- ✓ Certifikata për trajnimin e planifikimit strategjik, u janë dhënë 72 të punësuarve në ESHR të cilët e kaluan trajnimin (80% nga të punësuarit);
- ✓ Raporti me analizën krahasuese të praktikave më të mira të BE-së në fushën e revizionit të partive politike, në të cilin janë dhënë rekomandimet për përmirësimin e kornizës ligjore dhe institucionale për mbikqyrjen mbi financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore.

Rezultatet e aktiviteteve të Komponentit 2 të Tvincing Projektit kanë të bëjnë me:

- ✓ Përmirësimin e kapacitetit institucional dhe kadrovik të ESHR-së, për çka është përpiluar Raporti me rekomandime, si dhe Vlerësimi i nevojave për trajnimet dhe Plani për trajnimet e të punësuarve;
- ✓ Certifikatat për trajnimet për revizionin e suksesit dhe revizionin e fondeve të BE-së, më të cilat u pajisën 45 revizorë, gjegjësisht gjysma nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në ESHR;
- ✓ Zbatimin e 4 pilot-revizioneve të suksesit të fondeve të BE-së, TKI-së, realizimi i të diplomuarve në tregun e punës në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe prokurimet publike, që do të përfundojnë në vitin 2019, me çka ndjeshëm do të avanchohen kapacitetet e ESHR-së për zbatimin e revizioneve të suksesit.

Me rëndësi të veçantë është Komponenti 3 i Tvincing Projektit i cili fokusohet në përforcimin e bashkëpunimit ndërmjet Entit Shtetëror të Revizionit me Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së

Veriut, që të sigurojë shqyrtim të rregullt të raporteve të revizorit në Dhomën Ligjvënëse, ndërsa me të edhe përforcimin e rolit të revizionit shtetëror, si dhe ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve korrigjuese për zbatimin e rekomandimeve të revizorit.

Në bashkëpunim të drejtëpërdrejtë me deputetët tanë dhe me shërbimet e Kuvendit, me ndihmën e tvining partnerëve tanë, zbatuan një varg aktivitetesh qëllimi kryesor i të cilave ishte ngritja e ndërgjegjës së deputetëve për rëndësinë e punës së Entit Shtetëror të Revizionit dhe për caktimin e debatit të rregullt dhe cilësor në Kuvend për shkak të ndikimit më të madh të raporteve të revizorëve. Në prill dhe tetor të vitit 2018, në kuadër të Tvincing Projektit me deputetët tanë kishim mundësi t'i vizitojmë parlamentet e Kroacisë dhe Bullgarisë dhe për së afërmë të njoftohemi me praktikat e mira evropiane në lidhje me bashkëpunimin me institucionet e larta të revizionit.

Kolegët tanë të Entit Shtetëror të Revizionit të Republikës së Kroacisë na ndihmon ta përcaktojmë kornizën juridike dhe institucionale në lidhje me bashkëpunimin e Entit Shtetëror të Revizionit me Kuvendin, si dhe t'i njohim nevojat e deputetëve për t'i kuptuar dhe shqyrtuar raportet e revizorit.

Në këtë drejtim, në kuadër të Tvincing Projektit më 29 mars të vitit 2019 u organizua Tryzeza e Rrumbullakët për bashkëpunimin e ESHR-së me Kuvendin, me të cilën u festua edhe përvjetori ynë i 20-të i punës së suksesshme të Entit Shtetëror të Revizionit. Në Tryezën e Rrumbullakët, përvèç organizatorit, fjalime patën edhe përfaqësuesit më të lartë të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Delegacionit të BE-së në Shkup, EUROSAI, Gjykatës Evropiane të Revizionit, Entit Nacional të Revizionit të Republikës së Bullgarisë dhe Entit Shtetëror të Revizionit të Republikës së Kroacisë. Nëpërmjet dy panel-diskutimeve me kolegët tanë nga më tepër se dhjetë institucione të larta të revizionit nga Evropa dhe përfaqësuesit e Kuvendit, në prani të përfaqësuesve nga institucionet shtetërore nacionale dhe evropiane relevante dhe organizatat joqeveritare, shkëmbbyem përvoja për rëndësinë e bashkëpunimit të institucioneve të larta të revizionit me parlamentet dhe për rolin e tyre në zbatimin e rekomandimeve të revizorit.

Në kuadër të Komponentit 4 të Tvincing Projektit, tvining partnerët tanë na ndihmojnë që ta përmirësojmë transparencën nëpërmjet shfrytëzimit të rrjedhave bashkëkohore për të komunikuar me palët e prekura për bartjen e rezultateve nga puna jonë dhe nxitjen e ndërgjegjës publike për të ndërmarrë veprimin lidhur me sugjerimet e revizorit.

Gjithashtu, në kuadër të këtij komponenti në periudhën 02 - 05.10.2018, ishte zbatuar vetëvlerësimi i sistemeve të TI-së (ITSA) dhe është përpiluar raporti me rezultatet dhe rekomandimet në pajtim me metodologjinë e EUROSAI i Grupit të Punës së TI-së.

Në kuadër të Tvincing Projektit në vitin 2018 u realizuan edhe 5 vizita studimore në institucionet e larta të revizionit të Bullgarisë, Kroacisë dhe Sllovenisë, me të cilat ishte përfshirë gjithsej 50 pjesëmarrës nga ESHR-ja, si dhe 4 përfaqësues nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilët kishin mundësi t'i vizitojnë parlamentet e Republikës së Bullgarisë dhe Republikës së Kroacisë.


Aktivitetet e Tvincing Projektit vazhdojnë edhe në vitin 2019 të orientuara në përmirësimin e proceseve të revizionit, zbatimin e pilot-rezizioneve të rregullshmërisë dhe suksesit, punën si stazhier të të punësuarve në institucionet e larta të revizionit në vendet anëtare të BE-së, përmirësimin e sistemit të kontrollit dhe sigurimit të cilësisë së rezioneve, përforcimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet Kuvendit dhe ESHR-së, përforcimin e rezioneve të TI-së, përmirësimin e faqes së internetit të ESHR-së dhe komunikimin me palët e prekura.

## BUXHETI I ENTIT SHTETËROR TË REVIZIONIT

Në pajtim me Ligjin për revizionin, financimi i Entit Shtetëror të Revizionit sigurohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Mjetet e nevojshme për punë me propozim të Entit Shtetëror të Revizionit i përcakton Kuvendi. Buxheti i Entit Shtetëror të Revizionit përpilohet në kuadër të limiteve të përcaktuara vjetore në pajtim me strategjinë e përcaktuar fiskale dhe paraqet pjesë integrale të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Buxheti i përgjithshëm i miratuar për Entit Shtetëror të Revizionit në vitin 2018 arrinte 94.971.000,00 denarë. Prej tyre 96% janë mjete të siguruara nga buxheti qendror në shumë prej 90.816.000,00 denarë, 4% janë të ardhura personale në shumë prej 4.000.000,00 denarë dhe 155.000,00 denarë janë mjete nga Projekti për implementimin e sistemit për menaxhim me revizionet: MAK-12/0015. Burimet personale të të ardhurave rrjedhin nga periudha kur Enti Shtetëror i Revizionit bënte arkëtimin për revizionet e kryera në subjektet e caktuara, para miratimit të Ligjit të ri për revizionin shtetëror të miratuar në vitin 2010. Në pajtim me Ligjin nga viti 2010, mjetet për punën e Entit Shtetëror të Revizionit sigurohen ekskluzivisht nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Duke pasur parasysh numrin konstant të të punësuarve në vitet e kaluara dhe strukturën e shpenzimeve ku pjesëmarrja e rrogave në shpenzimet e përgjithshme arrin afér 82%, nuk ekzistojnë oscilacione në mjetet që Enti Shtetëror i Revizionit i siguron nga Buxheti i RMV-së:



## SHPENZIMET E ESHR-së NË VITIN 2018

Struktura e shpenzimeve të Entit Shtetëror të Revisionit tregon se 82% të shpenzimeve të përgjithshme në llogarinë e buxhetit themelor (637) dedikohen për rrogat e të punësuarve, 5,5% dedikohen për shpenzimet ditore dhe të rrugës për kryerjen e revizioneve në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe pjesëmarrja e të punësuarve në ngjarjet ndërkombëtare për t'u edukuar dhe përsosur në fusha të caktuarat: revizioni i TI-së, revizioni i brendshëm, implementimi i ISSAI për revisionin e suksesit, përforcimi i integritetit të institucioneve të larta të revisionit, kryerja e revizioneve kooperative, etj.

Me shpërnguljen në objektin e ri në rr. Jordan Mijallkov, shpenzimet për shërbimet komunale dhe ngrohje u rritën dhe marrin pjesë me 5% në shpenzimet e përgjithshme të ESHR-së. Përqindja e ulët e realizimit të shpenzimeve kapitale prej 1% ka të bëjë me mosrealizimin e prokurimeve publike për pajisjen informatike nga ana e operatorit ekonomik të zgjedhur si ofertuesi më i volitshëm, i cili nuk ishte në gjendje deri më 31.12.2018 ta realizojë prokurimin publik, ndërsa mjetet mbetën të parealizuara dhe u kthyen në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në vitin 2018 gjendja e llogarisë së Projektit për zbatimin e sistemit për menaxhim me revisionet, arrin 155.000,00 denarë, meqë projekti realizohet, mjetet u kthyen në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Norvegjisë.

*Shpenzimet e ESHR-së në vitet 2017 dhe 2018 nga llogaria 637*

Shpenzimet	2017	2018	%	Struktura
1	2	3	4	5
rrogat dhe kompensimet	70341026	71989385	102,3	81,6
shpenzimet ditore dhe të rrugës	4865614	4847836	99,6	5,5
shërbimet komunale, ngrohje komunikimi dhe transporti	4095494	4477000	109,3	5,1
materialet dhe invertari i imët	883680	1069453	121,0	1,2
sanimet dhe mirëmbajtja rrjedhëse	1045436	1289094	123,3	1,5
shërbimet kontraktuese	3952642	2573252	65,1	2,9
shpenzimet tjera rrjedhëse	801866	878820	109,6	1,0
transferet e ndryshme	30000	208221	694,1	0,2
shpenzimet kapitale	1794604	850689	47,4	1,0
<b>Shpenzimet e përgjithshme</b>	<b>87810362</b>	<b>88183750</b>	<b>100,4</b>	<b>100,0</b>

## TEKNOLOGJIA INFORMATIKE DHE REVIZIONI I TI-së

Enti Shtetëror i Revizionit e ndjek zhvillimin e teknologjisë informatike dhe vazhdimisht investon në përdorimin e teknologjisë informatike në revizion. Zhvillimi dhe përdorimi i teknologjisë informatike dhe përdorimi i saj racional dhe efikas në revizion është njëri nga qëllimet strategjike të Entit Shtetëror të Revizionit.

Për këtë qëllim është siguruar funksionimi i pandërprerë i infrastrukturës së sistemit të informacioneve dhe sistemeve të implementuara për ruajtjen e centralizuar dhe shkëmbimin e të dhënave, me vëmendje të veçantë në serviset dhe proceset kryesore, si posta elektronike, puna arkivore, sistemi i integruar financiar i informacioneve, sistemi për analizën e të dhënave nga raportet e revizorit dhe sistemi për menaxhim me procesin e revizionit (Audit Menaement System (AMS)). Sistemet dhe aplikacionet janë zhvilluar duke u përkujdesur për parimet dhe rregullat e: arritjes së të dhënave te shfrytëzuesi i autorizuar, besueshmërisë, integritetit, ruajtjes së sigurt të të dhënave në lokacionin qendror, pajtueshmërisë me ligjet, kryerjes së rregullt të kopjes rezervë (backup), mbrojtjes nga qasja fizike dhe logjike e të dhënave. Në pajtim me strategjinë e TI-së, ndërsa duke e pasur parasysh nevojën nga zhvillimi teknologjik i sistemit, çdo vjet zbatohen procedurat për furnizimin e pajisjeve informatike, me mjetet personale ose nëpërmjet IPA fondeve.

Në vitin 2018 është zbatuar dhe realizuar furnizimi i pajisjeve informatike nëpërmjet IPA fondeve. Më furnizimin është kryer zëvendësimi i serverëve të amortizuar, laptopëve personalë dhe desktop kompjuterëve, si dhe zëvendësimi dhe plotësimi i licencave të nevojshme për sistemet operative. Në mënyrë plotësuese është zbatuar furnizimi nëpërmjet SEPP-së, më çka ishte furnizuar muri mbrojtës (firewall) për siguri më të madhe nga sulmet e jashtme të sistemit informativ. Gjithashtu, realizohen edhe furnizime të softuerëve të specializuar, të bazuar mbi analizat e zbatuara paraprakisht për nevojat e atyre zgjidhjeve të softuerëve, si dhe për përkufizimin e qartë të karakteristikave teknike të tyre. Më rëndësi është të theksohet se nga viti 2017, ESHR-ja arriti të vendos një platformë pune për të gjithë shfrytëzuesit e vet, që dukshëm e lehtëson shfrytëzimin e resurseve të TI-së, si dhe realizimin e trajnimeve të TI-së për të punësuarit.

Realizimi i pandërprerë i detyrave të revizorit është vërejtur si prioritet kryesor në shfrytëzimin e teknologjive informative. Për këto shkaqe, krahas shfrytëzimit të internetit me shpejtësi dhe kapacitet të madh në hapësirat e ESHR-së, për çdo ekip të revizorëve janë siguruar: qasja në internetin celular, pavarësisht kushteve që i ka subjekti, pajisjet e transmetueshme për sigurimin digjital të provave, si dhe VPN qasja e pandërprerë dhe e sigurt në sistemin informativ të ESHR-së.

Revizorët shfrytëzojnë teknika të revizorëve për mjetet ndihmëse të kompjuterëve (CAAT's) në procesin e revizionit, ndërsa revizorët në sektorin e revizionit të sistemeve informative e shfrytëzojnë edhe softuerin IDEA për analizën e të dhënave prej të cilave gjenerohen raportet financiare.

Shfrytëzimi i teknologjisë informatike bazohet mbi ndjekjen konsekiente të Politikës për sigurinë e sistemit informativ të Entit Shtetëror të Revizionit, si dhe procedurave të zbatuara të TI-së së sigurisë dhe procedurave të TI-së për zbatimin e Sistemit për menaxhim me procesin e revizionit (AMS). Këto i nënshتروhen analizës vjetore, me qëllim që gjithnjë të jenë në hap me zgjidhjet e reja.

Procesi i revizionit nga viti 2017 kryhet me përdorimin e Sistemit për menaxhim me procesin e revizionit (Audit Management System (AMS)). Ky sistem ishte rezultat i projektit të përfunduar me sukses "Përmirësimi i efikasitetit dhe cilësisë së punës së revizorit me përdorimin e sistemit për menaxhim me procesin e revizionit (Audit Management System (AMS))", i financuar me grant nga Mbretëria e Norvegjisë dhe i realizuar me ndihmën teknike të Zyrës së kryerevizorit të Norvegjisë. AMS përbëhet nga një varg modulash: moduli i planifikimit vjetor, moduli për kryerjen e procesit të revizionit, moduli për menaxhim me bazën e subjektit që është lëndë e revizionit, moduli i shkëmbimit të informatave, moduli i diskutimit, moduli i të mësuarit, moduli i raporteve dhe moduli i administrimit. Si sistem kryesor për kryerjen e detyrave të revizorit, në vitin 2018 ishte përditësuar me versionin e ri, ndërsa përdorimi dhe mënyra e përmirësimit të tij, ndiqet në nivel vjetor. Në vitin 2018 është organizuar trajnimi i vazhdueshëm për të punësuarit në Entin Shtetëror të Revizionit për përdorimin e AMS-së (për të gjithë shfrytëzuesit e sistemit).

Revizioni i sistemeve informative është pjesë e revizioneve të rregullshmërisë, ku revizori e vlerëson vendosjen dhe funksionalitetin e kontrolleve duke i konstatuar rreziqet specifike tek kontrollet e brendshme me të cilat ballafaqohet subjekti i revizionit (qasja e paautorizuar, ndryshimi i paautorizuar i të dhënavë, humbja potenciale e të dhënavë etj.) që të bindet në besueshmërinë dhe integritetin e të dhënavë.

Enti Shtetëror i Revizionit, me revizionet vazhdimisht sugjeron në nevojën e miratimit të strategjisë për zhvillim të sistemeve informative, si dhe përcaktimin, miratimin dhe zbatimin e politikave dhe procedurave të sigurisë për sistemet dhe përmirësimin e bashkëpunimit të ndërsjellë, lidhshmërinë e sistemeve informative dhe shkëmbimin e të dhënavë, lidhshmërinë e bazave të të dhënavë tek aplikacionet e caktuara dhe kontrollin e qasjes në aplikacionet.

Me rekomandimet e dhëna do të përmirësohet menaxhimi me resurset e TI-së në pajtim me prioritetet për zhvillimin e subjektit të reviduar, njëherazi do të zgjedhohet rreziku nga mbrojtja joefikase e sistemit informativ, humbja ose dëmtimi i të dhënavë, pasaktësia dhe pabesueshmëria e shënimave dhe qasja e paautorizuar në të dhënat konfidenciale.

## AKTIVITETET E REVIZORIT PËR MES NUMRAVE

PV 2018




## REVIZIONET E KRYERA DHE RAPORTE TË PUBLIKUARA

Në vitin 2018 janë kryer 66 revizione (2017 - 58 revizione) prej të cilave 54 revizione të rregullshmërisë, 1 (një) revizion të pajtueshmërisë, 4 revizione të suksesit dhe 3 revizione follow up. Gjatë vitit 2018 kanë filluar pilot-revizonet e suksesit të fondeve të BE-së, TKI-së, realizimi i të diplomuarve në tregun e punës në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe prokurimeve publike, që do të përfundojnë në vitin 2019, me çka dukshëm do të avancohen kapacitetet e ESHR-së për zbatimin e revizioneve të suksesit. Nga revizionet e kryera janë publikuar 117 raporte të revizionit (2017 - 89), prej të cilave 109 raporte për revizionin e rregullshmërisë, një raport për revizionin e kryer të pajtueshmërisë, 4 raporte nga revizioni i kryer i suksesit dhe 3 raporte nga revizionet follow up.


### *Pasqyra e revizioneve të kryera dhe struktura e tyre*

Lloji i revizionit	Numri i revizioneve të kryera dhe struktura			
	Numri	Pjesëmarrje në %	Numri	Pjesëmarrje në %
1	2	3	4	5
Revizioni financiar dhe revizioni i pajtueshmërisë	54	82	48	83
Revizioni tematik / revizioni i pajtueshmërisë	1	1	6	10
Revizonet Follow-up	3	5	0	0
Revizioni i suksesit	4	6	4	7
Pilot-revizonet e suksesit të filluara me PV 2018 dhe do të vazhdojnë në PV 2019	4	6	0	0
<b>Gjithsej revizonet e kryera</b>	<b>66</b>	<b>100</b>	<b>58</b>	<b>100</b>



### Pasqyra e raporteve të publikuara dhe struktura

Lloji i revizionit	Numri i raporteve të publikuara dhe struktura			
	2018		2017	
	Numri	Pjesëmarrje në %	Numri	Pjesëmarrje në %
1	2	3	4	5
Revizioni financiar dhe revizioni i pajtueshmërisë	109	93	79	89
Revizioni tematik / revizioni i pajtueshmërisë	1	0	6	7
Revizionet Follow-up	3	3	0	0
Revizioni i suksesit	4	4	4	4
<b>Gjithsej raporte</b>	<b>117</b>	<b>100</b>	<b>89</b>	<b>100</b>



## SUBJEKTET E PËRFSHIRA NË REVIZION


Enti Shtetëror i Revizionit me Planin Vjetor të Punës, ndërsa në pajtim me kriteret e përcaktuara për zgjedhjen e subjekteve dhe temave të revizionit, i përkufizon subjektet dhe fushat të cilat do të revidohen në nivel vjetor.

Përfshirja e revizionit shtetëror nga aspekti i numrit të subjekteve të reviduara, i përfshin edhe subjektet të cilat detyrimisht revidohen çdo vjet, në pajtim me Ligjin.

Për t'i arritur qëllimet e revizioneve të kryera, varësisht nga ajo nëse zbatohet revizioni i rregullshmërisë ose revizioni i suksesit, gjatë vitit 2018, me revizionin janë përfshirë 102 subjekte nga të gjitha revizionet e kryera. Në pasqyrën e radhës është dhënë struktura e subjekteve të përfshira me revizionet, sipas llojeve të revizioneve:

*Pasqyra e subjekteve të reviduara dhe subjekteve të përfshira me revizionet e suksesit*

Lloji i revizionit	Subjektit	Pjesëmarrje në %		Subjektit	Pjesëmarrje në %
		2018	2017		
1	2	3	4	5	
Revizioni financiar dhe revizioni i pajtueshmërisë	54	47	48	26	
Revizioni tematik / revizioni i pajtueshmërisë	6	5	22	12	
Revizionet Follow-up	3	3	0	0	
Revizioni i suksesit	39	45	113	62	
<b>Gjithsej subjektit e përfshira me PV-në</b>	<b>102</b>	<b>100</b>	<b>183</b>	<b>100</b>	




## KONTROLLET E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

Në vitin 2018 Enti Shtetëror i Rezisionit ka kryer kontolle për të përcaktuar statusin e rekomandimeve të dhëna në raportet përfundimtare të rezisionit (follow up) të publikuara në vitet 2017 dhe 2018, në funksion të përcaktimit të shkallës së zbatimit të tyre. Në tabelën më poshtë është dhënë numri i kontolleve të kryera „follow up“ dhe raporteve të publikuara për të përcaktuar statusin e rekomandimeve të dhëna në raportet përfundimtare të rezisionit.

*Pasqyra e kontolleve të kryera follow-up*

Revizionet e zbatimit të rekomandimeve	PV 2018	PV 2017	Gjithsej
1	2	3	4
Numri i kontolleve të kryera follow-up për të përcaktuar statusin e rekomandimeve të dhëna në RP	6	24	30
Numri i raporteve të publikuara sipas kontolleve të kryera follow-up për të përcaktuar statusin e rekomandimeve të dhëna në RP	10	41	51




# TË ARDHURAT E REVIDUARA PUBLIKE

Shuma e përgjithshme e të ardhurave të reviduara publike të përfshira me revisionet e kryera të raporteve financiare në vitin 2018, janë paraqitur në pasqyrën si vijon:

*Pasqyra e të ardhurave të reviduara publike (në milionë denarë)*

Të ardhurat e reviduara publike në:	PV 2018		PV 2017	
	Të ardhurat	Pjesëmarrja në %	Të ardhurat	Pjesëmarrja në %
1	2	3	4	5
Buxheti Qendoror i Republikës së Maqedonisë së Veriut	147.996	58	156.315	61
Buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale	4.182	2	5.244	2
Buxhetet e fondevë	97.555	38	89260	34
Shfrytëzuesit e mjeteve nga buxheti i FSSH-së (ISHP - spitalet, klinikat...)	4268	2	1510	1
Partitë politike	196	0	598	0
Ndërmarrjet publike	1.029	0	640	0
Institucionet tjera	109	0	5273	2
<b>Gjithsej</b>	<b>255.335</b>	<b>100</b>	<b>258.840</b>	<b>100</b>




Në strukturën e të ardhurave të reviduara publike në vitin 2018, sipas llogarive vjetore për vitin 2017, të ardhurat e Buxhetit Qendoror të Republikës së Maqedonisë marrin pjesë me 58% në të ardhurat e përgjithshme të reviduara, buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale me 2%, buxhetet e fondevë marrin pjesë me 38%, shfrytëzuesit e mjeteve të buxhetit të FSSH-së (ISHP - spitalet, klinikat...) me 2%.

## SHPENZIMET E REVIDUARA PUBLIKE

Në strukturën e shpenzimeve të reviduara publike në vitin 2018, sipas llogarive vjetore për vitin 2017, shpenzimet e shfrytëzuesve të Buxhetit Qendoror marrin pjesë me 11% në shpenzimet e përgjithshme të reviduara, shpenzimet e reviduara të njësive të vetëqeverisjes lokale marrin pjesë me 3%, shpenzimet e reviduara të buxheteve të fondeve marrin pjesë me 79%, shfrytëzuesit e mjeteve të FSSH-së (spitalet, klinikat...) marrin pjesë me 4%, shpenzimet e ndërmarrjeve publike marrin pjesë me 1% dhe 2% nga shpenzimet e reviduara kanë të bëjnë me revizionet e suksesit.

*Pasqyra e shpenzimeve të reviduara publike (në milionë denarë)*

Shpenzimet e reviduara publike në:	PV 2018		PV 2017	
	Shpenzimet	Pjesëmarrja në %	Shpenzimet	Pjesëmarrja në %
1	2	3	4	5
Buxheti Qendoror i Republikës së Maqedonisë së Veriut	13.526	11	4.668	4
Buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale	3.939	3	4.955	5
Buxhetet e fondeve	94.496	79	89.260	84
Shfrytëzuesit e mjeteve nga buxheti i FSSH-së (ISHP - spitalet, klinikat...)	4.248	4	1.497	1
Partitë politike	216	0	598	0
Ndërmarrjet publike	974	1	629	1
Institucionet tjera	60	0	5.064	5
Shpenzimet publike të përfshira me revizionet e suksesit	2.127	2	0	0
<b>Gjithsej</b>	<b>119.586</b>	<b>100</b>	<b>106.671</b>	<b>100</b>



- Buxheti Qendoror i Republikës së Maqedonisë së Veriut
- Buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale
- Buxhetet e fondeve
- Shfrytëzuesit e mjeteve nga buxheti i FSSH-së (ISHP - spitalet, klinikat...)
- Ndërmarrjet publike
- Shpenzimet publike të përfshira me revizionet e suksesit

*Shpenzimet e reviduara sipas llojeve të buxheteve lidhur me buxhetet e përgjithshme*

	Buxheti i realizuar për vitin 2017	I reviduar	Pjesëmarrja në %	Buxheti i realizuar për vitin 2016	I reviduar	Pjesëmarrja në %
	(në milionë denarë)			(në milionë denarë)		
1	2	3	4 (3/2)	5	6	7 (6/5)
Shfrytëzuesit dhe individët shfrytëzues të Buxhetit Qendror (Llogaria përfundimtare e Buxhetit të RMV-së për vitin 2017 (Gazeta Zyrtare e RMV-së 141/30.07.2018)	159.823	19.024	12	154.777	12.456	8
Buxhetet e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale	30.419	3.939	13	30.493	4.955	16
Buxhetet e fondeve	94.504	94.496	100	89.260	89.260	100
Shpenzimet e përfshira me revisionet e suksesit		2.127				
<b>GJITHSEJ</b>	<b>284.746</b>	<b>119.586</b>	<b>42</b>	<b>274.530</b>	<b>106.671</b>	<b>39</b>

# GJETJET E REVIZIONIT / GJENDJET E KONSTATUARA

Gjatë zbatimit të Programit Vjetor të Punës për vitin 2018 revizorët e autorizuar shtetërorë dhe revizorët shtetërorë në raportet e revizionit kanë konstatuar 1171 gjetje / gjendje gjatë kryerjes së revizionit shtetëror, edhe atë:

- ✓ 26 gjetjet me revizionin e Buxhetit Themelor;
- ✓ 733 gjetjet me revizionin e raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë;
- ✓ 71 gjetjet me revizionin e suksesit dhe
- ✓ 341 gjendje të konstatuara si lëshim sistemor përkatësisht gjendje të cilat nuk janë nën kontroll të drejtpërdrejtë të subjektit që është lëndë e revizionit.

Në pasqyrat më poshtë është paraqitur pjesëmarrja e gjetjeve sipas fushave / temave dhe llojeve të revizioneve.

## 1. Revizioni i pajtueshmërisë të Buxhetit Themelor të RMV-së

Lloji i gjetjeve		Numri	Pjesëmarrja në %
1	2	3	4
1	Përpilimi i Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut	3	12
2	Realizimi i Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut	23	88
<b>GJITHSEJ</b>		<b>26</b>	<b>100</b>

## 2. Revisionet e raporteve financiare dhe revizioni i pajtueshmërisë

Lloji i gjetjeve		Numri	Pjesëmarrja në %
1	2	3	4
1	Gjetjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërin e rregullativës ligjore dhe rregullave	323	44
2	Gjetjet që kanë të bëjnë me raportet financiare	228	31
3	Gjetjet në sistemin e kontolleve interne	45	8
4	Gjetjet që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e mjeteve në pajtim me rregullat ligjore	51	7
5	Gjetjet që kanë të bëjnë me prokurimet publike	86	12
<b>GJITHSEJ</b>		<b>733</b>	<b>100</b>

### 3. Revizioni i suksesit

	Gjetjet	Numri	Pjesëmarrja në %
1	2	3	4
1	Gjetjet e revizionit të suksesit, në pajtim me temën e revizionit	71	100
<b>GJITHSEJ</b>		<b>71</b>	<b>100</b>

### REKAPITULAR I GJETJEVE NË RAPORTET PËRFUNDIMTARE

	Lloji i revizionit	Numri	Pjesëmarrja në %
1	2	3	4
1	Revizioni i pajtueshmërisë të Buxhetit Themelor të Republikës së Maqedonisë së Veriut	26	3
2	Revizioni i raporteve financiare dhe revizioni i pajtueshmërisë	733	88
3	Revizioni i suksesit	71	9
<b>GJITHSEJ I</b>		<b>830</b>	<b>100</b>
4	Theksimi i çështjeve të pasigurisë dhe kontinuitetit	163	48
5	Çështjet tjera	178	52
<b>GJITHSEJ II</b>		<b>341</b>	<b>100</b>
<b>GJITHSEJ I + II</b>		<b>1171</b>	

# PROKURIMET PUBLIKE

Gjatë vitit 2018 Enti Shtetëror i Revisionit në kuadër të kryerjes së revizioneve të planifikuara, i revidonte edhe prokurimet publike te subjektet që janë lëndë e revisionit. Gjatë kontrollit në mënyrën e planifikimit, zbatimit dhe realizimit të prokurimeve publike, janë konstatuar 182 raste të cilat kanë të bëjnë me këto parregullsi, përkatësisht nëngjetjet:

## *Pasqyra e nëngjetjeve të GJPP - Gjetjet të cilat kanë të bëjnë me prokurimet publike*

Nr. r.	Lloji i nëngjetjeve	Numri i nëngjetjetve
1	2	3
1	Procedurat e pavendosura/ procedurat e vendosura në mënyrë jo të drejtë/ sistemet kontrolluese lidhur me veprimin e GJPP-së gjatë zbatimit të LPP-së	1
2	Procedurat e pazbatuara për prokurime publike/furnizimi i kryer para lidhjes së marrëveshjes për PP/ furnizimet e kryera sipas marrëveshjeve të vjetra nga vitet e kaluara	10
3	Plani për PP-në i cili nuk është përpiluar dhe miratuar në afatin e paraparë ligjor	1
4	Lëshimet në fazën e planifikimit të PP-së/ (lloji i furnizimit, zgjedhja e procedurës përkatëse, sasitë e planifikuara, dinamika, mjetet e planifikuara financiare, dërgimi i planit në BPP, ndryshimi dhe plotësimi i planit, etj.)	23
5	Lëshimet në fazën e miratimit të vendimit për PP-në	8
6	Dokumentacioni i tenderit i cili nuk është përpiluar në pajtim me dispozitat e LPP-së.	13
7	Kriteret e përcaktuara për ndarjen e marrëveshjes për PP-në të cilat nuk janë në pajtim me LPP-në	3
8	Lëshimet në fazën e shpalljes për prokurimet publike dhe njoftimin e BPP-së	1
9	Lëshimet në fazën e hapjes së ofertave, evalvimi i dokumentacionit dhe përpilimi i raporteve në mënyrë përkatëse me dispozitat e LPP-së.	3
10	Lëshimet gjatë evalvimit të ofertave dhe dhënieve së propozimit për zgjedhjen e ofertuesit më të volitshëm.	20
11	Lëshimet në fazën e miratimit të Vendimit për zgjedhjen e ofertuesit më të volitshëm	6
12	Lëshimet në fazën e njoftimit pas zgjedhjes së kryer	1
13	Lëshimet në fazën e lidhjes së marrëveshjeve me ofertuesit e zgjedhur (mos lidhja e marrëveshjeve me ofertuesin e zgjedhur; marrëveshjet e lidhura me çmimet, kushtet dhe elementet tjera të ndryshme nga ofertat; nënshkrimi i marrëveshjeve në afatin më të shkurtër se afati i paraparë ligjor, etj.)	11

14	Lëshimet në fazën e realizimit të marrëveshjeve të lidhura për PP-në (garancitë, çmimet, sasitë, kushtet e pagesës dhe kushtet tjera të ndryshme nga kushtet e përkufizuara me marrëveshjen)	31
15	Realizimi i marrëveshjesës së përmes mbi shumën kontraktuese (tejkalimi i shumës kontraktuese/ mjetet e planifikuar financiare)	1
16	Procedurat e pavendosura/ pjesërisht të vendosura për ndjekjen e realizimit të marrëveshjeve në tërësi si nga aspekti sasior ashtu edhe nga aspekti cilësor.	12
17	Ndarja e furnizimeve/anashkalimi i procedurave për PP-në të përcaktuara me ligj	6
18	Aneks marrëveshjet jo të lidhura; lidhja e aneks marrëveshjeve të cilat nuk janë në pajtim me dispozitat ligjore	8
19	Lëshimet gjatë përpilimit të dokumentacionit / dosja për PP-në e zbatuar (evidencat / dosjet e parregulluara dhe të paplotë/ procesverbalet / raportet / pasqyrat e panënhshkruara / jo plotësisht të nënshkruara/ gabimet matematikore, etj.) )	5
20	Mosnjoftimi i BPP-së për marrëveshjet e lidhura pas PP-së së zbatuar në pajtim me formën dhe afatet e parapara me LPP-në	2
21	Nevoja e ekipimit/ekipimit shtesë të njësise organitive të ngarkuar për PP-në	1
22	Personi i emëruar / në njësinë e PP-së, pa poseduar vërtetim për dhënien e provimit të PP-së	3
23	Nuk është kërkuar pëlqimi për PP-në nga Këshilli i PP-së në pajtim me dispozitat e LPP-së	2
24	Nuk është vepruar sipas Aktvendimit të miratuar nga Këshilli i PP-së	1
25	Dokumentacioni i tenderit i cili në vete përmban elemente të kufizuara në lidhje me konkurrencën, dhe krijon mundësi për favorizimin e operatorëve të caktuar ekonomikë.	9

**Gjithsej**

**182**

## MENDIMET E REVIZORIT

Qëllimi kryesor në procesin e revizionit të rregullshmërisë është që revizorit t'i mundësojë të shpreh mendimin për atë nëse:

- ✓ raportet financiare në mënyrë të vërtetë dhe objektive e paraqesin gjendjen financiare dhe rezultatin e aktiviteteve financiare dhe
- ✓ aktivitetet, transaksionet financiare dhe informatat të reflektuara në raportet financiare janë në pajtim me rregullativën ligjore relevante, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

Në pajtim me qëllimet e vendosura në raportet e revizionit, janë shprehur mendimet për raportet financiare dhe për pajtueshmërin me ligjet dhe rregullat.

Në raportet e revizionit lidhur me raportet financiare për vitin 2017, janë shprehur:

- ✓ 35% - mendime pa rezervë (mendime pozitive);
- ✓ 21% - mendime me rezervë;
- ✓ 34% - mendime negative dhe
- ✓ 10% - të përmbajtur nga dhënia e mendimit.

Për pajtueshmërin me ligjet dhe rregullat: janë shprehur:

- ✓ 14% - mendime pa rezervë (mendime pozitive);
- ✓ 48% - mendime me rezervë;
- ✓ 37% - mendime negative, dhe
- ✓ 1% - të përmbajtur nga dhënia e mendimit.

Në krahasim me të dhënat e Raportit Vjetor për vitin 2017 vërehet trendi i rritjes së mendimeve pozitive për RF-të për 14%, ndërsa ka zvogëlim të mendimeve negative për 6% dhe të përmbajtur nga dhënia e mendimeve për raportet financiare për 2%.


Në lidhje me mendimet për pajtueshmërin me ligjet dhe rregullat, gjithëashtu, vërehet rritja e mendimeve pozitive prej 11% në 14%, ndërsa ka zvogëlim të mendimeve negative prej 43% në 37%.

Më poshtë është dhënë pasqyra e mendimeve të shprehura me strukturën – për raportet financiare dhe për pajtueshmërin me ligjet dhe rregullat për vitin 2017, të përmbajtura në raportet e revizionit në vitin 2018.


### Pasqyra e mendimeve të shprehura për raportet financiare dhe për pajtueshmërin

Programi Vjetor për vitin 2018	Raportet financiare për vitin 2017		pajtueshmëria me ligjet dhe rregullat për vitin 2017	
	Numri	Pjesëmarrja në %	Numri	Pjesëmarrja në %
Mendimi i revizorit				
Mendimi pa rezervë (pozitiv)	37	35	14	14
Mendimi me rezervë	22	21	48	49
Mendimi negativ	37	34	37	36
Të përbajturit nga dhënia e mendimit	11	10	1	1
<b>GJITHSEJ</b>	<b>107</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>

### Pasqyra e mendimeve të shprehura për raportet financiare



### Pasqyra e mendimeve të shprehura për pajtueshmërin me rregullat ligjore



# MASAT E NDËRMARRA SIPAS REKOMANDIMEVE TË DHËNA NË RAPORTET E REVIZIONIT

Krahas misionit kryesor të Entit Shtetëror të Revizionit si institucion i lartë i revizionit që në kohë dhe në mënyrë objektive t'i informojë bartësit e funksioneve publike dhe opinionin për gjetjet e revizorit nga revizionet e realizuara, gjithashtu qëllimi i revizionit është të japë rekondime të qarta dhe efektive me çka ESHR-ja siguron mbështetjen e institucioneve shtetërore dhe shfrytëzuesve të mjetave publike për avancimin e menaxhimit me to.

Në pajtim me Ligjin për revizionin shtetëror, përfaqësuesi ligjor i subjektit ka për detyrë ta informojë Entin Shtetëror të Revizionit dhe organin kompetent për mbikëqyrje dhe kontroll për masat e ndërmarrë lidhur me gjetjet dhe rekondimet në raportet e revizionit, në afat prej 90 ditësh nga pranimi i raportit përfundimtar.

Enti Shtetëror i Revizionit e ndjek zbatimin e rekondimeve të dhëna në raportet e revizionit në kuadër të kryerjes së revizioneve të rregullta, revizioneve të veçanta dhe kontolleve të zbatimit të rekondimeve, si dhe nëpërmjet informatave të pranuara nga subjektit.


Pas revizioneve të kryera nga Programi Vjetor i Punës së ESHR-së për vitin 2017, janë dhënë gjithsej 789 rekondime, ndërsa janë ndërmarrë masa për 465 rekondime ose veprimi sipas rekondimeve është 59%.

Pas revizioneve të kryera nga Programi Vjetor i Punës së ESHR-së për vitin 2018, Enti Shtetëror i Revizionit ka dhënë 799 rekondime. Deri në ditën e përpilimit të Raportit Vjetor për vitin 2018, për 507 rekondime të dhëna nuk ka skaduar afati ligjor për të njofuar lidhur me masat e ndërmarrë. Nga gjithsej 292 rekondime për të cilat afati për marrjen e informatave kthyese për zbatim ka skaduar, 120 janë zbatuar plotësisht ose pjesërisht, përkatësisht zbatimi është në rrjedhë, 11 rekondime nuk janë zbatuar (lidhur me organet tjera kompetente / faktorët e jashtëm, ose mospajtimet), për 160 rekondime nuk është dërguar përgjigjja, përkatësisht nga subjekti nuk është marrë informatë kthyese për të vepruar sipas rekondimeve.

Në pasqyrat e radhës janë dhënë të dhënat për kategoritë e statusit të masave të ndërmarrë sipas rekondimeve të dhëna për vitet 2017 dhe 2018:

**STATUSI I REKOMANDIMEVE TË DHËNA NË RP SIPAS PV 2017 DHE PV 2018  
PËR PROGRAMIN VJETOR PËR VITIN 2017**


PËRSHKRIMI		Për PV 2017	
		Numri	Pjesëmarrja në %
1	Rekomandimet sipas së cilave është vepruar (Rekomandimet që janë zbatuar plotësisht ose pjesërisht ose janë në rrjedhë)	465	59
2	Rekomandimet që nuk janë zbatuar (nuk janë ndërmarrë masa për shkak të faktorëve të jashtëm, subjekti nuk është pajtue me rekomandimet e dhëna, është lidhur me faktorët tjerë të jashtëm ose ngjashëm)	159	20
3	Rekomandimet që nuk mund të zbatohen për shkak rr Ethanave të ndryshuara	4	1
4	Rekomandimet për të cilat subjekti nuk ka dhënë informatë kthyese për masat e ndërmarra/nuk janë bërë kontrolllet e pasqyrave/revizori nuk ka pasur informata të mjaftueshme për të vërtetuar statusin e rekomnadimit.	161	20
<b>Numri i përgjithshëm i rekomandimeve për të cilat ka skaduar afati prej 90 ditëve për informatat kthyese</b>		<b>789</b>	<b>100</b>
5	Rekomandimet për të cilat afati prej 90 ditëve për dërgimin e informatave kthyese nuk ka skaduar	0	
<b>GJITHSEJ REKOMANDIMET E DHËNA</b>		<b>789</b>	



- Rekomandimet sipas së cilave është vepruar (Rekomandimet që janë zbatuar plotësisht ose pjesërisht ose janë në rrjedhë)
- Rekomandimet të cilat nuk janë zbatuar (nuk janë ndërmarrë masa, nuk janë ndërmarrë masa për shkak të faktorëve të jashtëm ose ngjashëm)
- Rekomandimet që nuk mund të zbatohen për shkak rr Ethanave të ndryshuara
- Rekomandimet për të cilat subjekti nuk ka dhënë informatë kthyese për masat e ndërmarra/nuk janë bërë kontrolllet e pasqyrave/revizori nuk ka pasur informata të mjaftueshme për të vërtetuar statusin e rekomnadimit.

## PËR PROGRAMIN VJETOR PËR VITIN 2018

PËRSHKRIMI	Për PV 2017	
	Numri	Pjesëmarrja në %
1 Rekomandimet sipas së cilave është vepruar (Rekomandimet që janë zbatuar plotësisht ose pjesërisht ose janë në rrjedhë)	120	41
2 Rekomandimet që nuk janë zbatuar (nuk janë ndërmarrë masa për shkak të faktorëve të jashtëm, subjekti nuk është pajtue me rekomandimet e dhëna, është lidhur me faktorët tjerë të jashtëm ose ngjashëm)	11	4
3 Rekomandimet që nuk mund të zbatohen për shkak rr Ethanave të ndryshuara	1	0
4 Rekomandimet për të cilat subjekti nuk ka dhënë informatë kthyese për masat e ndërmarra/nuk janë bërë kontrolllet e pasqyrave/revizori nuk ka pasur informata të mjaftueshme për të vërtetuar statusin e rekomnadimit.	160	55
<b>Numri i përgjithshëm i rekomandimeve për të cilat ka skaduar afati prej 90 ditëve për informatat kthyese</b>	<b>292</b>	<b>100</b>
5 Rekomandimet për të cilat afati prej 90 ditëve për dërgimin e informatave kthyese nuk ka skaduar	507	
<b>GJITHSEJ REKOMANDIMET E DHËNA</b>		<b>799</b>



- Rekomandimet sipas së cilave është vepruar (Rekomandimet që janë zbatuar plotësisht ose pjesërisht ose janë në rrjedhë)
- Rekomandimet të cilat nuk janë zbatuar (nuk janë ndërmarrë masa, nuk janë ndërmarrë masa për shkak të faktorëve të jashtëm ose ngjashëm)
- Rekomandimet që nuk mund të zbatohen për shkak rr Ethanave të ndryshuara
- Rekomandimet për të cilat subjekti nuk ka dhënë informatë kthyese për masat e ndërmarra/nuk janë bërë kontrolllet e pasqyrave/revizori nuk ka pasur informata të mjaftueshme për të vërtetuar statusin e rekomnadimit.


# ASPEKTET KRYESORE NGA GJENDJET E KONSTATUARA TË BUXHETIT THEMELOR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR VITIN 2017

Menaxhimi i mirë me financat publike paraqet njërin nga priorititetet e larta të shtetit me të cilin mundësohet stabiliteti finanziar dhe qëndrueshmërin e tyre. Përgatitja, miratimi dhe realizimi i Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut është proces, për të cilin në pajtim më kompetencat ligjore vazhdimisht njofton revizori i autorizuar shtetëror.

Lëshimi i afateve të parapara në miratimin e dokumenteve themelore të planit: Vendimi për përcaktimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Strategjisë Fiskale për periudhën afatmesme prej tri viteve është konstatuar gjatë përpilimit të Buxhetit në vitet e kaluar. Konstatuam se edhe gjatë përpilimit të Buxhetit për vitin 2017, dokumentet e lartpërmendura janë miratuar me lëshimin e afateve të përcaktuara ligjore, për shkak të caktimit të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në vitin 2016. Në mungesë të strategjisë fiskale, shumat maksimale të mjeteve të miratuar, Ministria e Financave i ka përcaktuar me qarkoren buxhetore për vitin 2017 në nivel të Buxhetit për vitin 2016, të zvogluara për 10%.

Konstatuam se një pjesë e shfrytëzuesve buxhetorë nuk kanë dërguar plan të vendeve të sistematizuara dhe të plotësuara të punës, plan për prokurimet publike dhe planet strategjike trivjeçare të cilat janë bazë për përpilimin e buxhetit me çka ballafaqohet me rrezik buxheti i miratuar nga ana e Ministrisë së Financave mos të jetë në korelacion me nevojat e tyre reale. Kjo e imponon nevojnë nga avancimi i procesit të planifikimit të nevojave te shfrytëzuesit buxhetorë dhe procesit të pajtueshmërisë të kërkesave të dërguara, ndërmjet udhëheqësve të shfrytëzuesve buxhetorë dhe Ministrisë së Financave.

*Mjetet e kërkuaara, të harmonizuara dhe të miratuar me buxhetin për vitin 2017*




Me analizën e kryer të lartësisë së **shpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara** për vitin 2017 konstatuam se këto janë realizuar në shumë prej 140.615.731 mijë denarë dhe janë rritur në mënyrë joëvidente për 0,93% në lidhje me vitin 2016. Në kuadër të disa kategorive të caktuara të shpenzimeve të realizuara, rritja më e rëndësishme në lidhje me vitin 2016 shënohet te pagesat kamatare, ndërsa zvoglimi më i rëndësishëm ekziston te shpenzimet për rezervat e shpenzimeve të papërkufizuara.

Gjatë vitit 2017 në **Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Republikës së Maqedonisë së Veriut** janë transferuar mjete në shumë prej 28.460.553 mijë denarë, gjegjësish për 6.96% më shumë se në vitin 2016. Një pjesë e mjeteve të transferuara në Fondin e SPIM-it janë dedikuar për mbulimin e detyrimeve në bazë të sigurimit pensional dhe invalidor, të përcaktuara me ligj gjegjësish për mbulimin e deficidit rrjedhës të Fondit të SPIM-it për pagesën e pensioneve.

Transferet rrjedhëse në Fondin e Sigurimit Shëndetësor të Maqedonisë së Veriut në vitin 2017 arrijnë 5.074.727 mijë denarë dhe këto janë më të larta për 6.41% lidhur me vitin 2016.


***Shpenzimet dhe daljet e realizuara dhe të planifikuara në vitin 2017  
dhe shpenzimet dhe daljet e realizuara në vitin 2016***



Në gusht të vitit 2017 janë bërë ndryshimet dhe plotësimet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me ç'rast është bërë zvogëlimi i pjesës së të ardhurave dhe pjesës së shpenzimeve të Buxhetit Themelor për 2% në lidhje me buxhetin e miratuar së pari.

Konstatuan se mjetet të cilat lejohen për pushtetin gjyqësor janë më të vogla edhe në lidhje me mjetet e kërkua edhe në lidhje me mjetet e përcaktuara ligjore 0,8% të BPV-së dhe të analizuar sipas viteve, për vitin 2015 arrijnë 0,37% të BPV-së, 0,36% të BPV-së për vitin 2016 dhe për vitin 2017 arrijnë 0,33% të BPV-së.


Mjetet e lejuara dhe të kërkua për realizimin e veprimitarive të pushtetit gjyqësor lidhur me mjetet e parapara ligjore, janë paraqitur në grafikën më poshtë, sipas viteve:



Me rëndësi të veçantë është se **shpenzimet kapitale** marrin pjesë me vetëm 1% në mjetet e përgjithshme me Buxhetin për pushtetin gjyqësor, që paraqet rrezik nga përbushja jo e plotë e qëllimeve strategjike, përkatesisht zvogëlimi i efikasitetit të gjykatave dhe përforcimi i besimit të opinionit në gjyqësinë, mossigurimi dhe garantimi i pavarësisë së gjyqësisë, sigurimi i mjeteve të nevojshme për realizimin e pandërprerë të funksioneve të institucioneve të pushtetit gjyqësor.

Pjesëmarrje më të madhe në të ardhurat e Buxhetit Themelor të RMV-së kanë **të ardhurat tatimore** realizimi i të cilave në pjesën më të madhe është në kompetencë të Drejtorisë së të Ardhurave Publike dhe Drejtorisë së Doganave. Në vitin 2017, të ardhurat tatimore janë realizuar në shumë të përgjithshme prej 102.062.994 mijë denarë dhe marrin pjesë me 70,57% në të ardhurat e përgjithshme të Buxhetit Themelor. Në vitin 2016 janë realizuar në shumë prej 97.336.145 mijë denarë që paraqet 62,6%.

## Pjesëmarrja e tatimeve të veçanta në të ardhurat tatimore në vitin 2017



Me revisionin në vitin 2017 konstatuam se Drejtoria e të Ardhurave Publike ka nevojë nga rritja e efikasitetit të kontrollit tatimor dhe përforcimit dhe rritjes së kapaciteteve kadrovike, duke e pasur parasysh strukturën e pavolitshme të moshës së inspektorëve dhe kontrolluesve tatimorë. Gjithashtu, nevojitet vazhdimi i aktiviteteve për sigurimin e mjeteve të dedikuara për zhvillim, zbatimi i sistemit të ri të integruar tatimor të TI-së për evidencën dhe arkëtimin, në drejtim të përmirësimit sistemor dhe menaxhimit me proceset e punës dhe tejkalimit të rreziqeve ekzistuese.

Në vitin 2017 janë arkëtuar gjithsej **tatimet importuese** dhe taksat në shumë prej 5.174.702 mijë denarë që është për 8,7% shumë më e lartë lidhur me shumat e arkëtuara në vitin 2016, kur janë arkëtuar gjithsej 4.760.740 mijë denarë.

Me revisionin e kompetencës së **Drejtorisë së Doganave** konstatuam se nevojitet vazhdimi i aktiviteteve për të vepruar lidhur me kërkesat e parashkruara nga tatimet importuese, të evidentuara në evidencën doganore, zbatimi dhe përdorimi i sistemit të integruar për arkëtimin e doganës dhe tatimeve doganore dhe përpunimin dhe arkëtimin e akcizave, plotësimin e infrastrukturës së serverit dhe ekipimin plotësues kadrovik të Sektorit të TKI-së.

Pjesa më e madhe e **te ardhurave kapitale** të cilat realizohen në Buxhetin Themelor janë të ardhurat, realizimi, evidentimi dhe kontrolli mbi zbatimin e të cilave bëhet nga ana e organeve të administratës shtetërore, në kuadër të kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj. Te të ardhurat kapitale që janë në kompetencë të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave konstatuam se ka nevojë të vendoset evidencë e plotë dhe komplete e kërkesave në bazë të qirasë së tokës ndërtimore dhe zbatimit të softuerit aplikativ për ndjekjen e kërkesave, të ardhurave të arkëtuara dhe të dhënavë tjetra lidhur me tokën bujqësore të dhënë me qira.

**Ngarkimi me borxh në vend** bëhet nëpërmjet lëshimit të letrave me vlerë afatshkrutra ose afatgjata, që i lëshon Republika e Maqedonisë së Veriut, me qëllim të grumbullimit të mjeteve në para. Hyrjet nga ngarkimi me borxh në vend në vitin 2017 janë në shumë të përgjithshme prej 58.879.324 mijë denarë, prej të cilave 38.389.401 mijë denarë nga letrat me vlerë afatshkurtra – shkresat shtetërore dhe 20.489.923 mijë denarë nga letrat me vlerë afatgjata – obligacionet shtetërore, që krahasuar me vitin 2016 është për 152.693 mijë denarë ose 0,26% më pak.

Në vitin 2017 në llogarinë e Buxhetit Themelor nuk janë realizuar hyrjet në bazë të **ngarkimit me borxh jashtë vendit**. Deficiti buxhetor në nivel të Buxhetit Qendror të shtetit, përfundimisht në prill të vitit 2017 arrin 2,7% të BPV-së, financohet nga mjete e siguruara me euroobligacionin e lëshuar në vitin 2016, të cilat janë mjete të dedikuara për mbështetjen buxhetore në vitet 2016 dhe 2017 dhe për rifinancimin e detyrimeve që maturojnë në bazë të pagesës së borxhit shtetëror.

Kemi bërë krahasimin e të dhënavët e evidentuara në të dyja bazat me të cilat menaxhon **thesari me** të dhënat e evidentuara në bazën e kontabilitetit buxhetor, me ç'rast konstatuam se kontrollet e vendosura, i mbulojnë rreziqet në funksionimin dhe menaxhimin me llogarinë e thesarit në pjesën e plotësisë dhe saktësisë në evidentimin e hyrjeve dhe daljeve të mjeteve në Buxhetin Themelor. Mendimi për t'i shfrytëzuar mjete buxhetore nga ana e shfrytëzuesve buxhetorë, të klasifikuara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut sipas ndarjeve, e shprehim në raportet e veçanta të revizioneve të kryera të revizorëve të autorizuar shtetërorë.

# FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË SË VERIUT

Enti Shtetëror i Revizionit kryen revizionin e rregullshmërisë së Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor për vitin 2017, me ç'rast i konstatoi gjendjet si vijon:

- ✓ Sistemi i kontrolleve të brendshme në procesin e realizimit të së drejtës së SPI-së është rregulluar me shumë akte dhe procedura të veçanta interne me të cilat nuk janë përfshirë një pjesë e dokumenteve të nevojshme të dosjes elektronike dhe të letrës pensionale. Ekziston mospajtueshmëria në punë në nivel të Fondit, përkatësisht kontrolllet te një pjesë e filialeve të Fondit nuk sigurojnë në tërësi dokumentacionin e vërtetuar dhe të plotë, me çka rritet rreziku nga parregullsitë në procedurën e përpunimit të lëndëve pensionale dhe njojen e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor. Gjatë pagesës së pensioneve, edhe krahas aktiviteteve të ndërmarra për funksionimin e kontrolleve të brendshme, ekziston rrezik nga pagesa e shfrytëzuesit të pensionit edhe pas skadimit të së drejtës së përcaktuar ligjore. Aktivitetet e ndërmarra për kthimin e shumë mjeteve të paguara nuk i japin rezultatet e pritura.

Revizioni rekomandon të përpilohet Udhëzimi i ri për organizimin dhe mënyrën e kryerjes së punëve në procedurën për t'i realizuar të drejtat e SPI-së dhe shfrytëzimin e dosjes pensionale elektronike nëpërmjet sistemit të vendosur elektronik të Fondit dhe sigurimin e kapaciteteve përkatëse për kryerjen e detyrave të punës dhe zbatimin e kontrolleve në procesin e realizimit të të drejtave të SPI-së dhe pagesën e pensioneve.

- ✓ Transferimi i mjeteve buxhetore nga Buxheti Qendror i RMV-së për nevojat e Fondit bëhet nëpërmjet MPPS-së, ndërsa arkëtimi i kontributit për sigurimin pensional dhe invalidor duke filluar nga viti 2009 është në kompetencë të Drejtorisë së të Ardhurave Publike. Kontrollin, gjetjen, arkëtimin, arkëtimin e detyrueshëm, parashkrimin dhe shlyerjen e kontributeve për sigurimin e detyrueshëm social i kryen Drejtoria e të Ardhurave Publike në pajtim me dispozitat e Ligjit për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social. Me ligjin në fjalë është rregulluar se institucionet kompetente kanë obligim që në mënyrë të ndërsjellë të shkëmbejnë të dhëna për obliguesit për të paguar kontributet, përllogaritjen dhe pagesën e kontributeve. Megjithatë, shkëmbimi i të dhënavë për obliguesit nuk siguron informata të plota për shumën e kërkesave në bazë të kontributit, të nevojshëm për krijimin e aktiviteteve në periudhën e ardhshme dhe dinamikën e arkëtimit të kontributit. Fondi në bashkëpunim me palët e tjera të përfshira nuk i ka ripërtërirë aktivitetet për revidimin e marrëveshjes të lidhur ndërmjet Fondit dhe DAP-së për dërgimin e të dhënavë për borxhet e veçanta të çdo paguesi të rrogës i cili ka borxh përkundër që me Protokollin e lidhur ndërmjet Fondit dhe DAP-së parashihet dërgimi i të dhënavë për t'i paguar kontributet e obligacioneve ndaj Fondit.
  - ✓ Vështirësitetë të cilat janë të pranishme gjatë arkëtimit të kërkesave të paarkëtuara në bazë të kontributit të papaguar për SPI-në përfundimisht me vitin 2008 dhe të kërkesave në bazë të dëmeve janë të pranishme edhe në vitin 2017 për shkak të faktit që një pjesë e obligacioneve

janë në likuidim ose falimentim, një pjesë paraqesin obligacione joaktive, një pjesë janë obligacione aktive që nuk paguajnë kontribut, etj. Fondi edhe krahas sigurimit të dhënavë për statusin e obligacioneve nga Regjistri Qendror nuk shënon progres evident në bazë të arkëtimit të këtyre kërkesave. Për shkak të parashkrimit absolut të kërkesave të evidençuarë në shumë 6.317.564 mijë denarë, përkatesisht përafërsisht 102.724.600 euro më 31.12.2018 nuk do të mund t'i arkëtojë nga obligacionet, ndërsa të punësuarit do t'i realizojnë të drejtat e SPI-së në shumë të vogël ose aspak nuk do t'i realizojnë për shkak të kontributeve të papaguara.

Revizioni është i mendimit se Qeveria e RMV-së duhet të ndërmerr aktivitete me të cilat do t'i obligojë institucionet kompetente ta shqyrtojnë propozimin e dërguar nga Fondi nëpërmjet MPPS-së për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për SPI-në („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr. 98/12...) dhe të sigurojë, mjetet e kontributeve për sigurimin pensional dhe invalidor që kanë ndodhur deri më 31.12.2008 të kenë karakter të mjeteve për konsumim personal dhe arkëtimi i tyre mos të parashkruhet.


Revizioni rekomandon që të ripërtërihen aktivitetet për të reviduar marrëveshjen të lidhur ndërmjet Fondit dhe DAP-së për shkëmbimin e ndërsjellë të dhënavë për obliguesit për t'i paguar kontributet, përllogaritjen dhe pagesën e kontributeve.

- ✓ Për shkak të mungesës së dhënavë të nevojshme në llogarinë përkatëse të pagesës së dedikuar për grumbullimin e mjeteve për kontributin e SPI-së në fund të vitit 2017 ka mjetë të pandara të cilat Fondi nuk mund t'i shfrytëzojë në shumë prej 624.122 mijë denarë (prej të cilave një pjesë në shumë prej 262.800 mijë denarë janë saldo e llogarisë së theksuar nga vitet paraprake), ndërsa të siguruarit nuk mund t'i realizojnë të drejtat e SPI-së. Me futjen e arkëtimit të integruar nëpërmjet DAP-së, shuma e mjeteve të pandara rritet vazhdimisht për shkak të pagesave të paalokuara për të cilat Fondi nuk ka marrë fletëparaqitje përkatëse, të dhëna të pasakta gjatë parashtrimit të përllogaritjes mujore, të dhëna të ndryshuara amë të cilat DAP-i ka për obligim t'i zgjidh, mjetë të paguara gabimisht ose shumë mjetë të paguara nga obligacionet dhe mjetet e paguara pamjaftueshmë për numrin e përgjithshëm të dhëna të punësuarve te obliguesi për të cilët pritet pagesa plotësuese, ndërsa Fondi dhe DAP-i kanë për obligim t'i ndajnë. Është e nevojshme që Fondi në bashkëpunim me organet kompetente t'i intensifikojë aktivitetet për zgjidhjen e gjendjeve me mjetet e paalokuara dhe të pandara në bazë të kontributit të paguar për sigurim pensional dhe invalidor.
- ✓ Të ardhurat e përgjithshme të realizuara në vitin 2017 arritën 66.502.391 mijë denarë të cilat sipas burimeve të financimit dhe pjesëmarrjes së tyre në të ardhurat e përgjithshme realizohen sipas bazave si vijon:
  - Kontributet për sigurim pensional dhe invalidor - 54%
  - Transferet nga nivelet tjera të pushtetit - 45%;
  - Tatimet vendore të mallrave dhe shërbimeve (akcizave) - 1,74%, dhe
  - Të ardhurat tjera - 0,14%.

Fondi edhe krahas rritjes së të ardhurave në bazë të kontributeve të SPI-së ka mungesë të mjeteve për pagesën e pensioneve dhe funksionimin e tij të pandërprerë, për këtë shkak parashev që mbulimin e deficitit ta kryejë me mjetet nëpërmjet transfereve të Buxhetit Qendror të RMV-së. Ministria e Financave për të mbuluar deficitin në vitin 2017 ka arkëtar gjithsej 28.457.029 mijë denarë, që krashtuar me vitin 2016 ka rritje për 7% përkatesisht në shumë prej 1.857.529 mijë denarë.

Trendi i lëvizjes së pjesëmarrjes së deficitit në të ardhurat e përgjithshme në periudhën 2011-2017 është paraqitur në grafikën e prezantuar më poshtë.

### *Pjesëmarrja e deficitit në të ardhurat e përgjithshme*



Rritja e deficitit dhe varësisë së Fondit nga transferet e mjeteve të Buxhetit të RMV-së është shkaktuar nga rritja permanente e numrit të shfrytëzuesve të pensioneve dhe lartësisë së të ardhurave pensionale, ndikimi i zgjidhjeve të caktuara ligjore të realizimit të të ardhurave nga arkëtimi i kontributit dhe pagesa e madhe e mjeteve për pensionet, si dhe mënyra ekzistuese e ndarjes dhe pagesës së kontributeve ndërmjet Fondit dhe fondevë pensionale private.

Për t'i tejkaluar gjendjetës së Fondit dhe ministritë kompetente të ndërmarrin aktivitete për zhvillimin e kapaciteteve të parashikuara aktuare dhe pensionale dhe përpilimin e analizës gjithëpërfshirëse për stabilizimin e sistemit pensional. Gjithashtu, rekomandohet që Fondi në bazë të analizës së bërë, të dërgojë propozim në Qeveri duke e rianalizuar mënyrën ekzistuese të ndarjes dhe pagesës së kontributeve ndërmjet Fondit dhe fondevë pensionale private.

Pas dërgimit të Raportit Përfundimtar tek organet kompetente, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Qeveri dërgoi mendim numër 09-10183/2 të muajit tetor të vitit 2018 në të cilin janë konstatuar aktivitetet sipas së cilave është e nevojshme të veprohet sikurse nga ana e MPPS-së, ashtu edhe nga ana e FSPIM-së, duke përfshirë propozimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të akteve ligjore që e rregullojnë këtë fushë;

Gjithashtu, Qeveria e RMV-së në mbledhjen e mbajtur më 06.11.2018 miratoi një varg konkluzionesh me të cilat i ngarkoi organet kompetente (Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe Ministrinë e Financave) dhe FSPIM-në të ndërmarrin aktivitete për mënyrën e mbulimit të deficitit të Buxhetit të FSPIM-së i cili çdo vjet rritet. Njëra nga masat që janë ndërmarrë paraqet edhe ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social me të cilin bëhet rritja e shkallës së kontributit për sigurimin e detyrueshëm pensional invalidor.


## FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR

Enti Shtetëror i Revizionit kryen revizionin e raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë të Fondit të Sigurimit Shëndetësor në llogarinë e buxhetit të fondevë për vitin 2017. Me revizionin e kryer u konstatuan gjendjet si vijon:

- ✓ katër nga nëntë sektorët nuk kanë të emëruar drejtore, ndërsa kontrolllet janë bartur në nivel më të ulët hierarkik, që krijon rrezik të përcaktimit joadekuatë të një pjese të përgjegjësive dhe realizimit joadekuatë të aktiviteteve të sektorëve;
- ✓ gjatë vitit 2017 për t'u mjekuar jashtë vendit janë paguar 394.658 mijë denarë (6.417.200 euro), mirëpo në procedurën për t'i dërguar për mjekim jashtë vendit janë konstatuar parregullsi dhe lëshime të caktuara, përkatësisht:
  - pavarësisht specifikave dhe subtilitetit të aktiviteteve në këtë procedurë, ajo nuk është rregulluar në mënyrë të veçantë përkatësisht ka trajtim si procedurë e përgjithshme administrative, e cila është e ndërlikuar dhe afatgjate;
  - nuk është siguruar mbrojtja juridike përkatëse e kërkuesve;
  - nuk parashihet forma organizative (seksioni ose reparti) në të cilën do të delegohen kompetencat dhe aktivitetet për t'u zbatuar, ndjekur dhe kontrolluar aktivitetet lidhur me këtë proces;
  - nuk është vendosur kontrolli ex-post;
  - nuk është vendosur sistemi i ndjekjes së statusit të mjekimit jashtë vendit dhe sigurimi i dokumenteve të sakta dhe të besueshme që shkakton në librat e punës së FSSHM-së me gjendjen më 31.12.2017 të evidentohen kërkasat për avancat e dhëna në shumë prej 313.596 mijë denarë (5.099.100 euro), dhe
  - nuk bëhen analiza për suksesin e mjekimit në spitalet e caktuara të mjekimit.

- ✓ është ngritur procedurë gjyqësore / kërkesë e padisë nga ana e FSSHM-së në lartësi prej 68.240 mijë denarë për mjetin ndihmës ortopedik tek i cili gjatë lëshimit të tij janë konstatuar parregullsi të caktuara. Për të mbajtur procedurën, FSSHM-ja ka angazhuar zyrë avokati për shërbimet e të cilit janë paguar 987 mijë denarë.

Numri i verifikimeve të kryera të mjetit ndihmës kontestues, në mënyrë grafike sipas viteve është paraqitur më poshtë, me ç'rast ajo gjatë vitit 2017 nuk është lëshuar.



- ✓ Marrëveshja e lidhur për evidentimin dhe ndjekjen e kërkesave, ndërmjet DAP-së dhe Fondit nuk është në pajtim me Ligjin për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social, përkatësisht me të nuk është përcaktuar obligimi që DAP-ja t'i dërgojë informatat e konstatuara ligjore tek institucionet të cilat ndikojnë mbi plotësinë e kërkesave të deklaruara në bazë të kontributit të papaguar në raportet financiare të Fondit;
- ✓ FSSHM-ja nuk disponon me plan strategjik aktual përkatësisht plani i fundit i miratuar strategjik ka të bëjë me periudhën 2010-2015, e as që disponon me strategjinë e TI-së;
- ✓ nuk është rregulluar statusi i një pjese të objekteve ndërtimore dhe tokës në pajtim me Ligjin për kadastër të patundshmërive që ndikon në realitetin dhe besueshmërinë e të dhënavë të deklaruara në raportet financiare;
- ✓ për kërkesat në bazë të kontributit të papaguar për sigurimin shëndetësor për periudhën prej vitit 2009 deri në vitin 2016 që arrijnë 1.624.243 mijë denarë (26.410.450 euro) janë konstatuar një varg lëshimesh në evidencën e tyre që kanë ndikim në raportet financiare për vitin 2017;

Në pjesën Çështjet tjera, revizioni zbuloi për zbatimin e aktiviteteve dhe gjendjes së kartelës elektronik të sigurimit shëndetsor dhe problemet me mossigurimin e vazhdimësia në lëshimin e tyre.

Në të njëjtën kohë revizioni sugjeroi në ndikimin e pavolitshëm të vendosjes së sistemit për sigurimin e detyrueshëm social në pajtim me të cilin të gjithë qytetarët kanë të drejtën e sigurimit shëndetësor, strukturën e të siguuarve, lartësinë e shkallës efektive të kontributit për sigurimin shëndetësor dhe të ardhurat që realizohen në këtë bazë dhe shkallën e papunësisë mbi qëndrueshmërinë e sistemit ekzistues të sigurimit shëndetësor.

Revizioni zbuloi edhe për mënyrën e pagesës së shërbimeve të kryera të institucioneve shëndetësore përkatësisht nuk është vendosur korrelacioni ndërmjet nivelit të shërbimeve të kryera dhe faturimit dhe kompensimit të tyre nga ana e Fondit me çka nuk është sigruar blerja e vërtetë e shërbimeve të paraparë me Ligjin për sigurim shëndetësor. Fondi në vend që t'i kompensojë shërbimet e kryera shëndetësore është i detyruar të sigurojë mjete për funksionimin e plotë të atyre ISHP-ve që nuk kanë mundësi të realizojnë vëllim të mjaftueshëm të shërbimeve ose të përputhen në sistemin ekzistues të vlerësimit të shërbimeve shëndetësore.

Revizioni nuk u bind se çmimet referente të shërbimeve shëndetësore janë të mjaftueshme për t'i mbuluar shpenzimet reale të institucioneve shëndetësore. Këto janë konstatuar në periudhën paraprake dhe nuk është bërë përshtatja e tyre në gjendjet aktuale për shkak të mungesës së analizave financiare të shpenzimeve nga ana e ISHP-ve që duhet të shërbejnë si tregues për krahasim.

**Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut e ngarkoi Ministrinë e Shëndetësisë ta informojë Qeverinë se deri ku është procesi për vënien e sërishtme në funksion të Sistemit për Kartelën Shëndetësore Elektronike, përkatësisht cili është statusi i Projekt-sistemit për kartelën shëndetësore elektronike. Njëherazi janë ndërmarrë masat për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social me të cilin bëhet rritja e shkallës së kontributit për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor.**


## PUSHTETI GJYQËSOR

Pushteti gjyqësor është pjesë e Buxhetit të RMV-së që është e veçuar si ndarje e veçantë "Pushteti gjyqësor" dhe paraqet vlerësim vjetor të të ardhurave dhe shpenzimeve të individëve shfrytëzues që i përcakton Kuvendi i RMV-së dhe është i dedikuar për financimin e tyre. Në kuadër të pushtetit gjyqësor gjatë vitit 2017, funksionojnë Gjykata Supreme, Gjykata e Lartë Administrative, Gjykata Administrative, 4 gjykata të apelit, 27 gjykata themelore, Këshilli Gjyqësor, Këshilli për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës Disiplinore për Gjykatës dhe Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë. Mjetet financiare për pushtetin gjyqësor sigurohen nga Buxheti i RMV-së, donacionet dhe të ardhurat personale të individëve shfrytëzues. Në pajtim me Ligjin për buxhetin gjyqësor, mjetet të cilat sigurohen nga Buxheti i RMV-së janë përcaktuar në shumë prej së paku 0,8% të bruto prodhimit vendor dhe në rastin e rebalancit të Buxhetit, këto nuk mund të zvogëlohen.

Nga analiza e qarkoreve të dorëzuara buxhetore, konstatuam se edhe krahas faktit që mjetet financiare të deklaruara të nevojshme për funksionimin e rregullt të individëve shfrytëzues të pushtetit gjyqësor prej viti në vit rriten prej 5% deri më 9%, mjetet që lejohen me Buxhetin e RMV-së zvogëlohen.

Më tutje, në pajtim me të dhënat për mjetet e planifikuara me Buxhetin e RMV-së për vitin 2015, për vitin 2016 dhe për vitin 2017 dhe rebalancet e realizuara, të dhënat nga Enti Shtetëror i Statistikës në lidhje me vlerën e bruto prodhimit vendor për vitet e njëjtë, si dhe të dhënat për mjetet e nevojshme të theksuara në kërkesa buxhetore të individëve shfrytëzues, konstatuam se mjetet e parapara për pushtetin gjyqësor me Buxhetin e RMV-së, nuk janë në kornizat e mjeteve të parapara në pajtim me Ligjin për buxhetin gjyqësor.

Pjesëmarrja e mjeteve të nevojshme që janë deklaruar në qarkoret buxhetore dhe mjetet e lejuara në lidhje me mjetet e parapara ligjore është paraqitur në grafikën më poshtë, ku është evidente se



mjetet të cilat me Buxhetin lejohen për pushtetin gjyqësor janë më të vogla edhe në lidhje me mjetet e kërkua edhe në lidhje me mjetet e përcaktuara ligjore prej 0,8% të BPV-së dhe këto për vitin 2015 arrijnë 0,37% të BPV-së, 0,36% të BPV-së për vitin 2016 dhe për vitin 2017 arrijnë 0,33% të BPV-së.

Mjetet të cilat me Buxhetin e pushtetit gjyqësor për vitin 2015, për vitin 2016 dhe për vitin 2017 janë paraparë për funksionimin e rregullt, në pjesën më të madhe janë të dedikuara për rroga dhe kompensime, ndërsa dukshëm më e vogël është pjesëmarrja e mjeteve për shpenzimet kapitale përkatesisht për investimet dhe zhvillimin e pushtetit gjyqësor.

Për nevojat e planifikimit dhe punës financiare të individëve shfrytëzues të pushtetit gjyqësor, një kohë të gjatë shfrytëzohet softueri për sistemin e menaxhimit të buxhetit të automatizuar ("SMB"). Me këtë sistem është vendosur veprimi i unifikuar i të gjithë shfrytëzuesve në lidhje me futjen, përpunimin, azhurnimin dhe prezantimin e të dhënave që dalin nga puna e përditshme e gjykatave, duke e përfshirë edhe procesin e planifikimit të buxhetit.

Gjithashtu, në pajtim me Ligjin për buxhetin gjyqësor, me Buxhetin për pushtetin gjyqësor duhet të parashihen edhe mjetet për rezervën rrjedhëse të dedikuara për rastet e paparapara (mbulimin e shpenzimeve në rastet e fuqisë së lartë, fatkeqësive elementare) shuma e së cilës nuk mund ta tejkalojë shumën e 2% të shpenzimeve rrjedhëse të buxhetit gjyqësor. Gjatë ndarjes së këtyre mjeteve, së paku 2,5% duhet të veçohen për përsosjen profesionale të gjykatësve, nëpunësve gjyqësorë, nëpunësve shtetërorë, policisë gjyqësore dhe të punësuarve tjerë në gjykatat. Të dhënët për strukturën e shpenzimeve për vitin 2015, për vitin 2016 dhe për vitin 2017, tregojnë se gjatë planifikimit të buxhetit, nuk parashihen mjetet për këtë dedikim.

Më tutje, sipas strukturës së shpenzimeve të planifikuara konstatuan se shpenzimet kapitale marrin pjesë me vetëm 1% në mjetet e përgjithshme të lejuara me Buxhetin për pushtetin gjyqësor. Në pajtim me Programin Vjetor për Shpenzimet Kapitale, këto dedikohen për përmirësimin e kushteve për punën në gjykatat përkatesisht për mirëmbajtjen e investimeve të objekteve dhe pajisjeve, përshtatjen e infrastrukturës gjyqësore për ndjekjen e reformave në jurisprudencë dhe për mirëmbajtjen e sistemeve informatike të pushtetit gjyqësor për shkak të rritjes së efikasitetit të gjyqësisë. Duke e pasur parasysh shumën e vogël të mjeteve që lejohen për shpenzimet kapitale për pushtetin gjyqësor, konstatuan rrezik me përbushjen e plotë të qëllimeve strategjike të pushtetit gjyqësor të parapara me planet strategjike, përkatesisht rritjen e efikasitetit të gjykatave dhe përforcimin e besimit të opinionit në gjyqësinë, sigurimin dhe garantimin e pavarësisë së gjyqësisë në RMV-në, sigurimin e mjeteve të nevojshme për kryerjen e pandërprerë të funksioneve të institucioneve të pushtetit gjyqësor, avancimin e vazhdueshëm të profesionalizmit dhe shkathtësive të gjykatësve dhe administratës gjyqësore.

Mënyra e këtillë e planifikimit të mjeteve për financimin e punës rrjedhëse të pushtetit gjyqësor krijon rrezik përfundimtar për funksionimin e tij të pandërprerë dhe ka ndikim mbi financimin stabil, afatgjatë, të barabartë dhe përkates të pushtetit gjyqësor.

Nevojitet që Ministria e Financave në bashkëpunim me institucionet kompetente dhe Këshillin Buxhetor Gjyqësor, të ndërmarrin masa dhe aktivitete për rishqyrtimin e mënyrës së përcaktimit dhe sigurimit të mjeteve për pushtetin gjyqësor në Buxhetin e Republikës në lartësinë e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për buxhetin gjyqësor.

# MBROJTJA E INTEGRITETIT TERRITORIAL DHE PAQES DHE SIGURISË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Rolin kryesor në sistemin nacional të mbrojtjes e ka Ministria e Mbrojtjes, e cila në pajtim me Ligjin për mbrojtje e krijon politikën e mbrojtjes, i përcakton drejtimet pér zhvillimin e planeve afatgjata dhe afatmesme, menaxhon me resurset njerëzore, materiale dhe financiare dhe njëherazi është mbështetje e Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Duke e realizuar misionin e vet, Armata përvèç në Republikë, detyrat për mbrojtjen dhe ruajtjen e paqes dhe sigurisë i realizon edhe jashtë shtetit, nëpërmjet bashkëpunimit të përbashkët ose në përbërjen e sistemeve kolektive të sigurisë dhe mbrojtjes.

Me revisionin e kryer të rregullshmërisë së Ministrisë së Mbrojtjes pér vitin 2017, revizorët i konstatuan gjendjet si vijon:

- ✓ Menaxhimi me resurset e Ministrisë dhe ARM-së zbatohet nëpërmjet sistemit të planifikimit, programimit, buxhetimit dhe realizimit shumëveçar, për çka është miratuar Rregullorja e planifikimit, programimit, buxhetimit dhe realizimit në Ministrinë e Mbrojtjes (PPBR) me të cilën përkufizohen qëllimet dhe prioritetet afatgjata dhe afatmesme, projektohen aftësitet dhe kapacitetet e mbrojtjes në pajtim me nevojat e mbrojtjes dhe të sigurisë së RMV-së. Në pajtim me Rregulloren e PPBR-së, pushteti ligjvénës dhe ekzekutiv në mënyrë afatgjate i përkufizon nevojat e mbrojtjes dhe të sigurisë dhe mënyrën e sigurimit të tyre, nëpërmjet dokumenteve të shumta strategjike, në mesin e të cilave edhe Strategjia e Mbrojtjes, e cila është miratuar në vitin 2018, por ende nuk është miratuar nga Presidenti i RMV-së. Gjithashtu, nuk është miratuar edhe plani afatmesëm pér zhvillimin e mbrojtjes pér vitet 2016-2019, që nuk është në pajtim me Ligjin për mbrojtje dhe ndikon në përbushjen e qëllimeve të ministrisë dhe funksionimit të saj.
- ✓ Ministria nuk ka ndërmarrë aktivitete për sigurimin e pronës dhe pajisjes me të cilën disponon për mbrojtjen nga situatat e paparapara (zjarret, vërshimet, vjedhjet dhe ngjashëm), për shkak të mosvendosjes së evidencës financiare të vlerës së tyre, e cila gjendje është konstatuar me vite të tëra, që krijon rrezik me shpenzime plotësuese për buxhetin dhe pamundësinë për dëme, në rastin e ngjarjeve të paparapara.
- ✓ Mënyra e vendosur e planifikimit të prokurimeve publike nuk është në pajtim me Ligjin për kontrollin financier të brendshëm publik dhe nuk e mbulon rrezikun nga gjetjet e gabuar të nevojës së prokurimit, vlerësimit joadekuatë të mjeteve të siguruar që janë të nevojshme për prokurim, përkufizimit joadekuatë të karakteristikave teknike të të mirave që prokurohen, që kontribuon për kohëzgjatjen e procedurave, lidhjes jo me kohë të marrëveshjeve dhe realizimit të vogël të planit vjetor për prokurime publike, kontraktimit të sasive të mëdha nga sasitë e nevojshme, gjendjeve që ndodhin gjatë zbatimit të procedurave për prokurime publike, në kundërshtim me Ligjin për prokurime publike.

Revizioni ka për obligim të sugjerojë se projekt „ARM-ja është shtëpia ime e vërtetë“ i referohet zgjidhjes së çështjes banesore të të punësuarve në ARM, është vënë në pushim edhe kahas asaj që janë ndërmarrë obligime në pajtim me Marrëveshjen dhe për realizimin e tij në periudhën prej vitit 2013 deri në vitin 2016 janë shpenzuar mjeteve të shumta nga Buxheti i Ministrisë.

## MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

Ministria e Punëve të Jashtme është organ i administratës shtetërore, i cili për shkak të realizimit të politikave dhe qëllimeve të veta, i kryen punët që u referohen punëve të jashtme dhe politikës së jashtme të Republikës së Maqedonisë, vendosjes, mbrojtjes së interesave, të drejtave dhe pronës së Republikës dhe shtetasve të saj, personave vendorë dhe juridikë jashtë vendit, kryen punë mbi organizimin dhe udhëheqjen me përfaqësitetë diplomatike, konsullore dhe përfaqësitetë tjera të RMV-së, si dhe punëve që kanë të bëjnë me lidhjen, komunikimin dhe bashkëpunimin me përfaqësitetë diplomatike dhe konsullore të shteteve të huaja dhe misioneve të organizatave ndërkombëtare në RMV, akreditimin e ambasadorëve, si dhe punëve tjera të përcaktuara me ligj.

Me revizionin e kryer të rregullshmërisë së ministrisë për vitin 2017, janë konstatuar gjendjet më të rëndësishme si vijon:

- ✓ Përfundimisht më 31.12.2017, nga gjithsej 57 Përfaqësuesi Diplomatik të Konsullit (PDK), 21 PDK funksionon pa pasur, përkatesisht pa qenë i emëruar ambasador ose konsull i përgjithshëm, që paraqet 37% të numrit të përgjithshëm të PDK-së. Theksojmë se deri në ditën e njoftimit nga revizioni i kryer, mars 2019, 43 PDK ose 76% funksionojnë pa pasur përkatesisht pa qenë i emëruar ambasador ose konsull i përgjithshëm që nuk janë në pajtim me dispozitat e Ligjit për punë të jashtme dhe Ligjit për kontroll financier të brendshëm publik dhe mund të ndikojnë mbi realizimin e qëllimeve dhe aktiviteteve politike në lidhje me shtetet, organet ndërkombëtare, organizatat dhe komunitetet, për t'i realizuar interesat e RMV-së në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe afirmimin e shtetit si faktor aktiv në skenën ndërkombëtare.
- ✓ Në drejtim të gjetjeve të pronës së PDK-së, nevojitet vendosja e evidencës përkatëse të vlerës së tokës në të cilën janë ndërtuar objektet ndërtimore të PDK-së, e cila është pronësi e RMV-së, si dhe e tokës nën objektin ku ministria e kryen veprimtarinë e vet.
- ✓ Me qëllim të konfirmimit të plotësisë dhe gjithëpërfshirjes së të dhënave të theksuara për obligimet e ministrisë në raportet financiare, nevojitet vendosja e evidencës së obligimeve të ndërmarra nga ana e PDK-së, me qëllim të paraqitjes së tyre në bazën e vetme të të dhënave në thesar.
- ✓ Nevojitet që ministria t'i tejkalojë mangësitë gjatë realizimit të aktiviteteve në regjistrimin e mjeteve dhe burimeve të mjeteve, për paraqitjen e tyre reale dhe objektive në raportet financiare dhe të miratojë akte për të pranuar regjistrimin.

- ✓ Me qëllim të shpenzimit me dedikim të mjeteve, nevojitet që PDK-të t'i realizojnë shpenzimet për dedikimin për të cilin janë lejuar, ndërsa në kushtet e nevojës nga shpërndarja e mjeteve në kornizat e buxhetit të miratuar që të kërkohet pëlqimi nga Ministria e Financave. Gjithashtu, nevojitet ndërmarrja e masave dhe aktiviteteve, që mjetet e lejuara e të pashfrytëzuara në fund të vitit, PDK-të t'i dërgojnë në Buxhetin e RMV-së.

Revizioni ka për obligim të sugjerojë në nevojën nga ndërmarrja e aktiviteteve që i referohen zgjidhjes së kontestit gjyqësor që RMV-ja e mban në Republikën e Italisë, si dhe përfundimin e investimit të objektit të ambasadës së RMV-së në Uashington.

Gjithashtu, e theksuam nevojën nga rregullimi normativ i mënyrës së përcaktimit të rrogës dhe kompensimeve tjera të këshilltarëve të veçantë të cilët janë angazhuar në pajtim me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik, si dhe mënyrën e përcaktimit të kompensimit për personalin e angazhuar lokalisht në PDK, duke e përfshirë edhe obligimin për rregullimin e statusit të tyre të punës, në pajtim me legjislacionin e shtetit të pranimit.

## MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Në pajtim me Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revisionit për vitin 2018 e kryem revizionin e rregullshmërisë së Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2017 të llogarive për buxhetin themelor; të ardhurave personale; buxhetin e huave / projekti i rikonstrukzionit dhe ndërtimit të ISHP-ve të RMV-së dhe buxhetin e huave / projekti i ndërtimit të qendrës së re klinike në Shkup dhe Shtip. Me revizionin e kryer i konstatuam gjendjet si vijon:

- ✓ Është bërë angazhimi i personave me kontratë në vepër vazhdimesht prej një viti në vendet e punës të cilët nuk janë të sistematizuar në aktin e sistematizimit të ministrisë, nuk janë angazhuar për realizimin e punëve jashtë veprimit tarisë. Për këta të punësuar janë paguar mjetet në shumë prej 12.656 mijë denarë, pa kriteri për të përcaktuar lartësinë e kompensimit;
- ✓ Në periudhën e raportimit janë realizuar gjithsej 20 programe të ndryshme në fushën e mbrojtjes shëndetësore për të cilat janë paguar mjete në shumë prej 3.856.232 mijë denarë (62.703.000 euro), me ç'rast revizioni konstatoi se buxheti i përcaktuar nuk është i mjaftueshëm për t'i mbuluar të gjitha aktivitetet që i realizojnë ISHP-të, me çka bëhet përkeqësimi i vazhdueshëm i gjendjes financiare të ISHP implementatorëve të aktiviteteve;
- ✓ Është konstatuar dallimi ndërmjet kontabilitetit material dhe finanziar me gjendjen më 31.12.2017 në shumë prej 1.522.714 mijë denarë që ndikon në cilësinë e raporteve financiare dhe informatave që i japin për menaxhimin dhe shfrytëzuesit e fundit;
- ✓ Nuk është bërë evidentimi dhe detyrimi i të punësuarve për aparatet celulare të marrë si subvencion nga operatori celular në shumë prej 1.548 mijë denarë;

- ✓ Nuk bëhet regjistrimi i vaksinave nga ana e ISHP-së dhe dërgimi i listave të regjistrimit në ministri, me çka pamundësohet sigurimi i të dhënave të nevojshme për gjendjen e tyre më 31.12.2017;
- ✓ Janë evidentuar kërkesat në shumë prej 127.735 mijë denarë për të cilat revizionit nuk i janë prezantuar të dhënat për masat e ndërmarrë përkthimin e tyre;
- ✓ Më pak janë evidentuar obligime për periudhën e raportimit në shumë prej 161.652 mijë denarë;
- ✓ Janë bërë prokurimet e pajisjes mjekësore për një numër të madh të ISHP-ve me ç'rast janë konstatuar një varg parregullshik sikurse në pjesën e ndarjes së marrëveshjeve për prokurime publike, ashtu edhe në procedurën e pranimit, duke i përfshirë gjendjet ku pajisja e blerë nuk është vënë në përdorim, ndërsa afati i garancisë ka skaduar;
- ✓ Për një pjesë të pajisjes së blerë është bërë vazhdimi i revizionit duke siguruar të dhëna plotësuese nga organi kompetent, me çka revizioni konstatoi se për një pajisje të caktuar nuk është bërë hulumtimi përkatës në treg, ndërsa furnizuesit kanë marre dallim plotësues në çmim;
- ✓ Janë konstatuar gjendjet që tregojnë respektim jokonsekvent të afateve të përcaktuara për realizimin e aktiviteteve ndërtimore të objekteve për të cilat janë ndarë marrëveshjet për prokurime publike, me ç'rast në raste të caktuara i është qasur lidhjes së një numri të madh të anekseve;
- ✓ Janë konstatuar gjendjet e realizimit të punëve të paparapara në periudhat paraprake, ndërsa rregullimi i tyre me lidhjen e anekseve është bërë me vonesë prej 17 muajsh;
- ✓ Gjatë realizimit të punëve për rikonstruksionin e ISHP-së, revizioni konstatoi se pozicionet e caktuara janë realizuar për 550% më tepër se marrëveshja themelore dhe paramatja përllogaritja në bazë të së cilës është ndarë marrëveshja për prokurime publike;
- ✓ Janë ndërmarrë obligimet për prokurimin e derivateve të naftës në shumë prej 3.389 mijë denarë pa u zbatuar procedura për prokurime publike;
- ✓ Janë konstatuar gjendjet për ndarjen e marrëveshjes për prokurime publike për punët pa u siguruar leja për ndërtim, përkatësisht ajo është siguruar pas lidhjes së marrëveshjes për prokurime publike, ndërsa në raste të caktuara me vonesë prej 7 muajsh;
- ✓ Janë konstatuar gjendjet e barnave dhe materialeve mjekësore të dërguara në vlerë të përgjithshme prej 3.327.273 \$ (donacion) për të cilat në vitin 2017 janë paguar 2.444 mijë denarë për t'i mbuluar shpenzimet logistike / administrative të dërgesave, por revizionit nuk i është prezantuar dokumentacioni për pranimin dhe dërgimin e tyre tek institucionet mjekësore që janë pranues të tyre, e as që janë siguruar të dhënat për atë se kush janë shfrytëzuesit e fundit;
- ✓ Është bërë zbulimi i gjendjeve në fushën e „sistemit nacional për punën materiale – financiare dhe të kontabilitetit në ISHP“ dhe „sistemit qendror për evidencën e orarit të punës“ me ç'rast revizori i autorizuar shtetëror zbuloi se sistemet e theksuara duke filluar nga 18.01.2018 janë lënë pa mbështetjen / mirëmbajtjen përkatëse, si dhe në pjesën e pagesës së tatimit mbi fitim të tepricës së realizuar të të ardhurave mbi shpenzimet.

# AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VRIUT

Në kornizat e kryerjes së veprimtarisë, Agjencia është kompetente për pagesën e rregullt të të drejtave në bazë të papunësisë – kompensimi në para, kontributi për sigurimin pensional për personat e papunësuar të cilët kanë të paktën 15 vjet stazh pensional, sigurimin shëndetësor për pranuesit e kompensimit në para dhe sigurimin material. Gjithashtu, në kompetencë të Agjencisë është zbatimi i Planit Operativ për programet aktive dhe masat e punësimit dhe shërbimet në tregun e punës, me të cilin përcaktohen programet, masat dhe shërbimet e punësimit, ndërsa me zbatimin e të cilit duhet të përmirësohet funksionimi i tregut të punës, të mbështetet krijimi i vendeve të reja të punës dhe të rritet punësimi. Plani Operativ mbahet nga ministri i Punës dhe Politikës Sociale, ndërsa zbatimi i tij është koordinuar nga ana e drejtorit të Agjencisë në bashkëpunim me institucionet tjera.

Me revisionin e rregullshmërisë në Agjencinë e Punësimit për vitin 2017 janë përfshirë programet aktive dhe masat e punësimit të cilat janë pjesë e Programit të Qeverisë së RMV-së, Strategjisë Nacionale të Punësimit 2016-2020 dhe Planit Aksional të Punësimit të Rinjeve 2016-2020 në bazë të së cilave është miratuar Plani Operativ për programet aktive dhe masat e punësimit dhe shërbimet në tregun e punës për vitin 2017, me të cilin parashihet të financohen 30 masa aktive. Me revisionin e kryer të Planit Operativ dhe dokumenteve të prezantuara janë konstatuar gjendjet si vijon:

- ✓ gjatë realizimit të programeve aktive dhe masave të punësimit nuk veprohet në pajtim me udhëzimet operative për realizimin e Planit Operativ për vitin 2017 në pjesën e sigurimit të specifikimit për marrëveshjet e lidhura, kopjen e gjithë dokumentacionit financiar, ndarjen e mbështetjes këshillëdhënëse dhe të mentorit, si dhe zbatimin e aktiviteteve për ndjekjen e suksesit të programeve;
- ✓ janë konstatuar gjendjet që tregojnë për raportimin dhe transparencën e zvogëluar në shpenzimin e mjeteve buxhetore, mosrespektimin e dispozitave nga marrëveshjet e lidhura dhe dërgimin me kohë të dokumentacionit të nevojshëm i cili i konfirmon transaksionet e bëra nga ana e organizatës ndërkontëtare implementuesi i 12 programeve aktive dhe masave të punësimit. Gjendja e konstatuar nga ana e revizorit të autorizuar shtetëror siguroi vlerë të shtuar në zbatimin e aktiviteteve të theksuara për shkak që gjatë veprimit për rekondimin e dhënë janë konstatuar kursime tek implementuesi i masave në bazë të TVSH-së në shumë prej 42.567 mijë denarë, përkatesisht 808.969 \$ dhe këto janë vënë në dispozicion për zbatimin e Planit Operativ për programet aktive dhe masat e punësimit dhe shërbimet në tregun e punës për vitin 2018 dhe të miratuar nga Qeveria e RMV-së.

Lëshimet të cilat paraqiten në realizimin e programeve në një pjesë të madhe janë për shkak të mossigurimit të mbështetjes këshillëdhënëse dhe të mentorit, si dhe aktiviteteve për ndjekjen e suksesit të programeve me futjen e kontrolleve në mënyrën e realizimit të programeve dhe masave të

punësimit, dhe inspektimin e marrëveshjes dhe dokumentacionit financiar dhe krahasimin e tyre me specifikimin, si dhe kontrollin në terren te personat juridikë që janë shfrytëzues të mjeteve.

Revizioni, gjithashtu, konstatoi mosrespektimin e dispozitave të Ligjit për punësimin e personave invalidë, në pajtim me të cilin në llogarinë e Fondit të Veçantë duhet të paguhen mjetet në para nga Buxheti i RMV-së, në bazë të TVSH-së së paguar dhe doganave nga ana e shoqërive mbrojtëse, si burime të mjeteve nga të cilat financohet Fondi i Veçantë, që ndikon në përmirësimin e kushteve të punësimit dhe punën e personave invalidë.


Pjesa më e madhe e të ardhurave të Agjencisë në vitin 2017 (71%) është kontributi i paguar për punësim. Revizioni konstatoi se në fund të vitit 2017 nga ana e Agjencisë nuk ishte bërë pajtueshmëri i të ardhurave të realizuara nga kontributi i punësimit me të dhënët e evidencës të cilën e posedon Drejtoria e të Ardhurave Publike. Në mungesë të mekanizmit kontrollues për ndjekjen e këtyre kërkeseve, revizioni nuk ka mundësi ta konfirmojë saktësinë dhe plotësinë e kërkeseve të theksuara në bazë të kontributit të punësimit, me të edhe ta vërtetojë plotësinë dhe saktësinë e të ardhurave të realizuara.

Revizioni, gjithashtu, konstatoi për obligimet e ndërmarra pa zbatimin e procedurave për prokurime publike, regjistrimin e zbatuar jotërsisht të mjeteve, kërkeseve dhe obligimeve, evidentimi i objekteve ndërtimore dhe tokës nuk e reflekton gjendjen faktike dhe për një pjesë nuk janë siguruar dokumente të rregullta dhe të besueshme, janë konstatuar parregullsi lidhur me shpenzimet për rroga dhe kompensime të rrogës, lëndë djegëse për mjetet motorike zyrtare dhe marrëveshjet e lidhura me të punësuarit për pagesën e shpenzimeve për transport dhe shpenzimeve gjyqësore.

Në pjesën e çështjeve që ndikojnë në vazhdimësinë e Agjencinë, revizioni bëri prezantimin e një varg gjendjesh që kanë të bëjnë me:

- ✓ parregullsitë e konstatuara në pjesën e sigurimit të dokumentit „ Gjetjet dhe mendimi për t'i caktuar punët të cilat mund t'i kryejë personi invalid në vendin përkatës të punës“ të lëshuar nga Komisioni pranë MPPS-së ku në pjesën më të madhe përdoret gjetjet „personi nuk është parë“;
- ✓ numrin e personave të papunësuar – kërkues aktivë, numrin e personave tjerë që kërkojnë punë – kërkues pasivë të punës, numrin e shfrytëzuesve të kompensimit në para, numrin e pjesëmarrësve në programet aktive dhe masat e punësimit, lartësinë e mjeteve të shpenzuara për të siguruar kompensimin në para dhe të drejtat tjera gjatë kohës së papunësisë, si dhe mjetet e shpenzuara në para për programet dhe masat aktive në periudhën 2014 – 2017, në mënyrë grafike është paraqitur si më poshtë:

*Mjetet e shpenzuara në para (në 000 denarë) për programet dhe masat aktive në periudhën 2014-2017*



Në pjesën e lëshimeve sistemore revizori i autorizuar shtetëror njofton për nevojën e veprimit të organeve kompetente për rregullimin shtesë të statusit të drejtorit / zëvendësdrejtorit të Agjencisë dhe të drejtat e tij me marrëdhënien e punës si statusi dhe të drejtat e të punësuarve në Agjencinë në pjesën e kategorizimit dhe niveleve të vendeve të punës, përcaktimin e pikëve dhe vlerën e pikës për bruto rrogat e të punësuarve në Agjenci.

Nga ana e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale më 13.11.2018 në Qeverinë e RMV-së është dërguar mendimi për Raportin Përfundimtar të Revizorit të APRM-së për pjesën e lëshimeve sistemore ku njofton se do të propozojë ndryshime dhe plotësimë të akteve ligjore.


Qeveria e RMV-së në mbledhjen e mbajtur më 27.11.2018 miratoi një varg konkluzionesh me të cilat ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale që të ndërmarrin masa dhe aktivitete për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara në pjesën e zbulimit të kryer dhe lëshimeve të konstatuara sistemore, ndërsa APRM-ja mes tjerash do të përpilojë plan aksional për zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Më 29.01.2019, APRM-ja në Entin Shtetëror të Revisionit dërgoi plan aksional me aktivitetet dhe afatet e përkufizuara për të vepruar sipas rekomandimeve të dhëna në Raportin Përfundimtar të ESHR-së.

## AGJENCIA E KADASTRËS SË PATUNDSHMËRIVE

Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive është kompetente për kryerjen e punëve të vënies dhe mirëmbajtjes së kadastrës së patundshmërive, menaxhimit me sistemin e informatave të kadastrës dhe gjeodezikes, vlerësimit masovik të patundshmërive të regjistruar në kadastrën e patundshmërive, themelimit dhe menaxhimit me Regjistrin Grafik të Tokës Ndërtimore, si dhe themelimit, mirëmbajtjes dhe qasjes publike në Infrastrukturën Nacionale të të Dhënavë Hapësinore.

Agjencia kryen një numër të madh shërbimesh për nevojat e qytetarëve dhe institucioneve, duke i shfrytëzuar të dhënat nga sistemi i informatave të kadastrës dhe gjeodezikes, të cilat sipas llojeve të shërbimeve për lëndët e zgjidhura në vitin 2017, hollësisht janë paraqitur në grafikën më poshtë:



Nga inspektimi i kryer në mënyrën e funksionimit të sportelit elektronik të Agjencisë i konstatuan gjendjet që kanë të bëjnë me mënyrën e vendosur të funksionimit të sportelit elektronik në Agjenci, i cili shpie në pamundësinë për t'i kontrolluar të gjitha lëndët në lidhje me vlerën e mjeteve që duhet të arkëtohen, me vlerën e mjeteve të paguara për lëndët e zgjidhura, si dhe mundësinë të

lëshohen një varg ekzemplarësh nga e dhëna e kërkuar, edhe pse kompensimi paguhet për një ekzemplar nga e dhëna e kërkuar. Rekomandojmë që personi përgjegjës i Agjencisë të vazhdojë me aktivitetet e filluara nëpërmjet plotësimeve përkatëse të sistemit që ta tejkalojë gjendjen e tillë.

Konstatuam se Agjencia nuk ka dërguar propozim të numrit të vetëm të identifikimit në Qeverinë e RMV-së, në bazë të të cilit do të vendos evidencë për pronën e patundshme në pronësi shtetërore, si dhe pronën e patundshme në pronësinë shtetërore që e shfrytëzojnë organet shtetërore.

Për një pjesë të objekteve ndërtimore në të cilën janë vendosur njësítë rajonale të Agjencisë, nuk janë siguruar listat pronësore si konfirmim i dispozicionit ose i së drejtës së dhënë në shfrytëzim.

Regjistrimi i mjeteve dhe burimeve të mjeteve nuk është kryer plotësisht në pajtim me rregullativën ligjore.

Agjencia ka dërguar njoftime për tërheqjen e vërejtjes para padisë për komunat, por nuk ka ndërmarrë masa dhe aktivitete për arkëtimin e faturave të dërguara nëpërmjet shfrytëzimit të klauzolës së kryer të marrëveshjeve për arkëtimin e faturave të dërguara, ndërsa të ardhurat nga shërbimet e kryera të kadastrës të arkëtuara nëpërmjet POS terminaleve nga ana e bankës afariste paguhet në llogarinë e Agjencisë në mënyrë përbledhëse, përkatësisht nuk veçohet në pajtim me kompensimin e paguar për kërkesën e parashtruar për lëshimin e të dhënave ose parashtrimit të fletëparaqitjes për t'i regjistruar ndryshimet në kadastrën e patundshmërive.

Nga inspektimi i kryer në pjesën e procedurave për prokurimet publike i konstatuam gjendjet të cilat nuk janë në pajtim me dispozitat e Ligjit për prokurime publike, si dhe parregullsitë në realizimin e dispozitave në marrëveshjet e lidhura sipas tyre.

Në pjesën e **lëshimeve sistemore** e theksojmë mungesën e dispozitave në Ligjin për nëpunësit administrativë për përcaktimin e rrogave të të punësuarve të cilët kryejnë punë teknike dhe ndihmëse për shkak të së cilës ekziston llojillojshmëri në përllogaritjen dhe lartësinë e rrogave të kësaj kategorie të të punësuarve. Për të tejkaluar gjendjen e konstatuar të organeve të administratës shtetërore në bashkëpunim me ministrinë kompetente duhet të ndërmarrin aktivitete për iniciimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të akteve ligjore dhe nënligjore dhe përcaktimin e kriterieve për përllogaritjen e rrogës së personave të punësuar të cilët kryejnë punë teknike dhe ndihmëse.

## AGJENCIA E FILMIT

Agjencia e Filmit e kryen veprimtarinë me interes publik në fushën e veprimtarisë së filmit, që e përfshin mbështetjen, nxitjen dhe zhvillimin e veprimtarisë së filmit, financimin e projekteve me interes nacional për RMV-në në veprimtarinë e filmit, si dhe mbështetjen, prezantimin dhe kujdesin për krijimtarinë e filmit në RMV.

Me revizionin e rregullshmërisë së Agjencisë së Filmit për vitin 2017, janë konstatuar gjendjet si vijon:

- ✓ Nuk është miratuar Strategjia për zhvillimin e veprimtarisë së filmit, bashkë me Planin Aksional për realizimin me aktivitetet e përkufizuara, bartësit e aktiviteteve, masat e realizimit, indikatorët e evalvimit, afatet e realizimit dhe burimet e mjeteve buxhetore dhe jashtë buxhetore. Mosndërmarrja e aktiviteteve për të miratuar këtë akt të rëndësishëm ndikon mbi punën e përditshme të Agjencisë, në lidhje me vendosjen e qëllimeve dhe prioriteteve në zgjedhjen e projekteve të filmit në konkurset vjetore, mjeteve të nevojshme financiare për realizimin e tyre, organizimin e procedurave administrative që ndërmerren për shkak të mbështetjes, nxitjes dhe zhvillimit të veprimtarisë së filmit.
- ✓ Gjatë shpalljes së konkurseve për projektet e filmit dhe projektet tjera, Agjencia nuk i ishte përmbajtur kushteve dhe kritereve të domosdoshme të Ligjit për veprimtarinë e filmit, e as që ka miratuar akt-procedurë interne me të cilën do të përcaktohen të gjitha aktivitetet dhe hapat të cilat ndërmerren gjatë zbatimit të procedurës në konkurs që mund të shfaq dyshim në vendimmarrjen subjektive për atë se cilat projekte duhet të pranohen, përkatesisht të refuzohen.
- ✓ Në marrëveshjet e lidhura me shtëpitë e producentëve janë konstatuar lëshimet në aspekt të garancisë bankare të lëshuar në mënyrë joadekuante ose mosvazhdimit të afatit të vlefshmërisë së saj, duke mos iu përmbajtur dinamikës së realizimit të projektit të filmit, si dhe pagesës së mjeteve, duke mos u përmbajtur pjesëmarrjeve të përcaktuara për të financuar filmin me metrazh të gjatë me pjesëmarrjen maqedonase të pakicës, duke mos u bashkëngjitur marrëveshjeve të lidhura ndërmjet pjesëmarrësve të cilët kanë pjesë në film, duke mos e përpiluar raportin pozitiv nga ana e Agjencisë për mjetet e ndara që janë shpenzuar, e as duke dërguar raport final gjatë përfundimit të filmit nga ana e shtëpisë të producentëve. Gjithashtu, Agjencia e Filmit nuk ka inspektim në të ardhurat e realizuara nga shpërndarja dhe shitja e projekteve të filmit, që për efekt ka të ardhurat e parealizuara të Agjencisë nga bruto fitimi i projektit të filmit, me çka zvogëlohen mjetet për t'i financuar projektet tjera.
- ✓ Për dhënien e pajisjes së kinemasë që t'i shfrytëzojnë përkohësisht institucionet nationale dhe lokale, nuk janë ndërmarrë masa për të vazduar afatin e shfrytëzimit ose kthimit të tyre. Mosndërmarrja e masave për të kthyer ose për të vazduar afatin e shfrytëzimit të pajisjes nga ana e shfrytëzuesve pa aktin juridik përkates krijon rrezik nga shfrytëzimi, ruajtja dhe mbrojtja e tyre joekonomike dhe joadekuante.
- ✓ Për shkak të ndërmarrjes jo me kohë të aktiviteteve për ndërprerjen e marrëveshjeve në periudhën e kaluar, në rastet kur nuk respektohen dispozitat e marrëveshjeve të lidhura, në vitin 2017 ishte shkaktuar gjendja e ndërprerjes së njëanshme të një numri të madh të paramarrëveshjeve,

marrëveshjeve ose anekseve të marrëveshjeve për t'i financuar projektet e filmit dhe ishin ndërmarrë masat për të mbikëqyrë shfrytëzimin me dedikim dhe ligjor të mjeteve.

- ✓ Është lidhur marrëveshja dhe tri anekse në këtë marrëveshje, për financimin shumëvjeçar të projekteve / serisë artistike që aspak nuk është realizuar, ndërsa për të janë paguar mjetet në shumën e caktuar, prej të cilave vetëm një pjesë janë kthyer, përkatesisht mbesin mjetet të cilat deri në ditën e revisionit nuk janë kthyer.
- ✓ Janë dhënë hua nga njëra shtëpi e producentëve në shtëpinë tjeter të producentëve nga mjetet e llogarisë me dedikim për filmin konkret, që mund të shfrytëzohet ekskluzivisht për projektin e filmit për të cilin është hapur. Huazimi i tillë i mjeteve në para prej njërit film në filmin tjeter nuk është në pajtim me kushtet për të shfrytëzuar llogarinë me dedikim e cila është hapur dhe duhet të shfrytëzohet ekskluzivisht për filmin konkret, e jo nga llogaritë tjera me dedikim të paguhen mjetet për filmat tjera. Huat e dhëna dhe të marra në këtë mënyrë prej njërit film në filmin tjeter ose pagesa në llogarinë e rregullt paraqet shfrytëzim jo me dedikim të mjeteve dhe nuk është në pajtim me rregullativën ligjore.
- ✓ Të evidentuarit e pagesave me para në dorë nga ana e shtëpive të producentëve nuk është rregulluar, nuk përpilohen mëditje të arkëtarëve, kryhen pagesat në bazë të faturave bllanko ose faturave dhe llogarive fiskale prej të cilave nuk mund të përcaktohet se çka është furnizuar dhe nëse ka të bëjë me projektin konkret të filmit.

Me qëllim të përmirësimit të gjendjeve, revizioni rekomandoi të ndërmerren masa dhe aktivitete për shkak të tejkalimit të gjendjeve të konstatuara.

Në pjesën – Të theksuarit e çështjeve për pasiguri ose vazhdimësi, revizioni e theksoi gjendjen me mundësinë nga lidhja e marrëveshjeve nga ana e shtëpive të producentëve me personat e tretë, në bazë të së cilave realizohen të ardhurat plotësuese nga shitja e filmit ose rilëshohen në mënyrë të përhershme ose të pakufizuar të drejtat materiale për prodhim, lëshim në qarkullim, prezantim publik, transmetim, ritransmetim të RTM-së, ndërsa për të cilat producenti nuk ka kërkuar leje dhe pëlqim nga Këshilli Drejtues i Agjencisë së Filmit, që del nga mospasja e inspektimit në gjendjen pas përfundimit të filmit që është financuar nga ana e Agjencisë së Filmit.

# KOMISIONI RREGULATOR I ENERGJETIKËS

- ✓ Komisioni Rregulator i Energjetikës është themeluar për shkak të rregullimit të çështjeve lidhur me kryerjen e veprimtarive energjetike të përcaktuara me Ligjin për energjetikë, me qëllim të sigurimit të funksionimit efikas, konkurrent dhe të pandërprerë të tregjeve energjetike. KRRE-ja është i pavarur në punën dhe vendimmarrjen e vet në kornizat e kompetencave të përcaktuara me Ligjin për energjetikë dhe me Ligjin për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve ujore, të miratuar në janar 2016, me cilësinë e personit juridik, ndërsa për punën e vet të paktën një herë në vjet e njofton Kuvendin dhe Qeverinë e RMV-së.
- ✓ Me revizionin e rregullshmërisë së Komisionit Rregulator të Energjetikës për vitin 2017, janë konstatuar gjendjet si vijon:
- ✓ Menaxhimi dhe kontrolli finansiar në KRRE-në nuk është vendosur dhe nuk zbatohet në pajtim me kërkesat e standardeve për kontrollin e brendshëm në sektorin publik, që krijon rrezik nga të prezantuarit gabimisht të të dhënave në librat tregtarë dhe raportet financiare, si dhe rrezikun nga parregullsitë në zbatimin e rregullave ligjore.
- ✓ Nuk është bërë pajtueshmëri i Statutit të KRRE-së me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për energjetikë dhe Ligjit për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve ujore në pjesën e kompetencave të KRRE-së.
- ✓ Në Marrëveshjen Kolektive janë përfshirë kryetari dhe anëtarët e Komisionit Rregulator të cilët janë zgjedhur dhe emëruar nga Kuvendi i RMV-së, që nuk është në pajtim me rëndësinë dhe rolin e Marrëveshjes Kolektive, me të cilën rregullohen të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e punëtorëve me marrëdhëni e punës në KRRE-në dhe kjo nënshkruhet ndërmjet tri palëve kontraktuese, në mesin e të cilëve edhe kryetari i KRRE-së, në rolin e punëdhënësit. Gjithashtu në KRRE, në vitin 2017 u bë pagesa e rrogës së kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit, në bazë të Marrëveshjes Kolektive që nuk është në pajtim me rregullat ligjore. Në Ligjin për rrogë dhe kompensime tjera të personave të zgjedhur dhe të emëruar në RMV, është rregulluar se rroga e funksionarëve dhe personave që i zgjdh ose i emëron Kuvendi, e përcakton Kuvendi ose trupi që ai do ta autorizojë.

Në periudhën e vërejtjeve për Projekt-raportin, është vepruar sipas rekomandimit të dhënë të revizionit dhe është lidhur Aneksi i Marrëveshjes Kolektive, me të cilën anëtarët dhe kryetari i Komisionit përjashtohen nga marrëveshja për rrogën dhe kompensimet tjera nga marrëdhënia e punës.

- ✓ Në Planin Financiar dhe Vendimin për përcaktimin e përllogaritjes së përqindjes së përfshirjes së të ardhurave të përgjithshme të bartësve të licencave për veprimtaritë energjetike dhe dhënësve për shërbimet ujore, është përcaktuar përqindja e përbashkët e përfshirjes së të ardhurave të përgjithshme të bartësve të licencave për veprimtaritë energjetike dhe dhënësve për shërbimet ujore, në vend të përqindjes së veçantë gjatë përllogaritjes së përqindjes nuk bëhet zvogëlimi i të ardhurave të planifikuara për shumën e tepricës së realizuar të të ardhurave

mbi shpenzimet në planin finansiar për vitin e ardhshëm, nuk bëhet balancimi (pajtueshmëri) i të ardhurave dhe shpenzimeve të nivelit përafërsisht të njëjtë dhe shfrytëzohen të dhënët për të ardhurat e realizuara të përgjithshme vjetore te bartësit e licencave dhe dhënësit e shërbimeve, të marra nga Regjistri Qendror i RMV-së, pa kontrollin dhe analizën plotësuese nga ana e KRRE-së.

- ✓ Komisioni Rregulator i Energjetikës nuk mban evidencë për raportet e pranuara, të rregullta dhe të jashtëzakonshme për punën, që bartësi i licencës ka për detyrë t'i dërgojë. Mosdërgimi i raporteve vjetore për punën nga ana e subjekteve – bartësve të licencave është indikator se KRRE-ja duhet të ndërmerr masa për fillimin e procedurës për marrjen e licencës, nëse përcaktohet se është përm bushur ndonjëri nga kushtet e theksuara në nenin 48 të Ligjit për energjetikë.
- ✓ Në librat e punës, janë evidentuar të ardhurat nga kompensimi vjetor i bartësve të licencave për kryerjen e veprimitarive energetike dhe të ardhurat nga kompensimi i veçantë vjetor i dhënësve të shërbimeve ujore, të përllogaritur dhe të arkëtuar në bazë të të dhënave për të ardhurat e realizuara të përgjithshme të marra nga Regjistri Qendror i RMV-së, pa u bërë krahasimi dhe pajtueshmëria me të dhënat e llogarive vjetore të dërguara në KRRE-në.
- ✓ Janë evidentuar të ardhurat nga licencat dhe të ardhurat nga tarifat për shërbimet ujore, në bazë të mjeteve të paguara në llogarinë e KRRE-së, për të cilën nuk mbahet evidencë e kërkesave të dërguara nga subjektet, sipas së cilave është vendosur ose vepruar nga ana e KRRE-së, baza për pagesën dhe shumën e kompensimit të përllogaritur dhe të arkëtuar, nga bartësit e licencave dhe dhënësit e shërbimeve ujore.
- ✓ Komisioni Rregulator në vitin 2011 ka miratuar Vendim për përcaktimin e nevojës nga ndërtimi i objektit administrativ, përkatësisht blerja e hapësirës afariste, pa vlerën e përcaktuar, burimin e financimit dhe lartësinë e mjeteve të nevojshme për blerjen e hapësirave afariste, në kundërshtim me LPP-në. Gjithashtu, KRRE-ja në mënyrë të pamjaftueshme dhe të paplotë e ka informuar Kuvendin e RMV-së, i cili duhet të jap pëllqim për vlerën e përgjithshme të përcaktuar të hapësirës afariste për nevojat e KRRE-së, mënyrën dhe burimin e financimit dhe lartësinë e mjeteve të nevojshme për realizimin e plotë të investimit të filluar.
- ✓ Para fillimit të procedurës për ndarjen e marrëveshjes shumëvjeçare, në KRRE-në nuk janë planifikuar mjetet në nivel vjetor, përkatësisht në mënyrë joadekuante janë planifikuar mjetet e nevojshme për pjesëmarrjen në ndërtimin e objektit, në planet financiare, për çdo vit të ardhshëm dhe nevoja për hapësirën afariste nuk është përfshirë në planet e veçanta vjetore për prokurime publike, në mënyrë përkatëse me pjesën e planifikuar për realizim, burimin e financimit dhe mjetet e nevojshme në nivel vjetor, në periudhën prej vitit 2012 deri në vitin 2017.
- ✓ Enti Shtetëror i Revisionit ka për obligim të informojë se kundër KRRE-së mbahen dy konteste tregtare dhe dy konteste civile, me vlerë të përgjithshme prej 1.217.619 mijë denarë, nga shkaku që ekziston pasiguri nga rezultati dhe efekti i mundshëm finansiar mbi punën e KRRE-së.

Enti Shtetëror i Revizionit konsideron se është i nevojshëm t'i zbulojë edhe gjendjet si vijon:

- ✓ Mënyrën dhe procedurën e ndërtimit të objektit administrativ "Administrata publike – institucionet shtetërore", për gjashtë institucione, të planifikuar dhe të filluar me realizim si prokurim grupor nëpërmjet SHPPP-së, ndërsa pastaj nëpërmjet koordinatorit të emëruar dhe komisionit të përbashkët për prokurime publike, në periudhën prej vitit 2011 deri në vitin 2017, kanë kontribuar që mos të jenë të plota, mos të jenë me kohë dhe mos t'i respektojnë rregullat ligjore gjatë ndërtimit të objektit, veçanërisht theksohet rritja e çmimit që kushton me m2, lëshimet nga projekti, ndërtimi dhe financimi i objektit, dallimet në sipërfaqen (bruto dhe neto) të objektit të prezantuara në dokumentet e ndryshme, kërkesa për leje për përdorim dhe zgjidhjet e miratuara nga ministria kompetente, masat dhe aktivitetet e pandërmarrë për sigurimin dhe mbrojtjen e pronës – objektit administrativ.
- ✓ Revizioni është i mendimit se nevojitet të bëhet pajtueshmëri i Ligjit për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve ujore dhe Klasifikimit Nacional të Veprimtarive, në pjesën e llojeve të veprimtarive lidhur me shërbimet ujore, që të mund në tërësi dhe me rregull të zbatohet ligji, nga ana e KRRE-së dhe dhënësve të shërbimeve ujore, si dhe të parashihet obligimi për pagesën e kompensimit nga procedura për përcaktimin e tarifës për shërbimet ujore përkatësisht tarifën rregullatore, përkatësisht të përcaktohet afati dhe mënyra e pagesës së tij në rregullativën ligjore.

## NRP RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË

NRP Radiotelevizioni i Maqedonisë e kryen veprimtarinë me interes publik në fushën e radiodifuzionit në RM, që e përfshin prodhimin dhe sigurimin e programeve të radios dhe të televizionit dhe serviseve të programit, përmbushjen e obligimeve, standardeve dhe parimeve të programit në pajtim me Ligjin për veprat audio dhe audiovizuele. RTM-ja si servis radiodifuziv publik në RMV-në, është i pavarur nga cilido organ shtetëror, personi tjetër juridik publik ose shoqëria tregtare dhe duhet në politikën e redaktimit dhe të punës të jetë objektive ndaj tyre.

Me revizionin e rregullshmërisë së RTM-së për vitin 2017, u konstatuan gjendjet si vijon:

- ✓ Sistemi i kontrolleve të brendshme nuk funksionon në mënyrën që do të sigurojë të dhëna relevante dhe të besueshme të kontabilitetit dhe dokumentacion përkatës të kontabilitetit, për ndryshimet afariste në librat tregtarë dhe raportet financiare, që ka të bëjë me vendet e paplotësuara udhëheqëse në sektorët kryesorë, rregulloret e pareviduara, udhëzimet për punën dhe procedurat lidhur me prokurimet publike të Sektorit të Punëve Financiare dhe Sektorit të Tregtisë dhe Prokurimeve Publike. Gjithashtu nuk bëhet kontrolli ex-ante i kontabilitetit i të gjithë dokumentacionit para se të bëhet pagesa, evidentimi dhe arkëtimi i kërkesave dhe evidentimi dhe pagesa e obligimeve që krijon rezik nga shfaqja joreale dhe joobjektive e gjendjeve të mjeteve, kërkesave dhe obligimeve në librat tregtarë dhe raportet financiare të RTM-së. Për këtë gjendje kontribuon edhe mungesa e revizorëve të brendshëm.

- ✓ Në periudhën e deritanishme, nuk janë miratuar një pjesë e akteve nënligjore dhe akteve të përgjithshme të parapara me Ligjin dhe Statutin e RTM-së. Nuk është miratuar Programi për Zhvillim i cili ka ndikim në funksionimin dhe realizimin e detyrate dhe qëllimeve në kryerjen e veprimitarisë me interes publik, në një afat më të gjatë kohor.
- ✓ Në zbatim është Rregullorja e politikave të kontabilitetit, nga viti 2005, e cila është ndryshuar në vitin 2011 dhe vitin 2012 në pjesën e paraqitjes së të ardhurave nga taksa radiodifuzive (TRD), megjithatë prej atëherë dhe deri më sot, nuk është bërë revidimi në mënyrën dhe metodën e mbajtjes së politikave të kontabilitetit në pajtim me parimet, bazat, rregullat dhe praktikat specifike që i zbaton subjekti gjatë përgatitjes dhe prezantimit të raporteve financiare.
- ✓ Në vitin 2015, është zbatuar procedura e ngarkimit me kredi dhe lënien peng të pronës dhe mjeteve, te banka komerciale vendore, në bazë të vendimeve të miratuara nga ana e Këshillit të Programit dhe Këshillit Mbikëqyrës. Revizioni ka për obligim të theksojë se me mënyrën dhe procedurën e tillë të ngarkimit me kredi dhe lënien peng të pronës dhe mjeteve për shkak të sigurimit të kredisë, nëpërmjet vendimeve të miratuara të Këshillit të Programit dhe Këshillit Mbikëqyrës, për çështjet për të cilat nuk kanë kompetencë të vendosin, nuk është në pajtim me rregullat ligjore.
- ✓ Në vitin 2013, ishte lidhur marrëveshja për riprogramin e borxhit të RTM-së kundrejt Ministrisë së Financave, për marrien e kredisë në bazë të kredive të shfrytëzuara nga Klubi i Parisit dhe i Londrës i Kreditorëve, edhe pse paraprakisht nga ana e Qeverisë së RMV-së ishte miratuar vendimi për shlyerjen e kërkesave nga RTM-ja në vitin 2011, ndërsa në vitin 2012 ky vendim ishte anuluar. Edhe krahas riprogramimit të lejuar të borxhit për pagesën e kësteve, në një periudhë të gjatë kohore, obligimet dhe këstet e kontraktuara nuk paguhen nga ana e RTM-së, që çoi në procedurë gjyqësore, me të cilën pasoi, përvëç borxhit kryesor edhe kamata.
- ✓ Te furnizimi i veprave audio dhe audiovizuele përkatësisht përbajtjeve të programit, nuk respektohen dhe zbatohen dispozitat e rregullave të përkufizuara në aktin intern të RTM-së, nuk ekziston dokumentacion i plotë për ofertat e dërguara për një lloj të caktuar të furnizimit ose blerjes sipas konkurseve të shpallura publike, ofertat nuk janë shqyrtuar nga ana e Komisionit dhe nuk është bërë zgjedhja e këtyre ofertave, përkatësisht shqyrtohet propozimi i zgjedhur nga ana e kryeredaktorit të servisit të programit (i parë dhe i dytë), për të cilën jepet mendimi pozitiv.
- ✓ Për shkak të mospasjes së të dhënave për tokën të evidentuar në vitin 2004, për bilansin e ndarjes nga viti 1998, ndërmarrja jo me kohë e masave për privatizimin e tokës ndërtimore lidhur me shtëpinë e RTV-së nga ana e RTM-së, pasiguria nga rezultati i kontestit administrativ që është në rrjedhë me AKP-në, në lidhje me përcaktimin e statusit të pronësisë së objekteve, si dhe për shkak të urdhëresave të dërguara për përbartim mbi pronën e patundshme të RTM-së për arkëtimin e kërkesës në para, revizioni nuk është bindur në realitetin dhe objektivitetin e gjendjes së mjeteve materiale në raportet financiare dhe ekziston pasiguria në lidhje me atë nëse prona (toka dhe pjesa e objekteve ndërtimore) të prezantuar në librat tregtarë dhe raportet financiare, do të mbetet në pronësinë e RTM-së.

- ✓ Deri në gusht 2017, Qeveria e RMV-së ka shfrytëzuar hapësirë mediatike me shenjën „emetim falas“, për të cilat mjete nuk janë paguar mjetet e RTM-së, ndërsa në Ligjin dhe në Listën e Çmimeve për shërbimet e marketingut ose në aktin tjetër të përgjithshëm, nuk është përkufizuar se çka nënkuptohej me këtë nocion dhe kush mund ta shfrytëzojë hapësirën mediatike me shenjën „emetim falas“ në radiodifuzerin publik.
- ✓ Te kompensimi për koproduktionet, lidhen marrëveshjen në bazë të vlerës së të kushtuarit të projektit të theksuar në fletëparaqitjen e koproducentit, pa pasqyrë dhe përshkrim të plotë të aktiviteteve sipas zërave dhe llojeve të shpenzimeve në RTM.
- ✓ Gjatë viteve 2015, 2016 dhe 2017, ishin miratuar vendimet dhe konkluzionet nga ana e drejtorit dhe Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së, për lëshimin falas të të drejtave për emetim (TV dhe radio) të programit dokumentar (prodhimi personal, dhe në koproduksion) të radiodifuzerëve ekzistues në RMV-në, si dhe të organeve dhe institucioneve tjera shtetërore. Ministria e Transportit dhe Lidhjes, SHPPP, ELS, Qeveria e RMV-së dhe një subjekt juridik.

ESHR-ja ka për obligim t'i zbulojë gjendjet si vijon:

- ✓ RTM-ja është e ngarkuar me detyrimet rrjedhëse, kreditë dhe huat, tatimin mbi fitim, TVSH-në dhe kontestet e humbura gjyqësore, në shumë evidente, për këtë shkak radiodifuzeri publik në vitet e fundit nga puna e vet, gjendet në një gjendje të pavolitshme financiare, ndërsa nga korriku 2017, deri në ditën e revizionit, RTM-ja është me llogari të bllokuar dhe me minimum mjete të caktuara në nivel më i madhi që janë të domosdoshme për ta kryer veprimtarinë, në bazë të aktvendimit të miratuar nga gjykata kompetente.
- ✓ Gjithashtu, gjatë vitit 2013, RTM-ja ka ndërmarrë obligimet kundrejt EBU-së për t'i blerë të drejtat (licencat) për emetimin e ngjarjeve sportive dhe ngjarjeve tjera, me karakter komersialisht, ndërsa për të cilat RTM-ja ishte e ngarkuar të paguajë kompensim në këste, në periudhën prej 1.01.2014 deri më 31.12.2023, me ç'rast para se të ngarkohet, organi i mbajtjes së punës i RTM-së, ka pasur për detyrë të sigurojë burim të qëndrueshëm të financimit të detyrimeve.
- ✓ RTM-ja ndërmori obligime për blerjen e të drejtave (licencave) për emetimin e filmave dhe serialeve, në periudhë të caktuar kohore (dy ose tri vjet), që janë nga vendet e huaja, paraprakisht pa bërë analizë financiare për fitimin ekonomik, përkatësisht mbulimin e shpenzimeve.
- ✓ Për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara u janë dhënë rekomandime personave dhe organeve kompetente.

# INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE

Veprimitaria shëndetësore është veprimitaria me interes publik dhe kjo kryhet në nivel primar, sekondar dhe terciar të mbrojtjes shëndetësore nga ana e institucioneve shëndetësore private dhe publike.

Me Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2018 ishin përfshirë një varg institucionesh shëndetësore publike në nivel të ndryshëm.

Me revisionin e kryer të rregullshmërisë për vitin 2017 në ISHP të caktuara u konstatua se në pjesën më të madhe të gjendjeve të konstatuara përsëriten sikurse edhe në periudhat paraprake të raportimit. Gjendjet e konstatuara, mes tjerash, kanë të bëjnë me:

- ✓ parregullsitë e konstatuara në sistemin e kontolleve interne i cili duhet të sigurojë bindje të arsyeshme për arritjen e qëllimeve të institucioneve shëndetësore publike në lidhje me besueshmërinë e njoftimit financiar, efektivitetin dhe efikasitetin e punës dhe pajtueshmërin me ligjet dhe rregullat e aplikueshme;
- ✓ mosndërmarrjen e aktiviteteve nga ana e ministrisë kompetente për dhënien e instrukSIONEVE dhe pëlqimeve me kohë të statuteve të institucioneve shëndetësore publike si bazë për miratimin e akteve për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës;
- ✓ emërimin e ushtruesve të detyrës drejtor i ISHP-së për periudhën më të gjatë se afatet e përcaktuara ligjore;
- ✓ mungesën e marrëveshjes së lidhur të menaxherit për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella ndërmjet ministrit të Shëndetësisë dhe ushtruesit të detyrës drejtor i ISHP-së;
- ✓ veprimin joadekuatë me mjetet në para të arkëtuara në dorë për shërbimet e kryera shëndetësore. Për gjendjet e konstatuara të cilat janë të rëndësishme sipas natyrës së tyre, revizori i autorizuar shtetëror për ISHP-të e caktuara i dërgoi raportet e revizionit në procedurë të mëtejshme në organet kompetente;
- ✓ pamundësinë e konfirmimit të mjetetëve të përgjithshme të arkëtuara dhe paraqitjen e tyre si të ardhura në raportet financiare;
- ✓ parregullsitë në mënyrën e zbatimit të kontolleve klinike në ISHP-të ku kryhen kontrolllet klinike dhe mënyrën e ndarjes së mjetetëve;
- ✓ mungesën e evidencës së vendosur të pajisjes mjekësore dhe sistemit të vendosur efikas të ndjekjes dhe mirëmbajtjes së saj;
- ✓ pajtueshmërin e plotë dhe të drejtë të vlerës dhe sasisë së mjetetëve;
- ✓ prezantimin e gjendjes reale të rezervave, si dhe shpenzimin e tyre gjatë vittit;
- ✓ mosndërmarrjen e aktiviteteve për arkëtimin me kohë të kërkesave për shërbimet e kryera shëndetësore dhe
- ✓ zbatimin jokonsekuent të dispozitave të Ligjit për prokurime publike në procedurat për ndarjen e marrëveshjeve për prokurime publike, anulimin e dokumentacionit dhe ndjekjen e realizimit të marrëveshjeve të lidhura.

Për gjendjet e konstatuara nga ana e revisionit janë dhënë rekomandimet për të vepruar, ndërsa zbatimi i tyre nga ana e organeve kompetente dhe personave përgjegjës në shërbimet shëndetësore publike përfshin do të kenë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të dhëna për qytetarët.

Për gjendjet e konstatuara dhe rekomandimet e dhëna të përmbajtura në raportet e revisionit, Ministria e Shëndetësisë dërgoi mendim me informata për aktivitetet që do të ndërmerrin duke i përfshirë edhe informatat për mënyrën e zgjedhjes së drejtorit të ISHP-së, lidhjen e marrëveshjeve të menaxherit dhe parashtimin e fletëparaqitieve përkatëse tek organet kompetente.

Revizori i autorizuar shtetëror në raportet e revizionit të ISHP-së të cilat ishin lëndë e revizionit në pjesën e zbulimit i theksoi gjetjet të cilat përsëriten vazhdimisht për planifikimin joadekuatë të programeve të veçanta nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë me ç'rast mjetet e përcaktuara në to janë në vëllim më të vogël se vëllimi i aktiviteteve të përcaktuara dhe vlera e shërbimeve të kryera nga ana e ISHP-së me çka bëhet përkeqësimi i vazhdueshëm i punës financiare të ISHP-së që nga ana tjetër ndikon në cilësinë e shërbimeve të dhëna.

Gjithashtu është bërë prezantimi i lëshimeve të konstatuara sistemore në pjesën e niveleve të vendeve të punës dhe mënyrën e përcaktimit të rrogave dhe shtesave të rrogës, si dhe mosbatimin e përllogaritjes së „sistemit të përllogaritjes së rrogës të bazuar në rezultatet e punës së punëtorit dhe efikasitetit të shfrytëzimit të orarit të punës“.

Duke vepruar sipas lëshimeve të konstatuara sistemore, Kuvendi i RMV-së me propozim të Qeverisë, në seancën e mbajtur më 28 janar 2019 miratoi Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen shëndetësore me të cilin, mes tjerash, bëhet rregullimi shtesë i dispozitave të nenit 219 të ligjit në fjalë, përkatësisht ndërpritet parimi i pagesës sipas rezultatit të punëtorëve shëndetësorë dhe rrogës themelore dhe pjesa për sukses do të përcaktohet në pajtim me marrëveshjen kolektive për veprimtarinë shëndetësore.

Gjithashtu, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2019 miratoi një varq konkluzionesh, në mesin e të cilave edhe:

1. Ingarkoi „Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës të gjejnë mënyrë / zgjidhje për pajtueshmërin e niveleve të konstatuara të vendeve të punës të përcaktuara në Ligjin për mbrojtjen shëndetësore, aktet për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në institucionet shëndetësore publike dhe Marrëveshjen Kolektive për veprimtarinë shëndetësore“.
  2. I ngarkoi të gjitha ministritë që në të ardhmen kur do të dërgojnë informata për masat e ndërmarra detyrimisht të dërgojnë edhe prova me shkrim për aktivitetet e ndërmarra.
  3. Në përgjithësi për të gjitha raportet e dërguara të revizionit për ISHP-në që janë lëndë e revizionit, Qeveria i ngarkoi të përpilojnë plan aksional me aktivitetet, afatet dhe bartësit e përkufizuar në mënyrë të qartë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportet përfundimtare të revizionit të autorizuar shtetëror.

## ARSIMI I LARTË

Në vitin 2018, Enti Shtetëror i Revizionit në pajtim me programin e punës, bëri revizionin erregullshmërisë për vitin 2017 të Universitetit të Tetovës.

Ky universitet është themeluar me Ligjin për themelimin e Universitetit Shtetëror të Tetovës, si institucioni më i lartë autonom, shkencor, përkatësisht artistik i arsimit të lartë. Me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e Universitetit Shtetëror të Tetovës, Universiteti Shtetëror i Tetovës riemërohet në Universiteti i Tetovës.

Në përbërjen e universitetit hyjnë fakultetet publike të cilat kryejnë veprimitari të arsimit të lartë dhe veprimitari hulumtuese shkencore në të gjitha shkallët e arsimit të lartë.

Universiteti i Tetovës dhe njësitë e universitetit janë themeluar nga Kuvendi i RMV-së. Universiteti dhe njësitë e universitetit e kryejnë veprimtarinë mbi parimin e autonomisë akademike.

Me revizionin e raporteve financiare dhe revizionin e pajtueshmërisë, janë konstatuar gjendjet si vijon:

- ✓ Për shkak të kuadrit të pamjaftueshëm shkencor mësimor i cili është në marrëdhënie të rregullt të punës, Senati Universitar në përbërjen e tij nuk e ka numrin e nevojshëm të anëtarëve, ndërsa Këshilli Universitar nuk është themeluar, në pajtim me dispozitat ligjore.
- ✓ Te një pjesë e kandidatëve për zgjedhjen në titujt shkencorë mësimorë nuk mundëm të bindemi në përbushjen e kritereve të parapara në Rregulloren e kritereve dhe procedurën për zgjedhjen e titujve mësimorë – shkencorë, shkencorë, mësimorë profesionalë dhe bashkëpunëtorëve dhe asistentëve – doktorantëve. Në vendimet për zgjedhjen e titullit mësimor shkencor nuk është theksuar periudha për të cilën bëhet zgjedhja, ndërsa me personat e zgjedhur nuk janë lidhur marrëveshjet për t'i punësuar në titullin për të cilin janë zgjedhur. Gjatë revizionit është bërë pajtueshmëria e Rregullores, ndërsa me çdo person të kuadrit mësimor shkencor dhe bashkëpunëtorit është lidhur marrëveshja në titullin në të cilin është zgjedhur.
- ✓ Objektet që i shfrytëzon Universiteti për punën e vet ende janë në procedurën e legalizimit dhe regjistrimit të së drejtës së shfrytëzimit. Pajisja e furnizuar nuk evidentohet në llogaritë përkatëse të përcaktuara për çdo lloj të pajisjes, nuk përllogaritet amortizimi vjetor i mjeteve materiale, për pranimin dhe lëshimin e materialeve është vendosur evidenca materiale, por jo edhe evidenca e kontabilitetit dhe nuk është bërë regjistrimi i mjeteve dhe burimeve të mjeteve. Pajisja e furnizuar nuk evidentohet në pozicionet përkatëse të bilancit, nuk përllogaritet amortizimi vjetor i mjeteve materiale, për pranimin dhe shpenzimin e materialeve është vendosur evidenca materiale, por jo evidenca e kontabilitetit dhe nuk është bërë regjistrimi i mjeteve dhe burimeve të mjeteve. Kthimi jo me kohë i borxhit të avancave të dhëna për udhëtimet zyrtare dhe mosndërmarrja e masave për arkëtimin e tyre ka kontribuar për të parashkruar një pjesë të kërkësave. Te një pjesë e furnizimeve të mallrave nuk është respektuar në tërësi Ligji për prokurime publike.
- ✓ Ndarja e mjeteve në bazë të participimit dhe bashkëfinancimit për të studiuar bëhet sipas Rregullores për ndarjen e brendshme të financave e cila edhe pse ishte dërguar në

ministrinë kompetente për punët nga sfera e arsimit të lartë, kjo deri në ditën e revizionit nuk ishte miratuar. Për të realizuar procesin arsimor për programet e akredituara studimore, universiteti angazhon mësimdhënës me kontratë për dhënien e shërbimeve intelektuale që përfshin 39% të kuadrit mësimor, me ç'rast një pjesë e personave që e kryejnë realizimin e mësimit nuk kanë titull shkencor mësimor, ndërsa personat e angazhuar si kuadër i bashkëpunëtorit janë me obligime të punës që nuk përkijnë me obligimet pedagogjike për kuadrin e bashkëpunëtorit.

Lidhur me të theksuarën, sugjeruam se personat përgjegjës të Universitetit duhet të ndërmarrin aktivitete për: respektimin konsekuent të dispozitave ligjore gjatë lidhjes së marrëveshjeve për dhënien e shërbimeve intelektuale gjatë zhvillimit të mësimit, provimeve, ushtrimeve me mësimdhënësin dhe kuadrin e bashkëpunëtorit, evidentimin e kontabilitetit të mjeteve materiale dhe jomateriale, përllogaritjen e amortizimit vjetor, evidentimin e kontabilitetit të pranimit dhe shpenzimit të materialeve, zbatimin e regjistrimit të mjeteve dhe burimeve të mjeteve, arkëtimin e kërkeseve për të cilat ekziston baza ligjore, si dhe shfrytëzimin racional dhe efikas të mjeteve buxhetore gjatë prokurimeve të mallrave dhe shërbimeve nëpërmjet zbatimit konsekuent të procedurave të përcaktuara me Ligjin për prokurime publike.

Në pjesën Theksimi i çështjeve për pasiguri ose vazhdimësi, revizioni thekson se mospasja e kuadrit shkencor mësimor në Fakultetin e Bujqësisë dhe Bioteknologjisë është shkaku i mospasjes së këshillit shkencor mësimor si organ profesional i fakultetit dhe mosemërimi i dekanit të fakultetit që mund të ketë ndikim mbi gjithë punën e tij dhe funksionimin e drejtë.

Në pjesën Çështjet tjera revizioni konsideron se është i nevojshëm të zbulohet se deri në ditën e revizionit, Kuvendi i RMV-së me propozim të Qeverisë nuk ka miratuar Program për veprimtarinë e arsimit të lartë, me të cilin përcaktohen mjetet për financimin e universiteteve publike dhe studimeve me interes publik nga Buxheti i RMV-së dhe nga burimet tjera, të caktuara me ligj. Me Ligjin e ri për arsim të lartë të miratuar në muajin maj të vitit 2018, Këshilli Nacional duhet të formohet në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, ndërsa miratimi i akteve të parapara me Ligjin duhet të jetë më së voni në afatin prej gjashtë muajsh nga dita e formimit të tij.

## ZGJEDHJET LOKALE 2017

Mandati dhe kompetencat e Entit Shtetëror të Revizionit lidhur me aktivitetet e pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore janë rregulluar në Kodin Zgjedhor. Në pajtim me Programin Vjetor të Punës për vitin 2018, u bënë revisionet e raporteve financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të pesëmbëdhjetë pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore për zgjedhjet lokale, të mbajtura në tetor të viti 2017.

Me revisionet e kryera te pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore, i konstatuam gjendjet të cilat nuk janë në pajtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor që kanë të bëjnë me:

- ✓ zbatimin jokonsekuent të afateve për dërgimin e raporteve për të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara në procesin zgjedhor,
- ✓ mosrespektimin e afatit për mbylljen e llogarive të transaksionit,
- ✓ financimin e fushatës zgjedhore me mjetet të cilat nuk janë paraparë si burime për të financuar fushatën zgjedhore në rregullativën ligjore,
- ✓ mossigurimin e dokumentacionit të plotë të mbështetjes për një pjesë të faturave për shpenzimet e bëra.

Si pjesë e institucioneve që kanë kompetenca dhe obligime lidhur me procesin zgjedhor i konstatuam gjendjet që kanë ndikim mbi mundësinë për vërtetimin e plotë të shpenzimeve të deklaruara për procesin zgjedhor, ndërsa kanë të bëjnë me:

- ✓ mënyrën e monitorimit përkatësisht konceptin e ndjekjes së prezantimit politik të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor nga ana e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele bëhet me zgjedhjen e ekzemplarit për një pjesë të medieve dhe një pjesë të radiodifuzerëve, për shkak që të dhënat për hapësirën e shfrytëzuar të reklamës gjatë kohës së fushatës zgjedhore nuk janë të plota dhe komplete;
- ✓ dallimet e konstatuara ndërmjet të dhënavë të deklaruara në raportet e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për ndjekjen e reklamimit të paguar politik për zgjedhjet lokale 2017 për të dyja rrethet zgjedhore me të dhënat e deklaruara në raportet e dërguara nga radiodifuzerët për hapësirën e shfrytëzuar të reklamës nga ana e pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore;
- ✓ të dhënat për prezantimin e paguar politik të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore, të deklaruara nga ana e radiodifuzerëve në raportet e dërguara në planet e bashkëngjitura të medieve nuk janë identike me të dhënat në raportet e dërguara për hapësirën e shfrytëzuar të reklamës;
- ✓ joplotësinë e konstatuar të dokumentacionit te një pjesë e radiodifuzerëve, lidhur me reklamimin e paguar politik përkatësisht raportet e padërguara për hapësirën e shfrytëzuar të reklamës, listat e çmimeve për reklamimin e paguar politik, faturat dhe planet e medieve.

Në raportet përfundimtare për pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore zbuluam se gjatë viteve 2017 dhe 2018 ishin bërë disa ndryshime dhe plotësime të Kodit Zgjedhor, me të cilat një pjesë e madhe e lëshimeve të konstatuara sistemore në raportet përfundimtare të revizionit të autorizuar shtetëror për proceset zgjedhore paraprake, ishin tejkaluar.

Por edhe kahas kësaj, sugjerojmë se ndryshimi i Kodit Zgjedhor nga viti 2018, me të cilën ishte dhënë mundësia për transferin e mjeteve ndërmjet llogarive të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore, duhet të saktësohet në mënyrë plotësuese përkatësisht të rregullohet nëse mjetet e transferuara paraqesin burim të financimit të fushatës zgjedhore ose pjesëmarrësit kanë për obligim t'i kthejnë mjetet në llogarinë e partisë politike për punën e rregullt përkatësisht në llogaritë e veçanta për mjetet e siguruara nëpërmjet kredisë, si dhe të rregullohet mënyra dhe afatet për kthimin e mjeteve të transferuara.

Gjithashtu, e konstatuam nevojën nga pajtueshmërisë në Kodin Zgjedhor, në pjesën:

- ✓ në nenin 76-d është rregulluar se pagesa e mjeteve financiare për reklamimin politik të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore të radiodifuzerëve, medieve të shtypit dhe medieve elektronike bëhet nga mjetet e Buxhetit të RMV-së, edhe pse në nenin 83 është përcaktuar se fushata zgjedhore nuk guxon të financohet me mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë;
- ✓ afati për pagesën e donacioneve, si burim i financimit të fushatës zgjedhore është më i gjatë se afati për mbylljen e llogarisë së transaksionit, të parapara me nenin 71 në Kodin Zgjedhor;
- ✓ në kushtet kur reklamimi politik i pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore të radiodifuzerëve, medieve të shtypit dhe medieve elektronike bëhet nga mjetet e Buxhetit të RMV-së, imponohet nevoja nga rishqyrtimi i afateve për mbylljen e llogarive të transaksionit për fushatat zgjedhore, të përkufizuara me nenin 71, përkatësisht tri muaj për zgjedhjet parlamentare ose presidenciale dhe nëntë muaj në kushtet e zgjedhjeve lokale.

Në drejtim të transparencës së shpenzimeve të përgjithshme në proceset zgjedhore, e konstatuam nevojën nga përcaktimi i obligimit për personat juridikë që ekonomizojnë me panotë dhe bilbordet e reklamave, komunat dhe Qyteti i Shkupit, të përpilojnë dhe dërgojnë raport për panotë dhe bilbordet e shfrytëzuara të reklamave dhe mjetet të cilat janë paguar ose kërkohen në atë bazë nga pjesëmarrësit në fushatat zgjedhore.

## VETËQEVERISJA LOKALE

Gjatë vitit 2018, ishte bërë revizioni i rregullshmërisë për vitin 2017, te 11 njësi të vetëqeverisjes lokale: Haraçin, Bogovinë, Veles, Gjorçe Petrov, Kisella Vodë, Makedonski Brod, Negotinë, Ohër, Shtip, Shën Nikollë dhe Çashkë me ç'rast janë konstatuar gjendjet si vijon:

- ✓ Gjatë vlerësimit të sistemit të kontrolleve të brendshme, në procese të veçanta, te një pjesë e komunave të reviduara, përcaktohet se nuk është vendosur dhe nuk funksionon në procesin e grumbullimit të të ardhurave dhe realizimit të shpenzimeve dhe në procesin e planifikimit të buxhetit të komunës, për çka ekziston rreziku i mosplotësisë së të ardhurave te tatimet mbi pronë dhe taksën komunale për të theksuar firmën, si dhe rrezik nga miratimi i buxhetit joreal. Gjithashtu, janë konstatuar lëshimet në funksionimin e aplikimeve për punën financiare dhe tatimore për çka ekziston rreziku i paraqitjes së të dhënave të pabesueshme ose humbjes së të dhënave, si dhe mos pajtueshmërin e evidencës së kontabilitetit dhe evidencës tatimore.
- ✓ Te një pjesë e madhe e njësive të reviduara të vetëqeverisjes lokale, e pranishme është dukuria e lëshimit evident ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara të buxhetit, ndërsa për të nuk është miratuar rebalansi (ndryshimet dhe plotësimet e buxhetit), ose edhe krahas rebalancit të miratuar të buxhetit nuk është bërë pajtueshmëria e tyre, që krijon mundësinë e ndërmarrjes së obligimeve për të cilat realisht nuk janë siguruar mjetet në buxhet dhe bartja e tyre në vitin e ardhshëm fiskal. Për këtë dukuri të buxhetimit joreal te një pjesë e njësive të vetëqeverisjes lokale, Enti Shtetëror i Revizionit njoftoi në shumë raste përvèç në raportet e njësive të veçanta të vetëqeverisjes lokale, gjithashtu, njoftoi edhe në raportet vjetore.

Në nëntor 2018, ishte bërë plotësimi i Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, me të cilën caktohet korniza në të cilën mund të planifikohet dhe miratohet buxheti i komunës, përkatësisht në Ligj është theksuar se të ardhurat personale të buxhetit themelor të komunës mund të planifikohen me rritjen prej më së shumti 10% të të ardhurave të realizuara mesatarisht në tri vitet e fundit, sipas të dhënave të evidencës së thesarit. Me përjashtim, komuna mund ta tejkalojë shumën maksimale të të ardhurave të planifikuara personale të buxhetit themelor vetëm nëse ka siguruar vërtetim për transferin e mjeteve nga institucioni përkatës ose në rast të ndryshimeve që kanë të bëjnë me lartësinë dhe llojin e të ardhurave personale të buxhetit themelor, të përcaktuara me ligj, në bazë të Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit të komunës të miratuar nga Këshilli i komunës. Me zgjidhjen e këtillë ligjore dhe zbatimin e tij, mundësohet planifikimi real i të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetin e komunave.

- ✓ Te një pjesë e njësive të reviduara të vetëqeverisjes lokale, buxheti nuk përbani pjesë zhvillimore, përkatësisht plan të programeve për zhvillim, nuk janë miratuar programet vjetore për rregullimin e tokës ndërtimore dhe për punë në fushën e disponimit me tokën ndërtimore,

pronësi të RMV-së, nuk janë përpiluar raportet vjetore për shfrytëzimin e mjeteve nga kompensimi për përcaktimin e statusit juridik të objekteve të ndërtuara pa leje, ndërsa raportet vjetore për punën e komunës për vitin 2017, nuk janë të plota. Gjithashtu, te një pjesë e tyre, nuk janë vendosur ose në mënyrë joadekuat mbahen regjistrat e pronës së patundshme dhe të tundshme të obliguesve tatimore, nuk është realizuar ose jo plotësisht është realizuar regjistrimi i kërkesave (baza juridike dhe struktura e moshës), nuk janë paraqitur në mënyrë reale kërkesat në bazë të kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore, tatimet mbi pronë dhe taksat komunale në librat e punës dhe raportet financiare, nuk ndërmerren me kohë masat dhe aktivitetet për arkëtimin e kërkesave për çka një pjesë e tyre parashkruhen dhe nuk ekziston mundësia për arkëtimin e tyre, ndërsa te disa komuna nuk realizohen të ardhurat nga kompensimi për mbajtjen e pastërtisë publike, dhe të ardhurat nga taksat komunale për shfrytëzimin e muzikës në lokalet publike, për paraqitjen e reklamave, publikimeve dhe konkurseve në vendet publike dhe për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik.

- ✓ Te një pjesë e madhe e njësive të reviduara të vetëqeverisjes lokale, janë konstatuar rastet e mosrespektimit të rregullave ligjore dhe akteve interne, me ç'rast te një pjesë e tyre gjendjet përsëriten me vite të tëra, ndërsa kanë të bëjnë me mënyrën e mbajtjes së librave të punës, dokumenteve të kontabilitetit, regjistrimin, prezantimin e të dhënave në raportet financiare, shpenzimet kapitale, pagesën e mjeteve në baza të ndryshme, siç janë:
  - Mjetet materiale dhe jomateriale, si dhe mjetet në përgatitje (investimet në rrjedhë), nuk janë paraqitur në mënyrë reale dhe objektive në librat e punës dhe raportet financiare.
  - Për një pjesë të pronës së patundshme (tokat dhe objektet) nuk është regjistruar e drejta e pronësisë, ndërsa për një pjesë të tyre, për të cilat kanë dokument, nuk janë evidentuar ose në mënyrë joadekuat janë evidentuar në librat e punës.
  - Nuk mbahet evidencia materiale për pranimin dhe lëshimin e materialeve.
  - Nuk është realizuar regjistrimi i plotë dhe cilësor i mjeteve dhe obligimeve, që ka të bëjë me pronën me të cilën disponon komuna, siç janë: toka, objektet ndërtimore, mjetet materiale në përgatitje (investimet në rrjedhë) dhe obligimet që janë ndërmarrë.
  - Te lloje të caktuara të shpenzimeve, nuk është bashkëngjitur dokumentacioni përkatës i mbështetjes gjatë pagesës së mjeteve, siç janë: shpenzimet për lëngën djegëse të shpenzuar, riparimet e automjeteve, mirëmbajtjen rrjedhëse të rrugëve urbane dhe ndérurbane, shpenzimet për materialet tjera, shërbimet juridike, shërbimet tjera kontraktuese, shërbimet e konsultimit, reprezentacioni, etj.
  - Te shpenzimet kapitale – ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugëve urbane dhe ndérurbane, nuk respektohen dispozitat e Ligjit për ndërtim, që kanë të bëjnë me mbajtjen joadekuat të ditarit ndërtimor dhe librit ndërtimor, dokumentet e pasiguruara për ndërtim dhe vëniën e objektit në përdorim, pa kryerjen e kontrollit teknik dhe procesverbalin për pranim-dorëzim.
  - Në disa komuna, mjetet u janë ndarë klubeve sportive dhe shoqatave, pa konkurs të shpallur publik, pa i përcaktuar kriteret, ndërsa për mjetet e shpenzuara nuk janë dërguar raportet dhe dokumentacioni nga ana e shfrytëzuesve të mjeteve.

- Bëhen pagesat për angazhimin e personave nëpërmjet agjencive për punësimet të përkohshme, për kryerjen e detyrave të rregullta të punës edhe për periudhën më të gjatë se një vjet, në kundërshtim me Ligjin, ndërsa te një pjesë e komunave, ky numër e tejkalon edhe numrin e të punësuarve të rregullt.
  - Gjatë zbatimit të procedurave për prokurime publike, të mallrave, shërbimeve ose sendeve, joplotësish respektohen dispozitat e Ligjit për prokurime publike.
  - Nuk ndiqet realizimi i marrëveshjeve për mallrat, shërbimet dhe sendet e furnizuara, nga aspekti i sasisë, çmimit dhe vlerës, janë lidhur anekse të marrëveshjeve për punë të paparapara dhe plotësuese pas afatit të kaluar kohor dhe nuk ndërmerr masa me kohë në pajtim me marrëveshjet, në rast të vonesës me realizimin nga ana e operatorit të zgjedhur ekonomik.
- ✓ Rastet më karakteristike të mosrespektimit të rregullativës ligjore janë konstatuar tek komunitati vijon:
- Në Komunën e Ohrit, objekti – ndërtimi plotësues i godinës së komunës, shfrytëzohet nga ana e administratës komunale, edhe pse ende nuk është bërë kontrolli teknik, nuk është bërë pranim-dorëzimi dhe nuk është lëshuar leja për përdorimin e objektit.
  - Në Komunën e Negotinës, gjatë ndërtimit të objektit për rinvimin e ujësjellësit dhe ndërtimin e rezervuarit të ujit, nuk janë respektuar kushtet e përcaktuara në marrëveshje, objekti nuk ka përfunduar plotësisht, ndërsa inxhinieri mbikëqyrës ka përpiluar raport për kontrollin teknik me të cilin nuk janë konstatuar mangësitë dhe ndërtimi mund të jetet në përdorim.

Me qëllim të përmirësimit të gjendjeve, revizioni rekomandoi për ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve për shkak të tejkalimit të gjendjeve të konstatuara.

Me revizionin u zbuluan gjendjet që mund të ndikojnë në punën e mëtejshme të komunave, që janë lëndë e revizionit, ndërsa të cilat kanë të bëjnë me:

- ✓ Në komunë e Ohrid, revizioni nuk është bindur në besueshmërinë e procedurës për lëshimin e lejes për ndërtimin e kompleksit të hotelit dhe e theksos gjendjen me lëndët gjyqësore, në bazë të detyrimeve të papaguara, në shuma jashtëzakonisht të mëdha, të cilat kanë përfunduar dhe për të cilat janë lëshuar zgjidhjet ekzekutive, si dhe lëndët gjyqësore, që janë në rrjedhë, për të cilat ekziston pasiguri nga rezultati final, me mundësinë e ngarkimit plotësues të buxhetit të komunës, për kamata dhe shpenzime plotësuese.
- ✓ Në komunë e Çashkës, nuk ka dokumentacion përkatës dhe të dhëna për të ardhurat e realizuara nga koncesionet e dhëna (uji, prodhimi i energjisë elektrike dhe lëndët e para minerale) që të mund të bëhen projekcionet reale për të ardhurat e planifikuara në këtë bazë në periudhën e ardhme.
- ✓ Në komunë Shtip, ndërtohet objekti i cili nuk është në pajtim me projektin dhe dokumentacionin e verifikuar teknik dhe bëhet shitja e parcelave në të cilat ekzistojnë objekte ekzistuese të ndërmarrjes publike.

Gjithashtu, revizioni i zbuloi lëshimet sistemore në rregullativën ligjore përkatësisht për shkak të paqartësive në ligje të caktuara, komunat nuk kanë inspektim në plotësinë dhe saktësinë e të ardhurave të realizuara që kanë të bëjnë me:

- ✓ Taksën komunale për shfrytëzimin e rrugëve me mjetet motorike, për të cilën nuk është përcaktuar në cilat afate personat juridikë të autorizuar për regjistrimin e automjeteve kanë për obligim ta paguajnë takën e arkëtuar në llogari të komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit.
- ✓ Taksën komunale për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik, për të cilën nuk është përcaktuar obligimi i shoqërisë tregtare që është kompetente për shpërndarjen e energjisë elektrike e cila bën arkëtimin e taksës nga pronarët e orëve elektrike, t'i njoftojë komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit për numrin e obliguesve sipas kategorive (numri i orëve elektrike) në pajtim me numrin tarifor, si dhe për të ardhurat e arkëtuara dhe kërkesat e paarkëtuara në këtë bazë.
- ✓ Raportet e Qytetit të Shkupit, në bazë të së cilave komunat në qytet i evidentojnë kërkesat (e rregullta, të dyshimta dhe kontestuese) në bazë të tatimit mbi qarkullim dhe taksës komunale (taksës së firmës), nuk përmبajnë dokumentacion të plotë për kërkesat e dyshimta dhe kontestuese dhe masat e ndërmarra për arkëtimin e tyre.
- ✓ Obligimin ligjor për pajtueshmërin e gjendjes së regjistrit të patundshmërive me regjistrin të cilin e mban Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- ✓ Në Ligjin për zjarrfikje, parashihen dispozitat për pagesën e kompensimeve të caktuara në buxhetin e komunave, por nuk është saktësuar në çfarë mënyre komunat do të kenë inspektim në plotësinë dhe saktësinë e mjeteve të paguara.
- ✓ Mos pajtueshmërin e Rregullores për shkallën e rregullimit të tokës ndërtimore me objektet e infrastrukturës komunale dhe mënyrën e përcaktimit të lartësisë së shpenzimeve për rregullim në varësi nga shkalla e rregullimit me Ligjin për ndërtim, Ligjin për kadastër të patundshmërive dhe Rregulloren për rimatjen dhe përpunimin e të dhënavë nga rimatja.

Lëshimet sistemore të theksuara paraprakisht, të cilat revizioni i zbuloi në raportet e veta vjetore edhe në periudhën e kaluar, kanë implikime financiare në punën e njësive të vetëqeverisjes lokale, për çka konsiderojmë se organet kompetente kanë për obligim të ndërmarrin masa dhe aktivitete për tejkalimin e tyre.

# REVIZIONI I SUKSESIT

Në vitin 2018 filluam me tetë (8) revizione të suksesit. Gjatë vitit janë realizuar katër revizione për të cilat njoftojmë në Raportin, ndërsa katër revizionet tjera vazhdojnë dhe do të përfundojnë në vitin 2019 dhe do të janë pjesë e Raportit Vjetor të vitit 2019. Pra, bëhet fjalë për pilot-revizione të suksesit që janë pjesë e Tvincing Projektit për t'i përforuar kapacitetet e revizorit të ESHR-së.

## 1. EFIKASITETI I MASAVE, POLITIKAVE DHE PROJEKTEVE PËR GAZIFIKIMIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Revizionin e Suksesit e zbatuam me qëllim që t'i japim përgjigje pyetjes „Nëse institucionet kompetente ndërmarrin masa, politika dhe projekte për ndërtimin efikas të rrjetit të gazsjellësit në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, si dhe të japim vlerësim për:

- Kushtet e krijuara për gazifikimin
- Gjendjen e rrjetit të gazifikimit dhe
- Masat, politikat dhe projektet për gazifikimin.

Aktivitetet e Revizionit të Suksesit kanë për qëllim që t'u ndihmojnë aktiviteteve të ardhshme të institucioneve kompetente që të fokusohen në përbushjen e postulateve të vendosura për gazifikimin e RMV-së.

Në lidhje me fushën që kanë të bëjë me atë nëse janë krijuar kushtet për gazifikimin e RMV-së i konstatuam gjendjet si vijon:

- nuk është miratuar strategja për zhvillimin e energjetikës në RMV;
- nuk është miratuar me kohë programi për realizimin e strategjisë për zhvillimin e energjetikës në RMV;
- mungon kapaciteti profesional dhe mbështetja financiare në sektorin energetik që ndikon në realizimin me kohë të programit për realizimin e strategjisë për zhvillimin e energjetikës;
- ekziston dinamikë e ngadalësuar në ndërtimin e rrjetit magjistral të gazsjellësit;
- procedurat e zbatuara në mënyrë të pasuksesshme për vendosjen e partneritetit privat publik nuk kanë mundësuar fillimin e procesit të ndërtimit të rrjetit shpërndarës të gazsjellësit në komunat e RMV-së;
- ekziston nevoja nga ndarja e operatorit të sistemit për përcimin e gazit natyror nga subjektit tjera që janë të lidhura me veprimtaritë e prodhimit dhe tregtisë dhe furnizimit me gaz natyror;
- miratimi dhe zbatimi i akteve nënligjore në fushën e gazit natyror në afatet e parapara ligjore;
- shqyrtimi i nevojës nga miratimi i Ligjit të ri për deponimin dhe mbrojtjen nga lëngjet dhe gazrat djegëse;

- janë paguar 250.000 euro në bazë të penaleve për shkak të tërheqjes jo me kohë të mjeteve, të parapara me marrëveshjen për hua;
- ka skaduar periudha prej 6 vitesh nga përpilimi i studimeve paraprake për gazifikimin e RMV-së deri në fillimin e ndërtimit të segmenteve magjistrale të gazu;
- nuk janë ripërtërirë licencat për bartjen dhe menaxhimin me sistemin për përcimin e gazit natyror të SHA GA – MA me ndryshimet e ligjit për energjetikë;
- SHA REM – Shkup nuk e kryen veprimitarinë e vet prioritare, për shkak të mosndërtimit të rrjetit magjistral të gazu;

Në lidhje me fushën që kanë të bëjë me **gjendjen me rrjetin e gazu** i konstatuam gjendjet si vijon:

- segmenti i ndërtuar magjistral në vitin 2016 ende nuk është në funksion;
- ekziston përqindje e vogël e realizimit të punëve të parapara me marrëveshjet e lidhura për ndërtimin e segmenteve magjistrale të gazu;
- është bërë ndërprerja e ndërtimit të njërit nga segmentet magjistrale të gazu;
- për shkak të kalimit të trasesë në park-pyllin Vodno për shkak të riaksionit të shoqatave joqeveritare për mbrojtjen e mjedisit jetësor;
- janë shpenzuar afér 3 herë më tepër mjete për ndërtimin e segmentit magjistral me mjetet e borxhit kliring rus për kilometër nga mjetet e parapara me studimin paraprak për gazifikimin e RMV-së;
- janë prolonguar punët ndërtimore për të ndërtuar segmentet magjistrale të gazu i për shkak të mjeteve të pasiguruara për shpronësim.


Në lidhje me fushën që ka të bëjë me **masat, politikat dhe projektet e ndërmarra për gazifikim** i konstatuam gjendjet si vijon:

- gjatë zbatimit të procedurave për prokurime publike, kriteret e përcaktuara për numrin e të punësuarve, për pajisjen teknike dhe gjendjen financiare ekonomike, nuk pamundësojnë zbatimin e parimeve të konkurrencës dhe paanshmërisë;
- ndërtimi i segmenteve magjistrale nuk zhvillohet në pajtim me dinamikën e paraparë, për shkak që ekziston rrezik që SHA REM – Shkup mos të mund të realizojë të ardhura me të cilat do të fillojë ta kthejë huan e marrë;
- nuk është ndërtuar sistemi për menaxhim dhe kontroll, si qendër përbledhëse e informatave për pranimin, mbikëqyrjen, marrjen dhe përpunimin e të dhënavë nga të gjitha segmentet magjistrale të gazu;
- edhe krahas periudhës prej 8 vitesh nga nevoja për fillimin me përgatitjet e planifikimit dhe përpilimit të dokumentacionit të planit dhe të projektit për rrjetin shpërndarës të gazifikimit përvëç Komunës së Kumanovës dhe Komunës së Strumicës, komunitat tjetra ende nuk kanë filluar aktivitete për ndërtimin e rrjetit shpërndarës të gazu;

- ekziston nevoja nga ndërtimi i gazsjellësit interkonektiv me qëllim të sigurimit të sasive plotësuese nga burimi tjetër i furnizimit me gaz natyror;
- janë përkufizuar komunat në të cilat duhet të fillojnë aktivitetet për ndërtimin e rrjetit shpërndarës;
- një pjesë e vogël e komunave kanë ndërmarrë masa për ndërtimin e rrjetit shpërndarës të gazsjellësit përvèç Komunës së Kumanovës dhe Komunës së Strumicës prej të cilave duhet të shfrytëzohen përvojat pozitive.

Gjendja me ndërtimin e rrjetit magjistral të gazsjellësit në RMV në kilometra është paraqitur në grafikën si vijon.

*Gjendja me rrjetin magjistral të gazsjellësit në Republikën e Maqedonisë së Veriut në kilometra*



Për zbatimin e pandërprerë të procesit të gazifikimit, konstatuam se nuk janë ndërmarrë të gjitha masat dhe aktivitetet e domosdoshme nga ana e institucioneve kompetente në RMV. Mungesa e strategjisë për zhvillimin e energjetikës në RMV për periudhën e ardhshme, përfundimi i plotë i projekteve të filluara për ndërtimin e rrjetit magjistral të gazsjellësit në pajtim me dinamikën e paraparë dhe vënien e tij me kohë në funksion, mosndërtimi i rrjetit shpërndarës të gazsjellësit në komunat e Republikës, sigurimi i mjeteve të domosdoshme financiare për ndërtimin e plotë të rrjetit të planifikuar magjistral dhe shpërndarës dhe përforcimi i kapaciteteve kadrovike në institucionet kompetente për zbatimin e procesit të gazifikimit, janë gjendjet që kanë ndikim mbi efikasitetin e ndërtimit të rrjetit të gazsjellësit, për shkak të shfrytëzimit të gazit natyror si energjens në gjithë territorin e RMV-së.

Realizimi i aktiviteteve të theksuara do të kontribuojë për të përmirësuar procesin e gazifikimit, me qëllim të shfrytëzimit më të madh të gazit si reagens, duke pasur parasysh rëndësinë e tij ekologjike në mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Përt'i tejkaluar gjendjet e përmendura më lartë kemi dhënë rekomandime që u referohen institucioneve kompetente, këto bazohen në rezultatet e revizionit të kryer dhe janë në funksion të përmirësimit dhe avancimit të efikasitetit në ndërtimin e rrjetit të gazsjellësit në RMV.

## 2. EFEKTIVITETI I POLITIKAVE, MASAVE DHE AKTIVITETEVE GJATË NDARJES SË TË DREJTËS SË UJIT

E drejta e ujit është e drejta e personave juridikë dhe fizikë të shfrytëzojnë ujëra dhe/ose të lëshojnë ujëra, e drejta e shfrytëzimit të ujërave nga trupat ujorë dhe e drejta e lëshimit në trupat ujorë të fituara me kushtin, mënyrën dhe në procedurën e përcaktuara me Ligjin për ujëra. Akumulimi, përfshirja, nxjerrja, shfrytëzimi, riorientimi, shkarkimi dhe lëshimi, si dhe veprimet tjera mbi ujërat kryhen me kushtet në mënyrën dhe në procedurën të përcaktuara me Ligjin për ujëra.

Menaxhimi me ujërat është veprimtaria me interes publik dhe paraqet masa dhe aktivitete për t'i arritur qëllimet e Ligjit për ujëra, ndërsa zbatimi i masave nuk guxon, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, të shpie në rritjen e ndotjes së medieve dhe zonave të mjedisit jetësor ose në zvogëlimin e cilësisë ekzistuese të ujërave.

Ujërat, si të mira me interes të përgjithshëm, në pajtim me Ligjin për ujëra janë në pronësi të Republikës së Maqedonisë dhe gjëzojnë mbrojtje të veçantë.

E kemi kryer Revizionin e Suksesit me temë „Efektiviteti i politikave, masave dhe aktiviteteve gjatë ndarjes së të drejtës së ujit“, ndërsa me revizion e kemi përfshirë periudhën 2015-2018, në institucionet kompetente për këtë fushë: Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Financave, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Instituti i Shëndetit Publik i Republikës së Maqedonisë, Qendrat e Shëndetit Publik, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor, Inspektorati Sanitar dhe Shëndetësor Shtetëror, Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale dhe Ndërmarrjet Komunale Publike.

Qëllimi i revisionit ishte „**Nëse miratimi i politikave dhe ndërmarrja e masave dhe aktiviteteve nga organet kompetente gjatë ndarjes së të drejtës së ujit sigurojnë përbashken e qëllimeve për arritjen e sasisë së mjaftueshme të ujit cilësor të pijshëm, mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të resurseve të disponueshme ujore nëpërmjet zvogëlimit të lëshimeve të dëmshme të ujërave si dhe përcaktimit të plotë dhe arkëtimit të kompensimit për të drejtën e ujit**“.

Për të arritur qëllimin e përcaktuar dhe dhënien e përgjigjes për pyetjen e shtruar u përfshin shumë fusha të rrezikshme me ç'rast konstatuan një numër të madh gjendjesh, në mesin e të cilave:

- Strategjia Nacionale e Ujërave, si dokumenti themelor i planit për planifikimin dhe zhvillimin e menaxhimit me ujërat në RMV, ishte miratuar në vitin 2012 me vlefshmëri prej 30 vitesh, por nuk përmban qëllime dhe prioritete strategjike konkrete, e as masa dhe aktivitete ose plan aksional dhe afate për zbatimin e tyre.
- Nuk janë miratuar dokumentet themelore të planit: Baza e Ekonomisë së Ujërave të RMV-së dhe planet për pellgjet e lumit. Deri në miratimin e bazës së re zbatohet Baza e Ekonomisë së Ujërave nga viti 1968 me dy ndryshime në vitin 2013 dhe vitin 2016;
- Për qytetet e mëdha nuk janë ndërtuar sistemet e kolektorit për ujërat e zeza dhe stacionet e pastrimit për trajtimin e tyre përkatës para lëshimit në recipient, përkatësisht një pjesë e madhe e ujërave të zeza urbane ende nuk lëshojnë pa pastrimin paraprak që nuk është në pajtim me standartet për t'i kufizuar emisionet, lëshimet kryhen pa leje dhe ndikim mbi shëndetin e qytetarëve, cilësinë e jetesës së tyre dhe mjedisin jetësor;

- Nga 37 ndërmarrjet publik dhe komunat e përfshira, janë lëshuar 15 leje për sistemet e furnizimit me ujë në qytet dhe 6 leje për sistemet e furnizimit me ujë në fshat për të shfrytëzuar ujin. Nga 36 ndërmarrjet publike të cilat kryejnë shërbime për grumbullimin dhe/ose pastrimin e ujërave të zeza, leje për lëshim kanë 4 ndërmarrje publike. Nuk janë siguruar lejet për komunat që kanë stacione të reja të pastrimit për ujërat e zeza të lëshuara në punë provuese në vitin 2017 dhe vitin 2018;
- Sipas Raportit për realizimin e programit vjetor nacional të shëndetit publik për vitin 2017, 62,7% të popullsisë furnizohet me ujë të pijshëm nga sistemet qendrore të furnizimit me ujë, të menaxhuara nga ndërmarrjet publike që i përmbushin obligimet ligjore lidhur me sigurimin dhe kontrollin e rregullshmërisë shëndetësore të ujit të pijshëm.
- Të dhënate krahasuara për analizat dhe rezultatet e kryera për rregullshmërinë shëndetësore të ujit të pijshëm në periudhën 2002–2017 tregonjë se nuk ekzistojnë dallime dhe lëshime të mëdha në rezultatet e marra gjatë gjithë periudhës;
- Shumica e ndërmarrjeve publike kanë vendosur dhe mbajnë zonë të ngushtë të mbikëqyrjes sanitare rrëth burimeve / puseve të kaptuara, por nuk janë vendosur dhe nuk mirëmbahen një ose më tepër zona më të gjera mbrojtëse rrëth objekteve të përfshira, ndërsa në disa raste janë evidente prishjet edhe në zonën më të ngushtë mbrojtëse për shkak të aktiviteteve infrastrukturore. Prezent është dukuria e lëshimit të ujërave të zeza të papastruara nga sistemet e kanalizimit në ujërat sipërfaqësore / ujëvarjet që derdhen në akumulimet e ujit të dedikuar për furnizimin me ujë, që shpie në prishjen e zonave mbrojtëse dhe cilësinë e ujit në to.
- Ndërmarrjet publike të cilat kanë stacione funksionale të pastrimit kanë të vendosur edhe instrumente për matjen e sasisë dhe cilësisë së ujërave të lëshuara. Të tjerat nuk kanë të vendosur instrumente dhe nuk kryejnë matje të ujërave të papastruara të cilat drejtpërdrejtë lëshohen në recipient. Në rrjedhë është realizimi i projektit në kornizat e të cilit gjatë viteve 2017 dhe 2018 ishin ndërtuar 5 stacione të pastrimit për ujërat e zeza dhe një stacion i pastrimit është duke u ndërtuar.
- Edhe pse shumica e ndërmarrjeve publike nuk kanë siguruar leje për lëshimin në ujërat, një pjesë e tyre e përllogarisin kompensimin për lëshimin në ujërat. Asnjë ndërmarrje publike nuk përllogarit vlerë variabile të kompensimit për lëshimin në ujërat, për shkak se nuk është miratuar akti nënligjor për të përcaktuar mënyrën e përllogaritjes së njësisë së dëmit, e as që në lejet kjo është përcaktuar. Një pjesë e ndërmarrjeve publike edhe pse kryejnë shërbime të kanalizimit, nuk kanë tarifë të përcaktuar për shërbimin dhe nuk përllogarisin kompensim për lëshimin në ujërat, ndërsa një pjesë edhe pse në shfrytëzuesit e fundit fakturojnë për shërbimet e kanalizimit dhe shërbimet e pastrimit, nuk përllogarisin kompensim për lëshimin në ujë, ndërsa te një pjesë e ndërmarrjeve publike nuk ka kufizim të kompensimeve të përllogaritura për shfrytëzimin e ujit dhe për lëshimin në ujërat;
- Përqindja mesatare e arkëtimit të llogarive për shërbimet komunale nga shfrytëzuesit e fundit arrin 72,25% dhe lëviz në distancë prej nën 20% (Dibër – 19,6% dhe Gostivar 22,6%) deri mbi 95% te ndërmarrjet tjera publike.

- Në dobi të llogarisë së thesarit përfundimisht në muajt gusht / shtator 2018 janë paguar 25.567 mijë denarë ose 7,32% nga gjithsej kompensimet e përllogaritura për shfrytëzimin e ujit nga 349,307 mijë denarë. Më tepër se gjysma e ndërmarrjeve të përfshira publike aspak nuk bëjnë pagesën e kompensimit të përllogaritur për shfrytëzimin e ujit, ndërsa të tjera bëjnë pagesë të pjesshme, më shpesh pas mbikëqyrjes së kryer inspektuese. **Gjendja e konstatuar udhëzon në gjetje se ndërmarrjet publike që përllogarisin kompensim kanë detyrime të deklaruara për kompensimin e papaguar në dobi të llogarisë përkatëse të pagesës në Buxhetin e RMV-së në shumë prej 323.740 mijë denarë ose përafërsisht 5.200.000 euro, përkatësisht 92,68% nuk është paguar kompensimi i theksuar.**
- Në dobi të llogarisë së thesarit përfundimisht në muajt gusht / shtator 2018 janë paguar 3.693 mijë denarë ose 10,98% nga gjithsej kompensimet e përllogaritura për lëshimin në ujërat në shumë prej 33.603 mijë denarë. Përveç NPK Nisko Gradba nga Manastiri, e cila kryen pagesë të rregullt vazhdimisht të kompensimit të përllogaritur për lëshimin në ujërat, të tjerat kryejnë pagesë të pjesshme të kompensimit të përllogaritur ose aspak nuk paguajnë. Më tepër se gjysma e kompensimit të përllogaritur të papaguar për lëshimin në ujërat bie në dy ndërmarrjet publike: NP Ujësjellësi dhe Kanalizimi – Shkup dhe NP Ujësjellësi – Kumanovë. **Gjendja e konstatuar udhëzon në gjetje se ndërmarrjet publike që përllogarisin kompensim kanë detyrime të deklaruara për kompensimin e papaguar në dobi të llogarisë përkatëse të pagesës në Buxhetin e RMV-së në shumë prej 29.950 mijë denarë ose përafërsisht 500.000 euro, përkatësisht 89,02% nuk është paguar kompensimi i theksuar.**

Vlera e shtuar nga revizioni i kryer paraqet evazion të konstatuar tatimor të përcaktuar vetëm te një pjesë e ndërmarrjeve publike që i përllogarisin kompensimet e nevojshme në shumë prej 353.690 mijë denarë ose përafërsisht 5.700.000 euro mjete të papaguara në Buxhetin e RMV-së.

Evazioni i përcaktuar tatimor krahasuar me Buxhetin e Entit Shtetëror të Revizionit i cili është miratuar për vitin 2018 në shumë prej 91.348 mijë denarë sugjeron se ESHR-ja vetëm me këtë revizion ka vlerë të shtuar në korrelacion 4:1 në dobi të Buxhetit të RMV-së.


Si rezultat i gjendjes së konstatuar, revizioni e dha konkluzionin si vijon:

- ✓ Politikat e miratuara dhe masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga organet kompetente, njësitë e vetëqeverisjes lokale (komunat) dhe ndërmarrjet publike gjatë ndarjes së të drejtës së ujit pjesërisht sigurojnë përbushjen e qëllimeve për ta arritur sasinë e mjaftueshme të ujit cilësor të pijshtëm, mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të resurseve të disponueshme ujore nëpërmjet zvogëlimit të lëshimeve të dëmshme në ujërat, ndërsa qëllimet e pritura në pjesën e përcaktimit të plotë dhe arkëtimit të kompensimit për të drejtën e ujit nuk janë përbushur.

### 3. ЕФЕКТИВИТЕТІ И ПОЛИКАВЕ, МАСАВЕ ДНЕ АКТИВИТЕТІВЕ ГЈАТË ЕКСПЛОАТИМИТ ТË ЗHAVОРРИТ ДНЕ РËРËС НГА ПELLGU И LUMIT ТË VARDARIT

Nxjerrja dhe shitja e rërës është problem botëror global. Hulumtimet në kornizat botërore tregojnë se çdo vjet shpenzohen afër 50 miliardë tonë rërë, që është dy herë më tepër se sasia të cilën mund ta prodhojnë të gjitha lumenjtë në botë. Resursi i tretë më i shfrytëzuar natyror pas ajrit dhe ujit është rëra, të cilën e shfrytëzojmë më tepër se naftën. Me rekomandimet që dolën nga Revizioni i Suksesit, Enti Shtetëror i Revizionit iu bashkëngjitet vendeve të cilat ndërmarrin masa për:

- eksploatimin e kontrolluar të rërës nga lumenjtë
- shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit në rastet kur nevojitet rregullimi i lumenjve, mbrojtja nga vërshimet dhe erozioni,
- sigurimin e mbrojtjes së mjedisit jetësor, dhe
- vendosjen e tregut të rregulluar për shitjen e rërës.



Ujërat në territorin e RMV-së, si të mira me interes të përgjithshëm, janë në pronësinë e saj, me ç'rast mënyra e mbrojtjes dhe menaxhimit të tyre janë rregulluar me dispozitat e Ligjit për ujëra. Në pajtim me dispozitat ligjore, nxjerra e rërës, zhavorrit dhe gurit nga shtrati dhe brigjet e trupave sipërfaqësore të ujit bëhet me qëllim të përmirësimit të regjimit të ujërave, në vëllimin i cili nuk do ta prish regjimin e ujit, nivelin e vazhdueshëm të ujërave nëntokësore, stabilitetin e bregut dhe ekuilibrin natyror të ekosistemeve bregdetare.

Republika e Maqedonisë ka 4 pellgje të lumbit – Pellgu i Vardarit, Pellgu i Strumicës, Pellgu i Drinit të Zi dhe Pellgu i Moravës Jugore. Pellgu më i madh i lumbit është Pellgu i Vardarit me sipërfaqe prej 20.546 km<sup>2</sup>, i cili graviton në Detin Egje.

Revisionin e Suksesit e zbatuam me qëllim që t'i japim përgjigje pyetjes „**Nëse masat / aktivitetet e ndërmarra nga ana e institucioneve kompetente për eksploatimin e rërës dhe zhavorrit nga shtrati dhe brigjet e trupave sipërfaqësore të ujit nga Pellgu i Lumit të Vardarit sigurojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e regjimit të lumenjve dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor në përgjithësi?**“


Për vendosjen e kornizës juridike që ka të bëjë me rregullimin dhe mirëmbajtjen e shtratit të lumit dhe brigjeve, si dhe mbrojtjen dhe përmirësimin e regjimit të ujërave me nxjerrjen e rërës dhe zhavorrit, konstatuam se krahas miratimit të rregullativës ligjore, nevojitet miratimi i dokumenteve strategjike, akteve nënligjore, dokumenteve themelore të planit dhe formimin e trupave profesionale. Një pjesë e këtyre dokumenteve strategjike dhe akteve nënligjore janë të domosdoshme për t'u harmonizuar me direktivën kornizë të Evropës për ujërat me të cilën rregullohet fusha e mbrojtjes dhe menaxhimit me ujërat në Evropë dhe direktivën për vlerësimin dhe zvogëlimin e rezikut nga vërvshimet në kornizat e Bashkimit Evropian.

Aktivitetet e ndërmarra për nxjerrjen e rërës dhe zhavorrit nga shtrati dhe brigjet e trupave sipërfaqësore të ujit në Pellgun e Lumit të Vardarit nuk mundësojnë mbrojtjen dhe përmirësimin përkatës të regjimit të ujërave. Pjesa më e madhe e materialit të nxjerrë shfrytëzohet për shitje, ndërsa pjesa minimale për t'i rregulluar shtretërit e lumit. Nuk është caktuar në mënyrë të quartë mënyra e përcaktimit të lokacioneve ku duhet të zbatohen aktivitetet për nxjerrjen e rërës dhe zhavorrit dhe nuk janë vendosur masat për mbrojtjen nga gjermimi joligjor.

MMJPH-ja nuk ka të vendosur libër ujor dhe nuk mundëson inspektim në gjithë dokumentacionin për lejet e lëshuara / pëlqimet e ekonomisë së ujërave. Edhe pse dispozitat ligjore lejojnë që teprica e nxjerrë e materialit të lëshohet në qarkullim, mënyra e shitjes së tij nuk është rregulluar. Mungon mekanizmi efikas i kontrollit nëpërmjet të cilit ndiqet sasia e rërës dhe zhavorrit të nxjerrë nga trupat sipërfaqësorë të ujit, Metodologjia për formimin e çmimit fillestar të materialit të nxjerrë, si dhe procedura konkurrente dhe transparente për ankandin publik gjatë shitjes së tij. **Për këtë shkak, revizioni nuk kishte mundësi të bindet në saktësinë dhe plotësinë e të ardhurave të realizuara nga shitja e rërës dhe zhavorrit, ndërsa me të edhe ta vërtetojnë gjithë kompensimin të cilin duhet ta arketojnë subjektet – bartësit e lejes gjatë shitjes së tepricës së materialit dhe atë ta paguajnë në llogari në kornizat e llogarisë së thesarit në Buxhetin e RMV-së.** Gjendja në mënyrë plotësuese përkeqësohet dhe me pagesën jo me kohë të kompensimit të përcaktuar për nxjerrjen e rërës dhe zhavorrit në llogarinë e thesarit nga ana e bartësve të lejes, si dhe kompensimin e shfrytëzimit me dedikim të mjeteve.

Nga viti 2015 deri në shtator 2018, pagesa e kompensimit për nxjerrjen e rërës dhe zhavorrit në llogarinë e thesarit ka trend të rënies së përhershme, përkatësisht në vitin 2015 kompensimi i paguar në llogarinë e thesarit ka qenë në shumë të përgjithshme prej 1.271 mijë denarë, në vitin 2016 – 759 mijë denarë, në vitin 2017 – 400 mijë denarë, që gjatë vitit 2018 ky aspak nuk paguhet.

Në pasqyrën grafike që vijon, në mënyrë të quartë janë paraqitur të ardhurat e realizuara nga shitja e rërës dhe zhavorrit, detyrimet e evidentuara për kompensim dhe pagesa e tyre nga ana e SHA Ekonomia e Ujërave dhe NPEU Lisiçe Veles.



Mungesa e Programit për të menaxhuar me ujërat ose marginalizimi i tyre në të kaluarën, në mënyrë të pavolitshme pasqyrohet mbi mundësinë për të ndërmarrë aktivitete për mbrojtjen dhe përmirësimin e regjimit të ujërave.

Institucionet kompetente nuk kanë zbatuar mbikëqyrje profesionale, ndërsa nevojitet ndërmarrja e masave për t'i përforcuar kapacitetet kadrovike gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese. Sistemi i vendosur i informimit nuk siguron informata të plota, të sakta dhe të azhurnuara lidhur me nevojën nga nxjerra e rërës dhe zhavorrit nga trupat sipërfaqësore të ujit, leje të lëshuara / pëlqime të ekonomisë së ujërave, si dhe veprimin sipas tyre.

**Vlera e shtuar nga revizioni i kryer mes tjerash shihet edhe në gjetjen e mjeteve të papaguara në Buxhetin e RMV-së me gjendjen më 30.09.2018 në shumë prej 1.839 mijë denarë.**

Si rezultat i revizionit të kryer, revizorët e dhanë konkluzionin si vijon:

- ✓ „Politikat, masat dhe aktivitetet të ndërmarra nga ana e institacioneve kompetente për eksplloatimin e rërës dhe zhavorrit nga shtrati dhe brigjet e trupave sipërfaqësore të ujit nga Pellgu i Lumin të Vardarit nuk janë efektive dhe nuk sigurojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e regjimit të ujërave, rregullimi i shitjes së tepricës së nxjerrë të materialit në dobi të shtetit, parandalimi i gërmimit joligjor të rërës dhe zhavorrit dhe pavarësimi i institacioneve gjatë zbatimit të aktiviteteve për menaxhimin me ujërat dhe mbrojtjen e tyre.“

Për t'i tejkaluar gjendjet e konstatuara, revizioni ka dhënë rekomandime me qëllim të vendosjes së politikave, masave dhe aktiviteteve efektive për t'i konstatuar nevojat reale nga eksplloatimi i zhavorrit dhe rërës nga trupat sipërfaqësore të ujit në Pellgun e Lumin të Vardarit, përdorimi i tyre në përmirësimin e regjimit të ujërave, rregullimi i shitjes së tepricës së nxjerrë të materialit në dobi të shtetit, parandalimi i gërmimit joligjor të rërës dhe zhavorrit dhe pavarësimi i institacioneve gjatë zbatimit të aktiviteteve për menaxhimin me ujërat dhe mbrojtjen e tyre.

## 4. EFEKTIVITETI I POLITIKAVE DHE MASAVE GJATË MENAXHIMIT ME TOKËN NDËRTIMORE

E kemi kryer Revizionin e Suksesit me temë „Efektiviteti i politikave dhe masave gjatë menaxhimit me tokën ndërtimore” me qëllim që përgjigje t'i japim pyetjes: „Nëse politikat dhe masat e vendosura mundësojnë menaxhimin efektiv me tokën ndërtimore që është pronësi e RM-së”, si dhe dhënia e rekomandimeve të cilat do të orientohen në rritjen e efektivitetit të tyre.

Të drejtat dhe obligimet, rregullimi, kushtet dhe mënyra e disponimit me tokën ndërtimore rregullohen me Ligjin për tokë ndërtimore. Toka ndërtimore, mund të jetë tokë e ndërtuar dhe e pandërtuar, e planifikuar me aktet e parapara me Ligjin për planifikimin hapësinor dhe urbanistik. Toka ndërtimore mund të jetë në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pronësi të komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, në pronësi të ndërmarrjeve publike, shoqërive aksionare dhe subjekteve tjera të themeluara nga Qeveria dhe Kuvendi i RMV-së dhe në pronësi të personave vendorë dhe të huaj juridikë dhe fizikë, me kushtet e përcaktuara me Ligjin për tokë ndërtimore dhe ligj tjetër.

Toka ndërtimore e cila është pronësi e RMV-së, mund të tëhuajësohet dhe të jepet me qira afatgjatë dhe afatshkurtër me ankand publik dhe me marrëveshje të drejtpërdrejtë edhe pse me planin urbanistik ose dokumentacionin urbanistik të planit të parcelës ndërtimore parashihet ndërtimi i ndërtimeve me interes publik të përcaktuara me ligj, pas vendimit të miratuar paraprakisht nga Qeveria e RMV-së.

Revizioni i Suksesit e përfshin periudhën prej vitit 2011 deri në vitin 2018, ndërsa sipas nevojës, edhe vitet para vitit 2011.

Aktivitetet e revizorit u orientuan në fushat si vijon:

- Miratimi dhe ndryshimet e dokumentacionit urbanistik të planit për shkak të planifikimit të drejtë të hapësirës dhe sipërfaqes publike dhe realizimi i interesit publik.
- Menaxhimi me tokë ndërtimore, që është pronësi e RMV-së, dhe politikat dhe masat e parapara për të.
- Mbikëqyrja mbi zbatimin e rregullativës ligjore në fushën e menaxhimit me tokën ndërtimore, që është pronësi e RMV-së.

Me revizionin i konstatuam gjendjet që kanë ndikim mbi efektivitetin në menaxhimin me tokën ndërtimore, edhe atë:

- Komunat, pas miratimit të PPU-së, shpeshherë nuk miratojnë PHU të ri, ose në kushte të ekzistimit të PPU-së, bëjnë ndryshime të shpeshta të PHU-së sipas bloqeve, meqë prezent është mospajtueshmëria e dokumentacionit të planit me gjendjen faktike, ose mos pajtueshmëria e PHU-së me PPU-në.
- Anketa publike në procesin e miratimit të planeve të hollësishtë urbanistike zbatohet në fazën mjaft të vonuar nga miratimi i PHU-së, meqë ekziston mundësia mos të participojnë të gjithë të interesuarit (personat fizikë dhe juridikë) në afatin e paraparë.
- Ekziston mosrespektimi i të drejtave të fituara (interesi publik) me ndryshimet e propozuara të dokumentacionit urbanistik të planit nga ana e komunave në cilësinë e urdhëruesit dhe

në vend të planifikohet zhvillimi me rritjen e sipërfaqeve publike, planifikohet zvogëlimi i tyre.

- Ndryshimi i dokumentacionit ekzistues urbanistik të planit ose miratimi i dokumentacionit të ri urbanistik të planit, nuk bëhet në bazë të analizës së përpiluar profesionale për nevojën nga ndryshimi ose plotësimi i planeve ose i një pjese të tyre.
- Janë ngritur padi që kanë të bëjnë me shitjen e tokës ndërtimore në pronësi të RMV-së, gjatë fushatës zgjedhore ose ndryshimi i PHU-së.
- Nuk janë të plota të dhënat për tokën ndërtimore, që është pronësi e RMV-së, e cila është tēhuajësuar ose është dhënë me qira afatgjatë / afatshkurtër.
- Në periudhën prej viti 2014 deri në korrik të viti 2018, nuk është formuar Komiteti për Tokën Ndërtimore, që është pronësi e RMV-së.
- Nuk bëhet mbikëqyrja përkatëse mbi zbatimin e Ligjit për tokë ndërtimore nga ana e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve.

Ndërmarrja e masave dhe aktivitetave pas rekomandimeve të dhëna nga ana e institucioneve kompetente do të kontribuojë për të përmirësuar efektivitetin e masave dhe politikave në menaxhimin me tokën ndërtimore në periudhën e ardhshme.

Duke e pasur parasysh sistemin e vendosur për menaxhimin me tokën ndërtimore në pronësi të RMV-së, ndërsa duke u nisur nga vendosja institucionale e subjekteve kompetente, aktivitetet e deritanishme për zbatimin e politikave për menaxhim me tokën ndërtimore, ekipimi kadrovik, si dhe ndryshimet në rregullativën ligjore, revizioni konstataci se gjendjet e caktuara që kanë të bëjnë me ndarjen e të ardhurave nga tēhuajësimi i tokës ndërtimore, caktimi i përqindjes minimale të ndërtimit të objekteve nga bruto sipërfaqja e zhvilluar në përgjithësi, zvogëlimi i përqindjes së mjeteve që i paguan komuna në rast të ndërprerjes së njëanshme të marrëveshjeve, janë të tejkaluara. Nga ana tjeter, njësive të vetëqeverisjes lokale u mundësohet që vazhdimisht të vendosin për mënyrën e disponimit dhe dinamikës së tēhuajësimit të tokës ndërtimore që është pronësi e RMV-së e cila është në territorin e tyre, në varësi nga nevoja për zhvillimin socio-ekonomik të komunës.

Edhe krahas avancimit, përsëri ekziston nevoja nga avancimi i procesit të planifikimit hapësinor dhe urbanistik në drejtim të ruajtjes së parimeve themelore të rregullimit racional dhe shfrytëzimit të hapësirës, kushtet për jetesën humane dhe punën e qytetarëve dhe publikut në procedurën dhe rregullimin infrastrukturor. Veçanërisht e rëndësishme është mbrojtja e tokës që është në pronësi të RMV-së, si tokë e cila mund të shfrytëzohet për interes publik, me çka do të sigurohet avancimi dhe disponimi me tokën ndërtimore nga ana e subjekteve kompetente si biznesmenë të mirë.

Gjithashtu, ka nevojë nga përsosja dhe plotësimi i sistemeve informatike për t'i zbatuar procedurat për tēhuajësimin e tokës ndërtimore që është në pronësi të RMV-së dhe sistemit për ndjekjen elektronike të marrëveshjeve për tēhuajësimin dhe dhënien me qira afatgjatë dhe afatshkurtër, në drejtim të zbatimit të tyre të pandërprerë dhe sigurimit të të dhënave të plota për menaxhimin dhe disponimin me tokën ndërtimore, si dhe vendosjen e mbikëqyrjes përkatëse mbi zbatimin e rregullativës ligjore në fushën, që do të mundësohet menaxhimi efektiv me tokën ndërtimore që është pronësi e RMV-së.

## BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Në periudhën e njoftimit, Enti Shtetëror i Revizionit realizoi një bashkëpunim të pasur ndërkombëtar me qëllim të avancimit në nivel profesional të kuadrit në ESHR. Ky u zhvillua nëpërmjet bashkëpunimit me ILR-të tjera në nivel bilateral dhe multilateral. Pjesëmarrja në revizionet kooperative në fushën e prokurimeve publike dhe cilësinë e ajrit me institucionet e larta të revizionit të BE-së dhe rajonit kontribuoi për avancimin e mëtejshëm të shkathtësive të revizorit të të punësuarve në Entin Shtetëror të Revizionit dhe për cilësinë e revizioneve të suksesit, njëri nga priorititetet kryesore të institucionit në vitin 2018.

Pas pjesëmarrjes aktive të Entit Shtetëror të Revizionit në revizionin kooperativ në fushën e cilësisë së ajrit, nga fundi i vitit 2017 dhe gjatë vitit 2018, të realizuar në kornizat e grupit të punës për mjedisin jetësor të EUROSAL, ndërsa në koordinim të ILR-së së Holandës dhe ILR-së së Polonisë, ishte përpiluar raporti përfundimtar i cili i përmban gjetjet dhe konkluzionet kryesore të raporteve nationale të revizionit të vendeve pjesëmarrëse. Ky raport është publikuar edhe në faqen e rrjetit të ESHR-së.

Realizimi i suksesshëm i projekteve paraprake (2015-2017) për institucionet e larta të revizionit të rrjetit – rajonit, për kryerjen e revizionit paralel të suksesit në fushën e efikasitetit energjetik dhe prokurimeve publike, dha impuls të ri për të vazhduar bashkëpunimin ndërmjet ILR-ve të rajonit. Në muajin tetor 2017 filloj projekt i ri në fushën e revizionit financiar me aspektet e revizionit të pajtueshmërisë. Ndihmë profesionale dhe financiare për këtë projekt, sikurse për dy projektet paraprake, siguroi ILR-ja e Suedisë, në koordinim me grupin e punës së Komitetit të Kontaktit për Revizionet e Përbashkëta (JWGAA) dhe me pjesëmarrjen e ekspertëve të Gjykatës Evropiane të Revizorëve.

Përfitimet nga bashkëpunimi me ILR-të tjera në revizionet kooperative janë të shumëfishta, veçanërisht do ta theksojë mundësinë që e patën revizorët përsosjen profesionale në formë të aktiviteteve kolegiale (peer-to-peer), qasjes fleksibile dhe shfrytëzimit të përvojave të pjesëmarrësve tjerë dhe përforcimit të vetëbesimit në kapacitetet personale për kryerjen e revizionit të suksesit.

Shkëmbimi i përvojave të reja në fushën e revizionit shtetëror me kolegët e ILR-ve tjera u zhvillua nëpërmjet formave standarde të bashkëpunimit dhe kryesisht në koordinim të INTOSAI1 dhe EUROSAL2. Kontributi i Entit Shtetëror të Revizionit në punën e grupeve dhe trupave të punës së këtyre asociacioneve me qëllim të promovimit të aktiviteteve në fushën e mjedisit jetësor, TI-së, etikës dhe integritetit te ILR-të dhe institucionet në administratën publike dhe revizionit të komunave vazhdoi edhe gjatë vitit 2018.

Pjesëmarrja e të punësuarve në Entin Shtetëror të Revizionit në ngjarjet ndërkombëtare për edukim dhe përsosje u zhvillua në këto fusha: revizioni i mjedisit jetësor, revizioni i komunave, përforcimi i integritetit dhe etikës tek institucionet e larta të revizionit dhe institucionet në sektorin publik, çështjet në fushën e mbështetjes së TI-së, përvojat nga realizimi i revizioneve kooperative, kontabiliteti dhe njoftimi në sektorin publik, avancimi i funksionit të revizionit të brendshëm, prokurimet publike, e-trajnimet për revizionin e suksesit; metodologja në revizion, revizioni i ndërmarrjeve në pronësinë e komunave, roli i ILR-së në mbikëqyrjen financiare te partitë politike.

1 Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve të Larta të Revizionit – ESHR është anëtar nga vitit 2001

2 Organizata Evropiane e Institucioneve të Larta të Revizionit – ESHR është anëtar nga viti 2002

Enti Shtetëror i Revizionit e mban statusin e veteranit në rrjetin e ILR-së së vendeve kandidate dhe kandidatëve potencialë për anëtarësim në BE dhe Gjykatën Evropiane të Revizorëve. Po rrjedhë dekada e dytë e kontributit që ESHR-ja vazhdimisht e jep në realizimin e aktiviteteve të rrjetit që kanë për qëllim përgatitjen e strukturave të revizionit në vendet të cilat janë në rrugën për anëtarësim në familjen evropiane.

Statusi i kandidatit i Republikës së Maqedonisë për t'u pranuar në Bashkimin Evropian, të marrë në fund të vitit 2005, Entit Shtetëror të Revizionit i mundësoi të marrë pjesë rregullisht në cilësinë e mbikëqyrësit aktiv në mbledhjet e Komitetit të Kontaktit dhe të jetë në hap me ngjarjet dhe sfidat më të reja me të cilat ballafaqohen shefat e ILR-së të Bashkimit Evropian gjatë ushtrimit të funksionit të revizionit.

## Aktivitetet në kornizat e EUROSAl, INTOSAl dhe organizatave tjera

Anëtarësimin në grupet e punës së EUROSAl për mjedisin jetësor nga viti 2002 dhe për TI-në nga viti 2005, Enti Shtetëror i Revizionit e mban vazhdimisht me pjesëmarrjen aktive në punën e tyre.

Në vitin 2018, Enti Shtetëror i Revizionit mbushi gjysmë dekade nga pjesëmarrja e vet në aktivitetet e grupit operativ të EUROSAl për revizion dhe etikë, të udhëhequr nga ILR-ja e Portugalisë që punon në përfocimin e integritetit dhe etikës tek institucionet e larta të revizionit dhe institucionet e administratës publike.

Lidhur me programin e IDI (INTOSAI Development Initiative) për kryerjen e revizionit të SDG – qëllimet e qëndrueshme zhvillimore, si vazhdim të aktiviteteve nga viti paraprak, përfaqësuesi i ESHR-së mori pjesë në trajnimin për mentorë për të zhvilluar programin dhe aftësimin e institacioneve të larta të revizionit për kryerjen e revizionit të SDG-së që u mbajt në Nanxhing, RP e Kinës.

Gjatë vitit 2018, delegacionet e larta të Entit Shtetëror të Revizionit morën pjesë në një numër të madh ngjarjesh të rëndësishme ndërkombëtare prej të cilave i theksojmë këto si vijon: konferanca ndërkombëtare në nivel të lartë me temë "Roli i ILR-së në promovimin e sundimit të mirë" të organizuar nën Kryesimin e Bullgarisë me Këshillin e Evropës, Sofje në muajin maj 2018; konferanca e INTOSAI për motivimin e ILR-së për kryerjen e kontolleve kolegjiale (peer reviews), Bratislavë në muajin qershor 2018, dhe mbledhja e UNDESA-IDI për kontributin e ILR-së në realizimin e Agjendës 2030 dhe qëllimeve për zhvillimin e qëndrueshëm, Nju Jork në muajin korrik 2018; shërimi i 15-vjetor të formimit të NAO Kosovë.

Në kuadër të programit (Public- Sector Accounting and Reporting Program (PULSAR) për ta zhvilluar kornizën për njoftimin financiar në sektorin publik në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe vendet që më herët ishin pjesë e Bashkimit Sovjetik, në vitin 2018 u mbajt edhe punëtoria e dytë në Vjenë në të cilën mori pjesë edhe përfaqësuesi i ESHR-së.

Për t'u shënuar është edhe fakti që Enti Shtetëror i Revizionit në vitin 2017 përkatësisht në vitin 2018 e rriti prezencën edhe në dy grupe ndërkombëtare të punës: i pari është grupi i projektit të EUROSAl për rolin e institacioneve të larta të revizionit në përhapjen e kulturës së integritetit, me të cilën udhëheq ILR-ja e Hungarisë. Ky aktivitet është pjesë e Planit të ri strategjik të EUROSAl (2018-2023), të miratuar në Kongresin në Stamboll. I dyti është grupi i punës së INTOSAI për borxhin

publik. Aktivitetet e këtij grupei të punës do të orientohen në shkëmbimin e përvojave ndërmjet institucioneve të larta të revizionit lidhur me njoftimin dhe menaxhimin e shëndoshë me borxhin publik në pajtim me standartet e ISSAI-së.

## Rrjeti i ILR-së i vendeve kandidate dhe kandidatëve potencialë për t'u pranuar në BE dhe Gjykata Evropiane e Revizorëve

Aktivitetet e rrjetit që kanë për qëllim integrimin më të lehtë të vendeve kandidate në familjen evropiane zhvillohen në koordinimin e oficerëve për lidhje të ILR-së dhe me mbështetjen e grupit të punës për aktivitetet e përbashkëta të revizionit, të formuar nga Komiteti i Kontaktit, anëtarët tjerë të ILR-së së BE-së dhe SIGMA-s.

Në mbledhjen e rregullt vjetore të oficerëve për lidhje të ILR-së së rrjetit, që u mbajt në Maltë (maj 2018), temë qendrore për të cilën janë mbajtur diskutimet ishin aktivitetet e planit të ri kornizë të aktiviteteve të rrjetit (2018-2020). Aktivitetet janë orientuar drejt përforcimit të kapaciteteve të anëtarëve të rrjetit nëpërmjet bashkëpunimit me ILR-në e vendeve anëtare dhe GJER-në, dhe në periudhën e ardhshme do të fokusohen në bashkëpunimin me parlamentet për të përmirësuar ndikimin e revizionit, mbështetjen e TI-së në procesin e revizionit dhe revizionin e softuerit, interaksion më të madh me sektorin civil, dhe vazhdimin e punëtorive nga seria për avancimin e revizionit financiar që filloi në gjysmën e dytë të vitit 2017.

Nga seria e punëtorive për revizionin financiar, që e mbulojnë gjithë ciklin e revizionit, prej planifikimit deri në njoftimin për gjendjet dhe gjetjet e revizionit dhe kontrollin e cilësisë, punëtoria e dytë dhe e tretë u mbajtën në shtator (Budvë) dhe nëntor (Ankara) të vitit 2018 duke arritur efekte lidhur me përforcimin e rekondimeve në raportet e revizionit.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të ESHR-së në mbledhjen e Komitetit të Kontaktit të cilin e përbëjnë shefat e ILR-së së BE-së, bashkë me anëtarët tjerë të rrjetit, mundeson ndjekjen e vazdueshme të ngjarjeve më të reja në fushën e sundimit / menaxhimit me finansat publike në BE, ndikimin

e rregullativave të reja të BE-së mbi punën e GJER-së dhe ILR-ve nationale, si dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e praktikës së revizorëve të orientuar në përmirësimin e përgjegjësisë dhe raportimit në shpenzimin e mjeteve të ndara nga fondet evropiane. Mbledhja u mbajt në Dubrovnik në muajin tetor 2018, dhe në kornizat e saj u mbajt seminari me temë: Interaktiviteti me qytetarët e BE-së – qasjet inovative në komunikimin me qytetarët / palët e prekura nga ana e ILR-së në BE.



## Bashkëpunimi bilateral dhe rajonal

Në vitin 2018, ESHR-ja ishte organizator i një varg takimesh bilaterale me përfaqësuesit e ILR-së nga rajoni: Slloveni, Bosnjë e Hercegovinë, Kosovë, Turqi, Shqipëri. Në këto takime, krahas avancimit të bashkëpunimit bilateral, në fokus të interesit ishte përvoja e ESHR-së nga zbatimi i sistemit për menaxhim me revisionet AMS (Audit Management System) dhe përgatitja përfshirëzim nga ana e të punësuarve, si dhe përdorimi i SAPRI – softuerit për përpunimin e të dhënave të prezantuara në raportet e revizionit, posaçërisht në pjesën e ndjekjes së rekomandimeve. Gjatë vizitës së delegacionit të ILR-së së Turqisë në Entitetin Shtetëror të Revizionit, në muajin tetor 2018, të dyja institucionet nënshkruan marrëveshje përfshirëzim të ndërsjellë.

## Projekti me Qeverinë Britanike

Në kornizat e mbështetjes së reformave në Republikën e Maqedonisë, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar nëpërmjet Fondit përfshirëzim të britanikëve (GGF of UK) i siguroi mbështetje Entitetit Shtetëror të Revizionit përfshirëzim e projektit *"Rritja e raportimit dhe transparencës në Maqedoninë përmjet zbatimit të përmirësuar të rekomandimeve të ESHR-së"*.

Projekti që filloi në korrik 2018 dhe do të zgjasë deri më 15 mars 2019, ESHR-ja e realizoi me ndihmën e Prajsvoterhaus Kupers Maqedoni (PwC), Vestminister Fondacioni përfshirëzim Demokraci (WFD) në bashkëpunim me Qendrën përfshirëzim Ekonomike (CEA) dhe RESIS dhe ka përfshirëzim e zbatimit të rekomandimeve të ESHR-së, nëpërmjet vlerësimit dhe përfshirëzimit të mekanizmave institucionale përfshirëzim e ndjekjen e tyre. Kjo do të arrihet nëpërmjet prezencës së madhe në publik dhe përfshirëzim së madhe në publikun e gjërë dhe palët tjera të prekura në punën e ESHR-së.

Projekti është fokusuar në tri rezultatet kryesore 1. Vlerësimi i përgjithshëm i procesit të revizorit; 2. Kapaciteti i rritur i ESHR-së përfshirëzim e rekomandimeve; dhe 3. Strategjia e komunikimit të ESHR-së e inkorporuar në planet e punës së institucionit, duke përfshirë edhe strategjinë përfshirëzim e prezantimin e raporteve të rëndomta të revizorit të palëve tjera të prekura.

Gjithashtu, në kornizat e projektit u përfshirëzim së gazetarë nga medie të ndryshme të cilët me mbështetjen e institucionit tonë me sukses realizuan storje hulumtuese në bazë të gjetjeve në raportet e revizionit të Entitetit Shtetëror të Revizionit dhe ato i prezantuan në publik.

## Bashkëpunimi me OECD - SIGMA dhe Komisionin Evropian

Bashkëpunimi me SIGMA-n në vitin 2018 u zhvillua në kornizat e aktiviteteve të rrjetit të cilin e përbëjnë ILR-ja e Turqisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Serbisë, Shqipërisë, Bosnjë e Hercegovinës, ESR-ja dhe Kosova\* (në cilësinë e mbikëqyrësit), me qëllim të përfshirëzimit të kapaciteteve institucionale nëpërmjet bashkëpunimit me ILR-në e vendeve anëtare të BE-së dhe ESR-së përfshirëzim më të lehtë të vendeve kandidate në familjen evropiane.

Me mbështetjen logjistike dhe financiare të SIGMA-s u realizuan një pjesë e aktiviteteve të Planit të ri

kornizë të rrjetit (2018-2020) ku theksi është vënë në përmirësimin e bashkëpunimit me parlamentet me qëllim të rritjes së ndikimit në raportet e revizionit.

Gjatë vitit 2018 sipas dinamikës së planifikuar, u zhvillua edhe realizimi i Twining Projektit (2017-2019) i financuar nga BE-ja me titull "*Përforcimi i mëtejshëm i kapaciteteve dhe efikasiteti i Entit Shtetëror të Revisionit përkryerjen e revizionit të jashtëm*". Enti Shtetëror i Revisionit filloi me aktivitetet e këtij projekti në dhjetor 2017 me përfaqësuesit e ILR-së së Bullgarisë dhe ILR-së së Kroacisë, partnerë në projekt, u kontraktuan aktivitetet për periudhën e ardhshme që kanë të bëjnë me fushat si vijon: 1. Zhvillimi i mëtejshëm i procesit të revizionit në pajtim me ISSAI; 2. Përforcimi i kapaciteteve të revizionit të ESHR-së; 3. Vendosja e praktikës së mirë ndërmjet Kuvendit dhe ESHR-së për t'i pranuar raportet e revizionit; dhe 4. Përmirësimi i sistemeve për komunikimin e TI-së dhe për menaxhimin me resurset njerëzore në dobi të procesit të revizionit.



# 2018

ГОДИШЕН ИЗВЕШТАЈ  
RAPORTI VJETOR  
ANNUAL REPORT

*"Nemo est supra leges"*  
*Marcus Tullius Cicero*





## **Foreword**

This year the State Audit Office is celebrating its 20th anniversary as an independent supreme audit institution in the Republic of North Macedonia. SAO management and employees are particularly proud of the achieved results in the past period.

With the Annual Report on SAO operation and performed audits in 2018, we would like to share with the public the most significant results and challenges of our work.

In 2018, the State Audit Office produced 117 reports, covering 102 entities under our jurisdiction. The reports contain important information and a number of recommendations that are important for improving

financial management and responsible spending of public funds by the auditees. In the selection and definition of the audit scope, we were guided by the principles of transparent and earmarked spending of public funds and the quality of public services worthy of the citizens of the Republic of North Macedonia.

Our activities in the following period will focus on enhancing the cooperation with the Assembly of the Republic of North Macedonia, as well as on implementation of the activities defined in our Development Strategy 2018-2022, HR Management Strategy and IT Strategy, aimed at strengthening independence and integrity of the institution, professional development of its employees and improvement of the efficiency and quality of audit with the application of an audit management system.

In the forthcoming period, we shall commit ourselves to the finalization of the initiative for constitutional regulation of the State Audit Office. It is necessary to define the role and function of the State Audit Office with the Constitution of RNM in order to strengthen its independence and it is a precondition for start of the negotiations with the EU for the chapter related to financial control. Integral part of this Annual Report is the opinion of the independent external auditor on the financial statements of the State Audit Office for 2018.

*Deputy Auditor General  
Naser Ademi*

## MISSION

The State Audit Office (SAO) is the Supreme Audit Institution of the Republic of North Macedonia whose objective is to communicate audit findings timely and objectively to the Assembly, the Government, other public office holders and the public.

The State Audit Office provides support to the Assembly of RNM in meeting its responsibilities by identifying and disclosing irregularities, cases of illegal operation and potential cases of corruption and abuse of office.

With clear and effective recommendations, SAO provides support to the state institutions and the beneficiaries of public funds for improving the management thereof. Thus, SAO contributes to the improvement of the lives of the citizens of the Republic of North Macedonia.

## INDEPENDENCE

As an independent external auditor, SAO conducts audit on public revenues and public expenditure in line with the auditing standards (ISSAIs) of the International Organization of Supreme Audit Institutions (INTOSAI).

SAO independence is guaranteed by the State Audit Law, first enacted in 1997 and amended on several occasions during the past years. New State Audit Law was adopted in 2010 for further compliance with the Mexico Declaration on Supreme Audit Institution Independence and the Lima Declaration of Guidelines on Auditing Precepts. The Law regulates SAO position and provides for a broad mandate for conducting regularity and performance audits, and access to all necessary information. SAO has financial independence and authority to manage its own resources. In addition, SAO has the freedom to decide on the audit subject and contents, and has sufficient mechanisms for follow-up of audit recommendations to ensure appropriate implementation thereof.

## EMPLOYEES

SAO organizational structure consists of 143 job posts, out of which 89 were filled out until the end of 2018. Out of the total number of employees, 84 are authorized state auditors and state auditors and five are administrative audit support staff. State auditors are organized in three departments directly involved in the audit process (audit departments) and cover different areas of the public sector, one department for audit development and following international practice for ISSAI implementation and one department for IT audit. SAO organizational structure also involves two departments for administrative audit support (legal and financial affairs) and two units for human resources and internal audit.

Most of the employees i.e. 68 of them hold a Certificate for authorized state auditor.

According to the qualifications structure, 99% of the employees have university degree in economy, law, information technology and other fields, and the percentage of employees with master's degree is continuously increasing.

Out of the total number of employees, 68% are women. The median age of employees is 40 and 32% of the employees are over 50 years of age.

As regards the number of authorized state auditors and state auditors distributed according to their title, audit is conducted by 22 independent auditors, 14 senior auditors, 21 auditor and 16 junior auditors. The remaining hold managerial positions as follows: three Advisors to the Auditor General, four Assistants to the Auditor General (Heads of department) and four Heads of audit.

In order to achieve SAO mission and vision, it is necessary to plan for and recruit experienced professionals to strengthen the capacities of the institution. Taking into consideration the number of auditees (around 1500), the age structure of the employees, as well as the natural outflow of highly professional staff expected in the following years (managerial staff, independent and senior auditors), SAO will face the challenge of insufficient professional potential to conduct the audit process.

In this context are also the recommendations of the European Commission regarding employment of audit professionals, especially for auditing the operation of political parties.

#### *Age structure of SAO employees*

Age structure	Number	%
Над 60	15	17
Над 50	13	15
Над 40	30	34
Над 30	25	28
Над 20	6	6
<b>Вкупно</b>	<b>89</b>	<b>100</b>

## Professional Development of SAO Employees

The professional development of auditors and managerial staff continued in line with SAO strategic objectives and 2018 Annual Work Program, which contributes to the establishment of an objective system for assessment of the level of quality completion of the work tasks.

Training of employees in SAO was carried out through internal trainings with SAO lecturers; trainings by experts engaged through the Twinning Project; on-the-job trainings through pilot regularity and performance audits within the Twinning Project; study visits and internships of employees organized through the Twinning Project; participation in courses, seminars and workshops organized by working groups/committees of INTOSAI/EURSAI, the European Court of Auditors, SIGMA and other international professional organizations and associations.

In 2018, SAO organized internal trainings in the following areas:

- Training of the employees on IT policies and procedures, as well as the procedures on the use of the Audit Management System (AMS);
- Training of the employees on the use of AMS, according to the established needs;
- Training on strategic audit planning;
- Training on performance audit and audit of EU funds, and
- Training on detection of irregularities and corruption in the public sector.

## STRATEGIC DOCUMENTS

SAO Development Strategy 2018-2022 was adopted in December 2017. It is a continuation of the previous strategy along the same path of strategic development, supporting itself on the pillars embedded as strategic development goals, ensuring the continuity of many activities and planning new ones to provide for further improvement of the State Audit Office and its work.

INTOSAI and EUROSACI strategic documents were used as starting point for SAO Development Strategy for the upcoming five-year period. It consists of the commitments for promotion and improvement of the implementation of international standards of supreme audit institutions (ISSAIs), for strengthening independence and integrity as preconditions for professionalism and credibility in the work, as well as for continuous monitoring of the effects of performed audits and the level of implementation of audit recommendations by the auditees.

In 2018, many activities were undertaken for implementation of the strategic objectives, as follows:

- Audit Quality Assurance, as a method for assessing quality control performance, is done in line with the Guidelines for audit quality assurance. Professional team of authorized state auditors conducted six audit quality assurance reviews. The issued reports contain recommendations on improvements and they are published on SAO web page.
